

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS SË SHQIPËRISË

INSTITUTI I STUDIMEVE PEDAGOGJIKE

UNICEF

INSTITUTI NDËRKOMBËTAR I EDUKIMIT GLOBAL,

UNIVERSITETI I TORONTOS

PROJEKTI I EDUKIMIT GLOBAL

RAPORTI I VLERËSIMIT TË FAZËS SË DYTË

AUTORE:

CAROLYNE ASHTON

NDIHMUAN:

STAVRI LLAMBIRI

ASTRIT DAUTAJ

AURORA BUSHATI

**TIRANË, SHQIPËRI
NËNTOR 2000**

Përmbajtja	Faqe
Përmbledhje.....	4
Metodologjia	6
1. Pjesa e Parë: Edukimi Global në Sistemin Arsimor Shqiptar.....	9
1.1 Gjendja e Sistemit Arsimor në Shqipëri.....	10
1.2 Edukimi Global: Përshkrim.....	12
1.2.1 Justifikimi.....	12
1.2.2 Filozofia e Edukimit Global.....	12
1.2.3 Prioritetet për Fazën e Parë	13
1.2.4 Prioritetet për Fazën e Dytë.....	13
1.2.5 Rezultatet e Fazës së Parë të Projektit.....	14
2. Pjesa e Dytë: Planifikimi dhe Zbatimi i Fazës së Parë dhe të Dytë.....	15
2.1 Pjesëmarrësit dhe Partnerët në Projekt.....	16
2.2 Planifikimi dhe Zbatimi.....	16
2.3 Roli i Ekipit Qendror.....	18
2.4 Proçesi i Zhvillimit të Kurrikulës- Modulet e Aktiviteteve.....	19
2.5 Trainimi i Mësuesve.....	19
2.6 Zbatimi.....	20
2.7 Vlerësimi.....	20
3. Pjesa e Tretë: Gjetjet.....	22
3.1 Përmbledhja e gjetjeve kryesore në vlerësimin e Fazës së Dytë.....	23
3.1.1 Nxënësit	23
3.1.2 Mësuesit	23
3.1.3 Trainimi i Mësuesve.....	24
3.1.4 Burimet.....	24
3.1.5 Ndryshimi i Sistemeve.....	24
3.2 Përshkrimi i Gjetjeve Kryesore në Vlerësimin e Fazës së Dytë.....	25
3.2.1 Nxënësit	25
3.2.2 Mësuesit.....	27
3.2.3 Trainimi i Mësuesve: E Shkuara, E Tashmja, E Ardhmja.....	31
3.2.4 Mbështetja nga Drejtorët e Shkollave.....	32
3.2.5 Edukimi Global dhe Inisiativa e Reformës së Kurrikulës	32
3.2.6 Përmirësohen Marrëdhëniet Shkollë- Komunitet.....	33
3.2.7 Rritet Përfshirja e Prindërve.....	33
3.2.8 Burimet e Nevojshme.....	34
3.2.9 Shënime të Vlerësueses mbi Vëzhgimin në Klasë.....	34
3.2.10 Ekipi Qendror.....	35
3.2.11 Roli i Ministrisë së Arsimit dhe Institutit të Studimeve Pedagogjike.....	40
3.2.12 Roli i UNICEF-it.....	41
3.2.13 Analiza e Buxhetit.....	43
3.2.14 Konkluzione.....	43

3.3 Rekomandime.....	44
3.3.1 Zhvillimi i Kurrikulës.....	44
3.3.2 Trainimi	44
3.3.3 Zhvillimi i Burimeve.....	45
3.3.4 Edukimi Publik.....	45
3.3.5 Vlerësimi.....	46
3.3.6 Ndërtimi i Kapaciteteve.....	46
3.3.7 Ndryshimi i sistemeve.....	47
Shtojca:	48
A. Buxheti.....	48
B. Procedurat për Vlerësimin nga Pjesëmarrësit gjatë Fazës së Dytë, gjatë Zbatimit-Shkurt- Maj 2000.....	52
C. Procedurat për Intervistat Gjysëm të Strukturuar të bëra gjatë hartimit të Raportit të Vlerësimit - Nëntor 2000.....	66
D. Anëtarët e Ekipit Qendror dhe Shkollat Pjesëmarrëse.....	72
E. Lista e Aktiviteteve të Kurrikulës së Edukimit Global.....	75
F. Matricat e Aktiviteteve dhe Dimensioneve të Edukimit Global.....	80
G. Shembuj të Aktiviteteve për çdo Lëndë.....	89

Përmbledhje

Ky raport paraqet një vlerësim të Projektit të Edukimit Global, i cili po zbatohet në sistemin arsimor shqiptar si një komponent i një përpjekje të gjithanshme në reformën arsimore. Projekti filloi në 1997 dhe në Qershor 2000 kishin përfunduar faza përgatitore dhe dy faza. Zyra e UNICEF-it në Tiranë, Shqipëri, e mbështeti financiarisht dhe administrativisht këtë projekt dhe financoi vlerësimin e tij. Ministria e Arsimit të Shqipërisë, Instituti i Studimeve Pedagogjike (ISP), dhe Instituti Ndërkombëtar i Edukimit Global (INEG), Universiteti i Torontos ishin partnerë me UNICEF-in në këtë projekt.

Vlerësimi përfshin një rishikim të një vlerësimi të brendshëm të bërë në Fazën e Parë të projektit si edhe vlerësimin e Fazës së Dytë. Metodologjia e kërkimit ishte kryesisht analizë cilësore. Vlerësimi u bë nga një vlerësuese e jashtme me mbështetjen e partnerëve në këtë projekt.

Qëllimi i kurrikulës së Edukimit Global është të kombinojë një metodologji të mësimdhënies në grup me një filozofi edukimi që përfshin nxënësin në të mësuarit e vet dhe nxit një shikim të gjithanshëm të të nxënësve. Në Shqipëri, projekti është zbatuar duke zhvilluar “aktivitete” që mund të bëhen gjatë një ore mësimi. Këto aktivitete janë hartuar që të plotësojnë objektivat e kurrikulave në matematikë, dituri natyre, gjuhë shqipe, edukatë qytetare dhe histori/gjeografi. Aktivitetet jo vetëm që lidhen me një objektiv të caktuar të lëndës, p.sh. pjesët e ligjëratës në gjuhë, por gjithashtu i japin nxënësve mundësinë të futen në dialog mbi tema më të gjera të tilla si mjedisi ose shëndeti nëpërmjet ushtrimeve që i lejojnë ata të praktikojnë zbatimin e të mësuarit në botën “reale”. Gjatë fazës së dytë, projekti u zbatua në tetë rrethe në 10 shkolla. Në aktivitetet e Edukimit Global u trainuan 88 mësues dhe morën pjesë 5100 nxënës.

Gjetjet tregojnë se pas 3 vjetësh, projekti ka një impakt pozitiv tek nxënësit pjesëmarrës dhe tek mbështetësit e tij. Gjetjet janë përmbledhur tek Pjesa e Tretë.

Gjetjet kryesore përfshijnë:

Nxënësit

1. Ka patur tregues të ndryshimit cilësor në aspekte të tilla si pjesëmarrja në klasë, përmirësimi i shprehive të zgjidhjes së problemeve, rritja e tolerancës ndaj ndryshimit, përmirësimi i vetëvlerësimit dhe tregues subjektivë të përmirësimit të rezultateve akademike.
2. Nxënësit më të dobët në mësim kanë rritur pjesëmarrjen e tyre në klasë dhe në të nxënësve objektive të lëndës.
3. Nxënësit merrnin pjesë në veprimtari në shkollë apo komunitet dhe raportuan se marrdhëniet e tyre me pjesëtarët e tjerë të familjes ishin duke u përmirësuar.

Mësuesit

1. Mësuesit shprehën një shkallë të lartë kënaqësie dhe komforti në lidhje me metodat e punës në grup të mësimdhënies. Ata e përshkruan rolin e tyre si lehtësues dhe bashkënxënës dhe jo si një lektor që thjesht jep informacion.
2. Mësuesit mendojnë se Projekti i Edukimit Global shpenzon më shumë kohë se modeli tradicional i së kaluarës, por të gjithë thanë se kjo metodë është shumë më efektive për t'i mbajtur nxënësit të angazhuar në procesin e të nxënësve.

3. Një Ekip Qëndror hartoi aktivitetet dhe mësuesit i zbatuan ata siç ishin shkruar. Disa mësues nuk patën probleme për t'i rregulluar apo përshtatur ato, por sidoqoftë ndihet nevoja për një integrim të mëtejshëm që mësuesit të ndërtojnë kapacitete për të shkruar vetë aktivitetet e tyre.
4. Trainimi u konsiderua shumë efektiv në hedhjen e bazave për suksesin e këtij projekti. Të gjithë mbështetësit shprehën dëshirën për trainim më të avancuar dhe implementimin e një modeli trainimi të trajnuesve.
5. Burimet për aktivitetet ishin disi të mjaftueshme, nxënësit dhe mësuesit i gjenin ato vetë, sidoqoftë, të gjithë shprehin nevojën për burime reference më teknologjike për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të projektit.

Ndryshimi i Sistemeve

1. Zbatimi i projektit u mbështet fuqimisht nga të gjithë: Drejtorët e shkollave, Drejtorët e Drejtorive Arsimore të Rretheve, Ministria e Arsimit dhe Instituti i Studimeve Pedagogjike. Drejtorët e shkollave dhe drejtorët e drejtorive arsimore në rrethe nxitën trainimin e mësuesve në rrethet e tyre dhe ISP i siguron kohë stafit të vet në Ekipin Qëndror për të shkruar aktivitetet dhe për t'i dhënë mbështetje mësuesve që janë duke zbatuar projektin.
2. Projekti duket se ka fuqizuar përpjekjet e reformës së kurrikulës në sistemin arsimor shqiptar.
3. Marrdhëniet shkollë-komunitet duket se janë përmirësuar si rezultat i këtij projekti.
4. UNICEF-i shihej si baza për gjendjen e tanishme të rezultatit të projektit.

Pjesa 3.3 e raportit përmban një sërë rekomandimesh nga vlerësuesja që bazohen tek gjetjet. Këto rekomandime duhen rishikuar dhe diskutuar nga mbështetësit të cilët kanë përgjegjësinë e vendim-marrjes për vazhdimin e Projektit të Edukimit Global. Disa nga rekomandimet më të rëndësishme përfshijnë:

Zhvillimi i Kurrikulës

1. Të përmirësohet më tej kapaciteti i Ekipit Qëndror për të shkruar aktivitete të një kalibri të lartë.
2. Të studiohet dhe të integrohet ku është e mundur efekti i këtij projekti mbi reformën e përgjithshme të kurrikulës.

Trainimi

1. Të përmirësohet cilësia e zbatimit të Edukimit Global dhe të rritet kapaciteti i mësuesve shqiptarë për të trainuar kolegët e tyre duke ruajtur ndërkohë integritetin e modelit të trainimit të siguruar nga INEG duke ofruar trainim të avancuar dhe një trainim të trainuesve.

Zhvillimi i Burimeve

1. Të përmirësohen materialet e referencës dhe mbështetja teknologjike, duke përfshirë pajisjen me kompjutera dhe fotokopje të shkollave ekzistuese të Edukimit Global dhe për përdorim nga Ekipi Qëndror në ISP. Ata e ndjejnë se kjo metodë është shumë më efektive për t'i mbajtur nxënësit të angazhuar në procesin e të mësuarit.

Edukimi Publik

1. Rekomandohen disa përpjekje për të rritur vizibilitetin dhe mbështetjen mbarëkombëtare për zbatimin e këtij projekti, duke përfshirë materialet e botuara, videot dhe një konferencë kombëtare.

Vlerësimi

1. Të rishikohen dhe të revizionohen të gjithë instrumentet e proceset e vlerësimit për të siguruar një vlerësim të vazhdueshëm dhe të besueshëm të këtij projekti. Të integrohet vlerësimi si një mjet planifikimi gjatë gjithë projektit.

Ndërtimi i kapaciteteve

1. Të bëhet një vizitë nga Ekipi Qëndror në programin e Edukimit Global në Toronto nga fillimi i vitit 2001 për të rritur kapacitetin për të modeluar programin në Shqipëri.
2. Të integrohet Edukimi Global si pjesë e trainimit të mësuesve të ardhshëm në universitetet e mësuesisë.

Ndryshimi i Sistemeve

1. Të fillojë, në fillim të 2001, zhvillimi i një plani strategjik që do ta çojë sistemin arsimor shqiptar në marrjen përsipër plotësisht të pronësisë së këtij projekti në vitet e ardhshme. Të rritet përfshirja e mbështetësve në të gjitha nivelet, duke pasur si qëllim përfundimtar vlerësimin e “Shkollës së Edukimit Global”: duke mos u kufizuar tek kurrikula e Edukimit Global, por duke ndryshuar normat e sistemit arsimor shqiptar. Ky kalim është i pajtueshëm me reformën e propozuar arsimore.

Rishikimi i buxhetit tregoi se deri më sot, projekti pati një kosto me efekt të lartë, duke kushtuar afërsisht \$16 për nxënës gjatë fazës së dytë. Për fazën e tretë do të ketë një shtesë buxheti nëse do të ndiqen rekomandimet për pajisjen me kompjutera dhe pajisje dhe materiale të tjera për 14 shkollat e tanishme dhe ISP. Sidoqoftë, kostoja për nxënës do të vazhdojë të jetë në kahun e ulët të kostove të kurrikulave \$33 për nxënës krahasuar me një kosto mesatare \$253 për nxënës për kurrikula të krahasueshme. Meqënëse numri i shkollave, nxënësve dhe mësuesve që marrin pjesë në këtë projekt vazhdon të zgjerohet, këto kosto fillestare do të thithen nga zgjerimi. Këto shpenzime do të përbënin një kontribut të rëndësishëm për kapacitetin për të zgjeruar projektin dhe për cilësinë e tij.

Në përgjithësi, Projekti i Edukimit Global i zbatuar në sistemin arsimor shqiptar doli se ishte shumë efektiv dhe se përmbushte synimet e parashtruara në kurrikul. Ashtu si me çdo projek që përfshin ndryshim afatgjatë në qëndrime dhe sjellje, do të duhen edhe disa vite për të matur thellësinë e ndryshimit. Një proces i përmirësuar vlerësimi do të jepte mundësinë për të parë nëse ka ndryshim apo ai mungon. Në këtë pikë, të gjithë treguesit shënojnë sukses të vazhdueshëm të projektit nëse UNICEF do të vazhdojë ta mbështesë edhe për pak vjet dhe nëse kapaciteti i shqiptarëve për të marrë përsipër dhe futur projektin në sistemin e tyre arsimor vazhdon të rritet.

Metodologjia

Ky raport u përgatit për UNICEF-in dhe partnerët e tij të projektit të Edukimit Global në Shqipëri. Raporti u hartua nga një ekip vlerësimi i përbërë nga një vlerësuese e jashtme e ndihmuar nga dy anëtarët e Ekipit Qëndror të Edukimit Global nga Instituti i Studimeve Pedagogjike, Stavri Llambiri dhe Astrit Dautaj si dhe nga Aurora Bushati, menaxhere programi e UNICEF-it për projektin e Edukimit Global. Raporti përmban gjetjet dhe rekomandimet nga vlerësimi i brendshëm i fazës së parë kryer nga anëtarët e Ekipit Qëndror, nga Instituti i Studimeve Pedagogjike. Vlerësimi i fazës së dytë u hartua për të parë saktësinë e raportit të fazës së parë dhe për të rishikuar dhe integruar gjetjet e raportit në raportin e fazës së dytë. Gjetjet në vlerësimin e fazës së dytë konfirmojnë gjetjet në raportin Fazës së Parë dhe ndërtohen mbi atë dokument. Ky raport i fazës së dytë përfshin edhe një analizë të buxhetit. (Pjesa 3.2.13 dhe shtojca A). Intervistat e kryera nga vlerësuesja e jashtme mbulojnë periudhën 1997 deri Maj 2000.

Gjatë ecurisë së Fazës së dytë, Ekipi Qëndror ishte përgjegjës për administrimin e një sërë pyetësorësh dhe intervistash me mësues, nxënës, drejtorë shkollash dhe inspektorë drejtorish arsimore. Ata ishin përgjegjës bashkë me mësuesit edhe për plotësimin e fletëve të vëzhgimit

gjatë zbatimit aktual të sesioneve të Edukimit Global.. Mësuesit e Edukimit Global plotësonin ditaret ku përshkruanin ndjenjat e tyre dhe vëzhgimet para dhe pas zhvillimit të aktiviteteve të Edukimit Global. Këto të dhëna u grumbulluan në ISP dhe ishin gati për tu riparë nga vlerësuesja e jashtme në fund të fazës së dytë. (Shih shtojcën B). Të dhënat ekzistuese për analizën përfshinin:

1. Intervistat me mësuesit (me gojë) para dhe pas Pilotimit të aktiviteteve të reja të shtuara në fazën e dytë (7 para dhe 4 pas-intervista ishin disponibël për analizën)
2. Pyetësorët e mësuesve (me shkrim) para dhe pas periudhës së pilotimit për aktivitetet e reja (7 para dhe pas pyetësorë ishin disponibël për analizën)
3. Fletët e feedback të mësuesit të plotësuar pas zhvillimit të çdo aktiviteti të Edukimit Global. (544 fletë feedback ishin disponibël për analizë-u panë 52)
4. Fletët e feedback të nxënësit ishin plotësuar nga afro 5 nxënës që morën pjesë në çdo aktivitet (2199 fletë feedback ishin disponibël për analizë- u panë 219)
5. Lista për vëzhgimin e mësimit e plotësuar nga anëtarët e Grupit Qëndror dhe kolegët mësimdhënës gjatë një aktiviteti të Edukimit Global. (555 fletë feedback ishin disponibël për analizë-u panë 55)
6. Ishin mbledhur gjithashtu 47 ditarë që përfshijnë refleksionet e mësuesve mbi projektin e Edukimit Global në klasat e tyre.

Të gjithë formularët ishin plotësuar në shqip. Vlerësuesja e jashtme nuk fliste shqip dhe pati ndihmën e përkthyeses. Katër formularët para dhe pas pilotimit u analizuan të gjithë. Për arsye të kohës së kufizuar për plotësimin e raportit dhe sasisë së kohës që do të duhej për të përkthyer të gjithë dokumentacionin, u vendos që të përkthehej dhe analizohej dhjetë përqind e fletëve feedback të mësuesve, fletëve feedback të nxënësve dhe listave të vëzhgimit. Ekipi i vlerësimit mendoi se kjo përqindje do të jepte një vlerësim të drejtë të të dhënave. Përkthyesja u trainua gjithashtu nga vlerësuesja se si të analizonte të dhënat.

Më tej, vlerësuesja e jashtme, me ndihmën e Z. Llambiri dhe Z. Dautaj, hartoi një sërë pyetjesh intervistë gjysëm të strukturuar për nxënësit, mësuesit jo të përfshirë në Edukimin Global, mësuesit e Edukimit Global, drejtorët e shkollave, inspektorët e drejtorive arsimore dhe shumicën e anëtarëve të Ekipit Qëndror. (Shih shtojca C). Intervistat u bënë në katër shkollat që u vizituan nga vlerësuesja e jashtme. Tre nga këto vizita përfshinin gjithashtu vëzhgimin e një ore mësimi të Edukimit Global dhe një ore mësimi jo të Edukimit Global (dy nga të cilat në gjuhën shqipe dhe një në matematikë). Vizitat u përgatitën nga Z. Llambiri, Z. Dautaj dhe Zj. Bushati. Shkollat u zgjedhën mbi bazën e afërsisë me Tiranën. Shkollat ishin: Shkolla “Dora D’Istria” dhe shkolla “Ramazan Jarani” në Tiranë, shkolla “Xhaferr Kongoli” në Elbasan dhe shkolla “Kushtrimi i Lirisë” në Durrës. Intervista të pastrukturuar u zhvilluan gjithashtu me Drejtorin për Arsimin 8 vjeçar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë, Drejtorin e Institutit të Studimeve Pedagogjike dhe stafin e Universitetit “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan.

Anëtarët e Ekipit Qëndror siguruan asistencë në përpilimin e matricave që jepnin diagrame të aktiviteteve, numrit të shkollave, analizën e buxhetit dhe rishikimin e raportit për saktësi. Ata, së bashku me stafin e UNICEF-it, i dhanë në dispozicion vlerësueses së jashtme versionet anglisht të të gjithë dokumentacionit me shkrim mbi projektin përshirë raportet e Institutit Ndërkombëtar të Edukimit Global në Toronto, Kanada, raportime të brendshme dhe dokumenta përmbledhëse dhe të gjitha të dhënat financiare mbi projektin.

Të dhënat e rishikuara të këtij raporti janë kryesisht cilësore, kështu që u përdor një metodë analize përshkruese. Për të zhvilluar këtë raport, analiza përshkruese kërkoi për tema dhe fije të përbashkëta midis burimeve të ndryshme të të dhënave. Vlerësuesja arriti të shndrronte disa nga

të dhënat në format sasior për raportim. Janë përsëritur disa materiale përshkruese nga hyrja e raportit të Fazës së Parë, të cilat përfshijnë përshkrimin e sitemit arsimor në Shqipëri dhe përshkrimin bazë të filozofisë dhe metodologjisë së Edukimit Global. Pjesa e planifikimit dhe zbatimit e raportit të Fazës së Parë është në Pjesën e Dytë të këtij raporti. Raportit të fazës së dytë i janë shtuar materiale dhe të dhëna përkatëse nga periudha e fazës së parë.

PJESA E PARË:

EDUKIMI GLOBAL NË SISTEMIN ARSIMOR NË SHQIPËRI

1.1 SITUATA ARSIMORE NË SHQIPËRI

Shndërrimet e vullshme cilësore, ekonomike, sociale, politike dhe kulturore të dekadës së fundit e vunë individin dhe shkollën shqiptare përballë detyrave të reja shumëplanëshe. Në përpjekjet për të zgjidhur problemet e shumta në arsim janë ndërmarrë hapa të shumtë që kanë synuar të vënë shkollën në funksion të ndryshimeve dhe nevojave të larmishme, aktuale dhe perspektive të individit, grupeve dhe shoqërisë në tërësi.

Ka disa vite që po bëhen përpjekje për të qartësuar dhe kristalizuar linjat kryesore të një reforme të re arsimore që do të synojë në sigurimin dhe rritjen e cilësisë së tërë sistemit arsimor në Shqipëri. Në vija të përgjithshme reforma synon të përfshijë 3 aspekte:

- ❖ Fushën legjislative- administrative:
Në fushën legjislative- administrative synohet krijimi i një kuadri ligjor për ndërtimin dhe zhvillimin e një shkolle demokratike dhe ka të bëjë me procesin e decentralizimit dhe rritjen e iniciativës lokale, me forcimin e lidhjeve të shkollës me komunitetin, me rritjen e shkallës së pjesëmarrjes së gjithë partnerëve të shkollës, të mësuesve, nxënësve, prindërve dhe komunitetit në marrjen e vendimeve dhe mbarëvajtjen e punëve të shkollës.
- ❖ Kurrikula:
Në fushën e kurrikulës synohet reformimi i përmbajtjes së sistemit arsimor parauniversitar. Të gjitha lëndët do t'i nënshtrohen procesit të rishikimit, të përmirësimit apo të hartimit të kurrikulave të reja që do të ndihmojnë shkollën dhe gjithë sistemin arsimor të vihen në funksion të nevojave reale afatshkurtëra dhe afatgjata të shoqërisë. Vizioni i ri për ndryshimet demokratike në shkollë, parashikon rritjen e shkallës së decentralizimit të kurrikulës dhe rritjen e rolit të autoriteteve lokale dhe vetë shkollës në përshtatjen e saj me kushtet dhe nevojat e veçanta të rretheve dhe shkollave.
- ❖ Përmirësimi i cilësisë së burimeve njerëzore:
Duke pranuar rolin qendror të burimeve njerëzore në përgjithësi dhe të mësuesit në veçanti në realizimin e kurrikulës së re dhe në demokratizimin e procesit mësimor, ndërtimi i kapaciteve është një ndër prioritetet absolute të reformës.

Kështu, situata kaotike ekonomike, politike e sociale ka penguar, ose të paktën nuk ka ndihmuar pozitivisht procesin e unifikimit të strategjisë së rinovimit të kurrikulës dhe të metodave të mësimdhënies. Ndryshimet që kanë ndodhur në fushën kurrikulare apo në trainimin e mësuesve, shpeshherë, kanë qënë të pjesshme, sporadike dhe jo rezultat i objektivave të qarta strategjike në nivel kombëtar, lokal ose shkolle.

Në të gjitha nivelet e arsimit janë bërë përpjekje të shumta për të sjellë ndryshime pozitive por realiteti tregon se këto përpjekje janë karakterizuar nga njëanshmëria e konceptimit dhe veprimit. Ka munguar analiza sistemike e gjithë sistemit arsimor në Shqipëri. Politika arsimore, për vite të tëra, nuk ka qënë në gjendje të hartonte dhe të sillte ndryshime cilësore.

Një pjesë e nxënësve dhe e familjeve të tyre duket se e kanë humbur motivin e shkollimit të tyre. Ata e kanë të vështirë të shohin lidhjet ndërmjet arsimit të sotëm dhe perspektivave të tyre në të ardhmen, ndërkohë që e ardhmja e nxënësve dhe e shoqërisë pak trajtohet, për të mos thënë nuk përmendet në kurrikulën ekzistuese. E ardhmja nuk ka zënë vendin e duhur as në veprimtaritë e mësuesve dhe nxënësve në klasë dhe shkollë.

Mjaft mësues, sidomos në zona rurale të vendit, janë pa arsimin përkatës ose janë me formim të njëanshëm dhe të papërshtatshëm për realizimin e objektivave të kurrikulës ose të dimensioneve

kros- dhe ekstra-kurrikulare të shkollimit. Sistemi i trainimit të mësuesve nuk ka funksionuar si duhet. Deri tani mësuesit janë trainuar sipas fushave dhe objektivave të projekteve të veçanta dhe nuk janë ngritur në kuadrin e trainimeve të mbështetura në programe strategjike dhe afatgjatë. Trainimet e deri sotme kanë plotësuar boshllëqe të caktuara në formimin e një numri të vogël mësuesish. Ato megjithë vlerën e tyre nuk kanë ndikuar në formimin sistematik të mësuesve, gjë që do të ndihmonte jo vetëm në zgjerimin e vizionit të tyre mbi botën, por edhe në mundësinë e integritit më të mirë lëndor nga mësuesi.

Në shumë shkolla, sidomos në zonat rurale mungojnë mjetet e domosdoshme. Në të njëjtën kohë ato karakterizohen nga një numër i madh nxënësish nëpër klasa (ndonjëherë 40-45 nxënës) si rezultat i migrimit të brendshëm të popullsisë dhe pamundësisë për ta përballuar atë në nivel shkolle apo zone.

Realiteti i përshkruar më sipër dëshmon se ndërmarrjet e realizuara në arsim, si në fushën e kurrikulës ashtu edhe në atë të metodave të të nxënës dhe të mësimdhënies, nuk kanë arritur t'i shërbejnë sa dhe si duhet krijimit të një sistemi arsimor në funksion të një shoqërie dhe bote gjithnjë e më të ndërvarur e në ndryshim të pandërprerë.

Pavarësisht nga mangësitë dhe vështirësitë e sipërpërmendura në të gjitha nivelet e sistemit arsimor nuk ka munguar vullneti dhe përpjekjet për të sjellë ndryshime cilësore dhe të qëndrueshme.

Projekti i Edukimit Global, i inicuar dhe i mundësuar nga UNICEF dhe i mbështetur fuqimisht nga MASH dhe ISP, erdhi në Shqipëri në kohën e duhur. Objektivat e këtij projekti rezonojnë plotësisht me nevojat aktuale dhe perspektive të sistemit arsimor në Shqipëri. Ato i shërbejnë rikonceptimit dhe hartimit të një kurrikule në funksion të një bote gjithnjë e më globale si dhe kualifikimit të burimeve njerëzore, kryesisht mësuesve që ato të jenë në gjendje ta zbatojnë atë në mënyrë krijuese. Kjo do të sigurote plotësimin e nevojave si lokale edhe globale të një qytetari global në një shoqëri globale.

1.2 PROJEKTI I EDUKIMIT GLOBAL INEG/UNICEF/MASH/ISP:

1.2.1. Justifikimi

Në Tetor të vitit 1997, UNICEF në Shqipëri mori vendimin të zbatojë në Shqipëri Edukimin Global si mundësi dhe mjet për të sjellë ndryshime cilësore dhe efektive në arsimin tetëvjeçar shqiptar. Në këtë kuadër një ekip ekspertësh shqiptarë, filluan punën për të vënë në jetë projektin, në bashkëpunim me konsulentët nga Instituti Ndërkombëtar i Edukimit Global në Universitetin e Torontos, Kanada, Prof. David Selby dhe Graham Pike të cilët kanë qënë edhe drejtuesit profesionalë të tij.

Justifikimin e tij, projekti i Edukimit Global e gjeti në rradhë të parë në nevojat e reformimit të arsimit shqiptar për t'i shërbyer dhe paraprirë kërkesave të vendit, në kuadrin e një bote në të cilën ndryshimi e ndërvarësia po rriten me ritme të paimagjinueshme.

Përqaftimi i idesë dhe zbatimi i projektit u përforcua nga fakti që modelet e Edukimit Global në fushën e kurrikulës dhe të metodave të të nxënimit dhe mësimdhënies ishin provuar plotësisht të suksesshme në vende të Lindjes së Mesme dhe të Afrikës Veriore. (Liban, Jordani, Siri dhe Palestinë)

1.2.2. Filozofia e Edukimit Global

Në themel të tij, Projekti ka modelin 4 dimensional të Edukimit Global. Këto dimensione janë si më poshtë:

1. **Dimensioni hapësinor** fokusohet në *varësinë dhe kushtëzimin* gjithnjë e më të madh të botës në cilën jetojmë, në botën në të cilën *frequenca, thellësia, shkalla, numri i dukurive* dhe veprimtarive njerëzore që prekin, ndikojnë apo ndikohen nga varësia globale po rriten në përmasa të konsiderueshme. (Ndarjet dhe kufijtë po e humbasin kuptimin e tyre të mëparshëm). Ky dimension kërkon nga shkolla të ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë njohuri, shprehje dhe qëndrime të domosdoshme për pjesëmarrje efektive në këtë botë të re të ndërvarur.
2. **Dimensioni kohor.** Në fokusin e këtij dimensionit *e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja* perceptohen në dinamizmin e një lidhjeje tërësore e dialektike. Në kuadrin e tij interpretimi i së kaluarës lidhet, rrjedh e kushtëzohet si nga shqetësimet dhe prioritetet e të sotmes ashtu dhe nga perceptimi i së ardhmes. Po kështu edhe vetë imazhi që sot njerëzit kanë për të ardhmen si dhe vetë e ardhmja modelohen nga shqetësimet dhe interpretimet e sotme (ku përfshihen edhe ato të së kaluarës) si dhe nga vendimet dhe veprimet që ata ndërmarrin sot. Edukimi Global, sipas dimensionit kohor, synon t'i japë të ardhmes vendin që meriton në procesin e edukimit, vend që aktualisht asaj i mungon dhe të përgatisë dhe të inkurajojë nxënësit të jenë agjentë efektivë në një botë në ndryshim të shpejtë.
3. Dimensionin e tretë është **dimensioni i çështjeve**, cili ka synimet e mëposhtme:
 - Së pari, ai synon të mundësojë *njohjen e nxënësve me çështjet kryesore globale* që lidhen me *zhvillimin, mjedisin, paqen dhe të drejtat e njeriut*.
 - Së dyti, ai kërkon njohjen e nxënësve me parimet, opinionet, këndvështrimet e kundërta, argumentat që lidhen me çështjet e mësipërme.

- Së treti, dimensiononi i çështjeve kërkon që çështjet globale të shihen në tërësinë e lidhjeve dhe varësive të tyre reciproke dhe jo thjesht në kuadrin e një lidhjeje dhe varësie të thjeshtë lineare.

Ky dimension kërkon që nxënësit të njihen dhe të reflektojnë mbi çështjet e mësipërme dhe problemet që lidhen me to dhe vendndodhjen e tyre.

4. Dimensiononi i brendshëm është dimensiononi i katërt i Edukimit Global. Ky dimension kërkon të përfshijë në globalitetin e varësisë vetë njeriun, me nevojat e dëshirat e tij, me të drejtat dhe detyrimet, me shqetësimet e problemet e tij të brendshme. *Ai e eksploron njeriun në kompleksin e tij fizik e shpirtëror, material e intelektual e kulturor, në të cilin bota e jashtme dhe e brendshme të shihen dhe vlerësohen si pjesë e një të tërë.*

Ky dimension kërkon nga mësuesit të mbajnë parasysh që qëndrimet, vlerat dhe synimet sociale të arsimit mund të realizohen plotësisht nëse proceset arsimore dhe mjediset e shkollës do të jenë të afta të nxisin dhe zhvillojnë ndjenjën e vetëdijes, vetvlerësimit, të përkatësisë së grupit, të besimit, bashkëpunimit dhe qëndrimeve që respektojnë reciprokisht pikëpamjet, ndjenjat dhe këndvështrimet e të tjerëve.

Mbështetur në këtë model projekti i Edukimit Global në Shqipëri, në plan afatgjatë, synon të veprojë në dy drejtime kryesore:

1. Në drejtim të *konceptimit dhe krijimit të një kurrikule globale*, e cila të jetë e aftë të reflektojë botën në globalitetin e saj dinamik.
2. Në drejtim të *kualifikimit të mësuesve*, për t'i aftësuar të nxënë vetë dhe të mësojnë të tjerët për një botë në zhvillim e ndryshim të pandërprerë, përmes lehtësimit të një të nxëni interaktiv dhe pjesëmarrës.

1.2.3. Prioritetet për Fazën e Parë

Në Shqipëri, në situatën në të cilën ndodhemi, Edukimi Global pati si prioritet *trainimin e mësuesve*. Çdo përpjekje për të sjellë ndryshime në kurrikulën shkollë, (cilado qoftë cilësia e tyre) do të dështonte nëse nuk do të ekzistonte edhe mësuesi i aftë për t'i dhënë jetë asaj në klasë.

Mbështetur në këtë prioritet projekti plotësoi objektivat e mëposhtme gjatë Fazës së Parë:

1. Zhvilloi tre module për metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit nën filozofinë e Edukimit Global për klasat 5 dhe 6 që shërbyen si programe të plota alternative të cilat mësuesit mund t'i zgjidhnin për t'i përdorur sipas nevojave në kushtet konkrete në klasa e tyre.
2. Në përgjithësi mësuesit u trainuan me metodat e të nxënit interaktiv dhe në veçanti u trainuan të zbatonin modulet e të nxënit dhe mësimdhënies të hartuara në kuadrin e projektit.
3. U pilotuan, vlerësuan dhe përmirësuan modulet e zhvilluara.
4. U trainuan grupe mësuesish që më vonë punuan për përshtatjen dhe zbatimin në shkallë të gjerë të moduleve të Edukimit Global si dhe të metodologjive interaktive që i shoqërojnë nga mësuesit e shkollave dhe rretheve të përfshira në projekt.
5. U publikuan materiale mbështetëse për mësuesit si edhe gjetjet dhe rezultatet.

1.2.4. Prioritetet për Fazën e Dytë

Faza e Dytë vazhdoi procesin e zgjerimit dhe thellimit të shtrirjes së Edukimit Global në sistemin arsimor duke synuar prioritetet e mëposhtme:

1. Reduktimi i pengesave teknike për implementimin.
2. Hartimi i Manualit të Mësuesit të Edukimit Global në gjuhën shqipe.
3. Vazhdimi i trainimit të mësuesve për të zgjeruar numrin e mësuesve të Edukimit Global.
4. Zgjerim i vazhdueshëm i numrit të shkollave që praktikojnë numrin e mësuesve të Edukimit Global.
5. Përfshirja e drejtorëve dhe mësuesve të tjerë jo të Edukimit Global në trainimet e Edukimit Global.
6. Hartimi dhe pilotimi i vazhdueshëm i aktiviteteve dhe përmirësimi i cilësisë së aktiviteteve.
7. Shtimi i aktiviteteve të Historisë/Gjeografisë dhe Diturisë së Natyrës.
8. Shtrirja e zbatimit në klasën e shtatë.

1.2.5. Rezultatet e Fazës së Parë të Projektit

Siç e përmendëm më lart, zbatimi i projektit të Edukimit Global në Shqipëri filloi në vitin 1997.

Në fazën e parë të projektit u realizuan objektivat e mëposhtme:

1. U krijua Ekipi Qëndror.
2. U caktuan lëndët në të cilat u pilotuan filozofia dhe metodologjia e Edukimit Global (Gjuhë Shqipe, Matematikë, Edukatë Qytetare- klasa 5 dhe 6) dhe shkollat pilot në qytetet Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Shkodër.
3. U trainuan mësues të zgjedhur me konceptet dhe metodologjinë e Edukimit Global.
4. U caktuan aktivitetet për temat e zgjedhura në çdo lëndë.
5. U pilotuan aktivitetet në shkollat e përfshira në projekt, shoqëruar me intervista, vëzhgimet dhe pyetësorët e kryer nga Ekipi Qëndror dhe mësuesit.
6. U rrit larmia e metodave të mësimdhënies dhe të të nxënësve në shkollat, duke u bazuar kryesisht në metodat bashkëpunuese.
7. Mësimdhënia plotësoi më mirë nevojat individuale të nxënësve.
8. U përmirësua niveli i përvehtësimit të dijes dhe shprehjeve dhe synimeve të qëndrimit.
9. U forcua dhe u thellua tendenca për ndërthurjen e lëndëve (tema të tilla si: mjedisi, e ardhmja, shëndeti, demokracia, qytetaria etj. do të zënë vend vazhdimisht në kurrikul).
10. U rrit niveli profesional i mësuesve të cilët tashmë mund të vlerësojnë më mirë dhe më saktë potencialin e nxënësve.
11. U zhvilluan marrdhënie më pozitive midis mësuesve dhe nxënësve.
12. U analizuan rezultatet e pilotimit dhe u përgatit raporti përfundimtar i vlerësimit.

Këto objektiva ishin përmbushur në një farë shkalle nga fundi i Fazës së Parë nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë midis konsulentëve të Institutit Ndërkombëtar të Edukimit Global, Ekipeve Qëndror shqiptar, MASH, ISP dhe drejtorive arsimore të rrethëve të përfshira në projekt.

Modulet e Fazës së Parë u hartuan mbi bazën e kurrikulave dhe teksteve ekzistuese dhe u kufizuan në lëndët Gjuhë Shqipe, Edukatë Qytetare dhe Matematikë; mësuesit u lejuan t'i zhvillonin aktivitetet në klasat e tyre. Aktivitetet e planifikuara, pasi të zhvilloheshin dhe përpunoheshin, do të përfshiheshin në manualin e ardhshëm të trainimit për mësuesit. Modulet e Fazës së Dytë u hartuan për Historinë/Gjeografinë dhe Diturinë e Natyrës dhe u shtuan edhe aktivitetet për klasën e shtatë. Këto module u pilotuan dhe u rishikuan mbi bazën e feedback të mësuesve.

PJESA E DYTË:

PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI I FAZËS SË PARË DHE TË DYTË

2.1. PJESËMARRËSIT DHE PARTNERËT NË PROJEKT

2.1.1. UNICEF (Shqipëri)

Zyra e UNICEF-it në Shqipëri, Tiranë, Programi i Edukimit, vazhdoi si mbështetësi kryesor i projektit. UNICEF-i siguroi mbështetjen financiare, lidhjet, vlerësuesen e jashtme dhe koordinimin me Institutin Ndërkombëtar të Edukimit Global.

2.1.2. Instituti Ndërkombëtar për Edukimin Global (INEG), Universiteti i Torontos.

David Selby dhe Graham Pike, Bashkëdrejtorë të Institutit Ndërkombëtar për Edukimin Global, në Fakultetin e Edukimit, Universiteti i Torontos, ofruan konsulencë në hartimin dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve të projektit dhe trainimin e mësuesve dhe drejtorëve.

2.1.3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës vazhdoi të mbështesë aktivisht projektin në realizimin e të gjitha objektivave të tij.

2.1.4. Instituti i Studimeve Pedagogjike

Instituti i Studimeve Pedagogjike, i cili është përgjegjës, në kuadrin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për kryerjen e kërkimeve shkencore në fushën e zhvillimit të kurrikulave, kualifikimit të mësuesve dhe përgatitjes së materialeve pedagogjike që lidhen me të, të vlerësimit të ecurisë së sistemit arsimor. Specialistët e këtij instituti kanë vazhduar të drejtojnë punën për hartimin e aktiviteteve, trajnimin e mësuesve (në bashkëpunim me INEG) dhe ndjekjen e procesit të pilotimit, angazhimin e mësuesve për të shkruajtur aktivitete të reja dhe hartimin e raporteve.

2.1.5. Ekipi Qëndror

Ky ekip përbëhet nga katër specialistë të Institutit të Studimeve Pedagogjike dhe nga 5 mësues (dy për çdo lëndë të përfshirë në projekt). Nga këta 3 janë meshkuj dhe 6 femra.

2.1.6. Mësuesit e Rinj

Në fazën e dytë, numri i mësuesve të trainuar për Edukimin Global u rrit nga 28 në 88. Në trainim morën pjesë edhe drejtorët.

2.2 PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI

Projekti u zhvillua në këto faza:

Faza përgatitore:	Tetor 1997-Korrik 1998
Faza e Pilotimit:	Shtator 1998-Korrik 1999
Faza e Dytë:	Gusht 1999-Qershor 2000

Ekipi Qëndror, i përbërë nga specialistë të ISP dhe mësues me përvojë, në bashkëpunim me konsulentët e INEG në Toronto, Kanada, kryen një sërë aktivitete, të cilat janë përshkruar me hollësi në Raportin e Fazës së Parë. Vijimi është një përmbledhje e Fazës përgatitore dhe të Pilotimit që përbëjnë Fazën e Parë.

2.2.1. Faza Përgatitore

Pas marrjes së vendimit se futja e Projektit të Edukimit Global do të ishte me vlera për sistemin arsimor shqiptar, u zgjodhën për pilotim lëndët Matematikë, Edukatë Qytetare dhe Gjuhë Shqipe

si edhe 6 shkolla në katër rrethe të Shqipërisë. Për pilotimin e projektit u trainuan njëzet e dy (22) mësues. Konsulentët e INEG vunë në dispozicion të anëtarëve të Ekipit Qëndror libra, artikuj dhe materiale të tjera akademike për t'i lexuar dhe reflektuar mbi to.

U hartuan aktivitetet përkatëse të Edukimit Global në lëndët e zgjedhura për klasa 5 dhe 6. Përmbajtja tematike e aktiviteteve u zgjodh në varësi të përmbajtjes që do të mësohej në shkollë në periudhën e pilotimit (Maj 1998). U qartësua roli i Ekipit Qëndror në zhvillimin e aktiviteteve dhe filloi zhvillimi i tyre. Konsulentët e INGE rishikuan dhe dhanë komente të detajuara për modulet në të trija lëndët dhe Ekipi Qëndror bëri përshtatjet e nevojshme.

Në prill 1998, përfundoi përpunimi i moduleve dhe u mbajt një seminar për mësuesit e fazës së pilotimit. Konsulentët e INEG hartuan instrumentat e vlerësimit të zbatimit të projektit dhe Grupi Qendror mblodhi të dhëna nga mësuesit, nxënësit dhe drejtorët e shkollave nëpërmjet intervistave, vëzhgimeve dhe pyetësorëve.

2.2.2. Faza e pilotimit- Shtator 1998- Korrik 1999

Në tetor 1998 mbahet seminari për vlerësimin e gjetjeve të fazës përgatitore. Në të morën pjesë profesor Et'hem Ruka, Ministër i Arsimit dhe i Shkencës, përfaqësues të ISP, të ftuar nga universitetet e mësuesisë, anëtarët e Grupit Qendror dhe mësuesit e përfshirë në projekt.

Ministri Ruka shprehu vlerësimin e tij për projektin dhe ofroi mbështetjen e tij të fuqishme për vazhdimësinë e tij. Në seminar u sugjerua të vihej më shumë theksi në dy nga dimensionet e Edukimit Global: dimensionin e çështjeve dhe atë të brendshëm.

Zoti Bujar Basha, Drejtor i ISP dhe zoti Eduard Osmani, drejtor i Drejtorisë së Arsimit Tetëvjeçar në MASH formuluan vlerësime shumë pozitive rreth projektit, duke theksuar nevojën për një bashkëpunim institucional në realizimin e projektit si edhe nevojën për një vlerësim sa më tërësor të pilotimit (duke përfshirë vlerësimet e veçanta të Ekipit Qendror, ISP dhe MASH).

Konsulenti dhe Ekipi Qendror aprovuan përmbajtjen dhe shtrirjen e projektit në periudhën e Fazës së dytë 1999-2000 duke përfshirë objektivat e parashtruara në projekt-propozimin fillestar, sipas të cilit pilotimi do të vazhdonte në klasat 5, 6 dhe 7 dhe do të shtrihej në lëndët historike/jeografi dhe dituri natyre. U hartuan aktivitetet e pilotimit për klasën e pestë dhe të gjashtë. U zhvilluan dy seminare rreth cilësisë dhe përshtatmërisë së aktiviteteve për pilotim. Projekti u zbatua dhe vlerësua në gjashtë shkollat e zgjedhura.

2.2.3. Faza e dytë

Tetor 1999 - Zhvillohen dy trainime për 70 mësues, një trainim dy-ditor për mësuesit e rinj të Edukimit Global dhe një trainim katër-ditor i cili u përqëndrua dy ditë mbi Edukimin Global dhe dy ditë mbi një projekt të veçantë të Edukimit Mjedisor.

Shkurt 2000 – Mbahet një trainim për rreth 126 pjesëmarrës përfshirë mësuesit dhe drejtorët e shkollave

Mars 2000 – Bëhet një shërbim në shkollën e Edukimit Global në Kavajë (28.3) nga anëtari i Ekipit Qendror, S.Llambiri.

Prill 2000 – Bëhen shërbime nga anëtarët e Ekipit Qendror në shkollat e Edukimit Global në qytetet e mëposhtme:

1. Kavajë (18.4) nga F.Zenelaj dhe M.Gjokutaj
2. Elbasan (21.4) nga F.Zenelaj dhe S.Llambiri
3. Lezhë (25.4) nga F.Zenelaj, M.Gjokutaj, S.Llambiri dhe F.Myteberi

Maj 2000 – Bëhen shërbime në shkollat në qytetet e mëposhtme:

1. Korçë (10.5) nga F.Zenelaj, M.Gjokutaj, F.Myteberi
2. Elbasan (12.5) nga F.Zenelaj, M.Gjokutaj, F.Myteberi
3. Shkodër (16.5) nga F.Myteberi
4. Vlorë (17.5) nga F.Zenelaj, M.Gjokutaj, S.Llambiri
5. Kavajë (26.5) nga A.Bushati (UNICEF), dhe A.Dautaj, M.Gjokutaj dhe S.Llambiri
6. Durrës (26.5) nga A.Bushati, A.Dautaj, M.Gjokutaj, F.Zenelaj dhe S.Llambiri

Qershor 2000: Botohen (1000) fletëpalosje dhe 1000 postera (750 në shqip dhe 250 në anglisht) për tu shpërndarë në fillim të Fazës së Tretë.

Bëhet një shërbim në shkollën e Edukimit Global në Lezhë (6.6) nga A. Bushati dhe S.Llambiri.

2.2.4. Ritmi i shtrirjes nga Faza Përgatitore deri tek Faza e Katërt.

TABELA 1: SHTRIRJA E PROJEKTIT TË EDUKIMIT GLOBAL, 1997-2000

Viti	1997	1998	1999	2000
Rrethet	4	4	8	12
Shkolla	6	6	10	4
Mësuesit	24	28	88	126
Nxënësit	630	1250	5100	8090
Aktivitetet	23	73	123	Në vazhdim

2.3. ROLI I EKIPIT QËNDROR

Gjatë Fazës së Dytë, Ekipi Qëndror i përbërë nga specialistë të fushave të ndryshme të arsimit dhe nga mësues, bartës të përvojave lokale, vazhdoi të jepte mbështetjen si vijon:

1. Të përcaktonte mundësitë brenda kurrikulës për të ndërtuar një dimension të Edukimit Global.
2. Të përcaktonte përmbajtjen e materialeve mësimore në ndihmë të mësuesve dhe nxënësve.
3. Tu siguronte specialistëve të INEG informacion mbi përvojën dhe realitetin shqiptar.
4. Të ofronte ndihmë në hartimin e aktiviteteve të para dhe në rishikimin e tyre përfundimtar.
5. Të kontribuonte dhe bashkëpunonte në trainimin e mësuesve.
6. Të kontribuonte në procesin e pilotimit dhe vlerësimit të aktiviteteve.
7. Të interpretonte të dhënat e procesit të pilotimit dhe të përpunonte konkluzionet përkatëse.
8. Të siguronte konsulencë për vlerësuesen e jashtme për hartimin dhe shkrimin e raportit të mbarimit të fazës.

2.4. PROCESI I ZHVILLIMIT TË KURRIKULËS – MODULET E AKTIVITETEVE

Procesi i hartimit të moduleve të aktiviteteve pilot ka vazhduar duke përdorur të njëjtin proces hartimi si në Fazën e Parë. Siç ishte rënë dakord që në fillim të projektit, integrimi i koncepteve dhe modeleve të Edukimit Global vazhdoi të mbështetej mbi kontekstin shqiptar, por u zgjerua në Histori/Gjeografi dhe Dituri Natyre. U pilotuan aktivitete të reja dhe para shpërndarjes së plotë u futën vërejtjet dhe sugjerimet. Numri i aktiviteteve tregohet në Tabelën 2. Shtesat gjatë Fazës së Dytë tregohen me shkronja të zeza.

Tabela 2: Aktivitetet e Edukimit Global të Ndara sipas Lëndëve dhe Klasave

Lënda	Klasa 5	Klasa 6	Klasa 7	Gjithsej
Matematikë	14	2	19	16 + 19 = 35
Gjuhë Shqipe	24	18	13	42 + 13 = 55
Edukatë Qytetare	11	4 + 3	3	15 + 6 = 21
Dituri Natyre			9	9
Histori/Gjeografi	7			7
AKTIVITETE GJITHSEJ	28 + 7 = 35	26 + 3 = 29	44	127

Aktivitetet e reja ndoqën modelin e hartimit të aktiviteteve të mëparshme. Në aktivitetet e planifikuara u bë kujdes që të lidheshin temat e kurrikulës me temat e përshtatshme të Edukimit Global si të drejtat e njeriut, shëndeti mjedisor etj. Këto tema do të zhvilloheshin gjatë orëve 35-45 minutëshe të mësimi. Një listë e aktiviteteve të hartuara për çdo lëndë e klasë dhe aktivitete model ndodhen në shtojcën E.

Konsulenca e vazhdueshme e specialistëve kanadezë dhe përvoja e fituar gjatë fazës përgatitore ndihmuan në përmirësimin e aktiviteteve duke i bërë më të përshtatshme për realizimin e objektivave të Edukimit Global. Krahasuar me Fazën e Parë, aktivitetet e Fazës së Dytë ishin më të fokusuar dhe lidheshin më mirë me temat dhe çështjet globale. Në intervista dhe pyetësorë, mësuesit bënë komente mbi përputhjen e aktiviteteve të reja me kurrikulën. Informacioni nga ekipi kanadez sugjeronte se Ekipi Qëndror duhet të punojë akoma për zhvillimin e tërësisë së pjesëve të aktivitetit mbi “objektivat”, “burimet e nevojshme” dhe “potencialin e të nxënësit”. Në shtojcën F paraqiten matricat që tregojnë shpërndarjen e aktiviteteve nëpër dimensionet e Edukimit Global. Këto matrica u hartuan për vlerësimin e Fazës së Dytë dhe do t'i shërbejnë Ekipit Qëndror për të identifikuar boshllëqet në lidhjen e aktiviteve me faktorët e dimensioneve.

2.5. TRAINIMI I MËSUESVE

Mësuesit e zgjedhur për të marrë pjesë në Fazën e Dytë u trainuan në seminarët e mbajtur në Tetor 1999 dhe Shkurt 2000. Në këto 2 seminare të lehtësuara nga konsulentët kanadezë, mësuesit u njohën me teorinë dhe praktikën e Edukimit Global dhe me shembuj aktivitetesh. Seminarët e tjera u drejtuan pjesërisht ose tërësisht nga anëtarët e Ekipit Qëndror. Seminarët e fundit kishin si objektiv rritjen e njohjes së mësuesve me modulet e aktiviteteve dhe me instrumentat e vlerësimit të tyre.

Vëzhgimi nga ana e Ekipit Qëndror dhe kolegëve të mësuesve së bashku me feedback treguan se pavarësisht nga progresi i dukshëm i mësuesve në komunikimin me klasën dhe organizimin e punës me grupe, ndihet akoma nevoja për përmirësim në aspekte të tjera të zbatimit. Disa mësues kishin ende vështirësi për të luajtur rolin e tyre si moderatorë në të nxënit interaktiv dhe bashkëpunues dhe për të shfrytëzuar të gjitha mundësitë që ofronte aktiviteti. Mësuesit kishin nevojë për tu trainuar për të vlerësuar aktivitetet dhe për tu aftësuar për t'i përdorur ato në mënyrë krijuese. Ata kishin nevojë edhe për trainim të mëtejshëm për ta bërë punën në grupe më të hapur që nxënësit t'i kapin më shpejt mjetet që ata po përdorin tani në zgjidhjen e problemeve.

2.6. ZBATIMI

Zbatimi i Fazës së Dytë u bë në 10 shkolla, në 8 rrethe me pjesëmarrjen e gjithsej 5100 nxënësve. (Një listë e shkollave jepet në shtojcën D)

Të gjithë mësuesit u pajisën me aktivitetet e mëparshme dhe aktivitetet e reja që do të pilotoheshin në lëndët e zgjedhura. Mësuesit bënë pilotimin e aktivitetëve të reja duke ia përshtatur ato kushteve të klasës. Numri i aktivitetëve të mëparshme ose atyre të reja të zbatuara nga çdo mësues ndryshonte sipas lëndës. Numri i tyre ishte më i madh për mësuesit e matematikës dhe gjuhës shqipe dhe më i vogël për ata të edukatës qytetare. Kjo ndodhi për arsye të numrit më të madh të orëve në programet e matematikës dhe gjuhës shqipe (4–5 orë në javë) krahasuar me numrin e orëve të edukatës qytetare (1 orë në javë). Kështu një mësues matematike ose gjuhe zbatoi 5-10 aktivitete, ndërsa një mësues i edukatës qytetare zbatoi vetëm 2-5 aktivitete. Zbatimi vazhdon të bëhet në klasa me mesatarisht 30-35 nxënës; në raste të pakta numri i tyre shkonte në 40-45 nxënës.

Për të vlerësuar efikasitetin e aktivitetëve gjatë Fazës së Dytë dhe për të vlerësuar shkallën e realizimit të objektivave të projektit, mësuesve dhe nxënësve iu kërkua të plotësonin formularë dhe pyetësorë dhe të jepnin mendimet e tyre në intervista të bëra nga Ekipi Qëndror, detyra e të cilit ishte gjithashtu të ndiqte nga afër të gjithë procesin e pilotimit dhe zbatimit të projektit, si nëpërmjet intervistave me mësuesit e nxënësit ashtu edhe me anë të vëzhgimeve periodike në klasa. (Shih Gjetjet, Pjesa 3.0.)

2.7. VLERËSIMI

Për mbledhjen e të dhënave dhe për rritjen e shkallës së saktësisë dhe besueshmërisë u përdor strategjia e trekëndëzimit. Sipas kësaj strategjie, të dhënat u morën nga burime të ndryshme në intervale kohe të njëjta gjatë gjithë Fazës së Pilotimit. Ato u analizuan mbi bazën e një reference paralele të të gjitha burimeve. Në tabelën 3 poshtë “mësues pilot” i referohet atyre që pilotuan aktivitetet e reja dhe dhanë feedback vetëm për to. Instrumentat e përdorur për mbledhjen e të dhënave janë si më poshtë:

Tabela 3: Administrimi i Instrumentave të Vlerësimit

Nr.	Mjeti i marrjes së informacionit (të dhënave)	Burimi i informacionit (të dhënave)	Marrësi i informacionit (të dhënave)	Koha e marrjes së informacionit (të dhënave)
1	Intervista para pilotimit	Mësues pilot	Ekipi Qëndror	Para pilotimit
2	Intervista gjatë pilotimit	Mësues pilot	Ekipi Qëndror	Gjatë pilotimit
3	Intervista pas pilotimit	Mësues pilot	Ekipi Qëndror	Pas pilotimit
4	Ditaret	Mësues pilot	Mësues pilot	Gjatë pilotimit
5	Feedback i mësimit	Mësues pilot	Mësues pilot	Pas çdo mësimi
6	Feedback i mësimit	Nxënës	Nxënës	Pas çdo mësimi
7	Vëzhgime të mësimit	Mësues pilot	Ekipi Qëndror	Rastësore
8	Pyetësorë para pilotimit	Nxënës	Mësues pilot	Para pilotimit
9	Pyetësorë pas pilotimit	Nxënës	Mësues pilot	Pas pilotimit
10	Intervista në grup	Nxënës	Mësues pilot	Pas pilotimit
11	Intervista në grup	Mësues pilot	Ekipi Qëndror	Pas pilotimit
12	Përmbledhja dhe interpretimi	Ekipi Qëndror	Konsulentët, Ekipi Qëndror, UNICEF	Pas pilotimit
13	Intervista në grup	Ekipi Qëndror	David Selby, INEG	Pas Fazës së Parë
14	Intervista në grup	Ekipi Qëndror	David Selby, INEG	Pas Fazës së Dytë
15	Intervistat përfundimtare	Mësues, Drejtorë	Vlerësuesja e jashtme, EQ, UNICEF	Nëntor 2000
16	Intervista në grup	Nxënës	Vlerësuesja e jashtme, EQ, UNICEF	Nëntor 2000

Procesi i mbledhjes së të dhënave për Raportin e Fazës së Parë nuk ishte shumë i plotë për shkak të paafësisë së dukshme të mësuesve për t'iu përgjigjur si duhet pyetjeve të parashtruara. Kjo ishte e vërtetë edhe për përgjigjet e nxënësve. Në Fazën e Dytë pati një përmirësim, megjithatë vlerësuesja e jashtme mendon se formularët e vlerësimit duhen rishikuar që të ofrojnë pyetje, të cilat do të nxjerrin më qartë një përgjigje përshkuese ose sasiore në lidhje me eksperiencën e mësuesve dhe nxënësve dhe të nxënësit e përvehtësuar nga nxënësit. Pavarësisht nga kufizimet, qëndrueshmëria e të dhënave të mara nga të gjitha burimet mundësoi formimin e konkluzioneve cilësore mbi rezultatet dhe impaktin e tyre tek shkollat, mësuesit dhe nxënësit e përfshirë në Fazën e Dytë të projektit.

PJESA E TRETË:

GJETJET

3.1 PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE TË FAZËS SË DYTË

3.1.1. Nxënësit

1. Nxënësit u angazhuan aktivisht në kurrikulën e Edukimit Global dhe ka një sërë treguesish të ndryshimeve cilësore në përvojën e tyre në klasë si më poshtë:
 - a. Pjesëmarrje më e madhe në klasë.
 - b. Liri për t'u përfshirë në dialog dhe shkëmbim mendimi.
 - c. Përmirësim i shprehive të zgjidhjes së problemeve.
 - d. Përmirësim i aftësisë për të ndërtuar marrëdhënie.
 - e. Rritja e tolerancës ndaj ndryshimit.
 - f. Rritja e entuziazmit për të mësuar.
 - g. Rritja e vetëvlerësimit.
 - h. Rritja e pjesëmarrjes në procesin e tyre të të nxënit.
2. Në veçanti, nxënësit e dobët në mësim tregonin shenja të fuqizimit të shprehive të tyre mësimore dhe shoqërore.
3. Nxënësit ishin përfshirë në projekte që pasqyronin të kuptuarit në rritje të lidhjes së të tyre me botën përreth dhe përgjegjësinë e tyre personale në të.
4. Nxënësit përdornin gjuhën e forcës personale p.sh. “Unë mund ...” ,” ne mund të ndërtojmë një të ardhme më të mire duke...”
5. Nxënësit përdornin një vlerë për bashkëpunim konstruktiv, por nuk ishte e qartë sa mirë e kuptonin ata lidhjen me parimet e demokracisë apo nëse ata mund t'i përshkruanin metodat aktuale dhe mjetet e zgjidhjes së problemit që po përdornin.
6. Nxënësit dhe prindërit tregonin një rritje në sjellje dhe kapacitetin për komunikim konstruktiv.

3.1.2. Mësuesit

1. Mësuesit rritën shumë shkallën e tyre të lirshmërisë në zbatimin e Edukimit Global duke treguar se kyçi i saj janë trainimi i mirë dhe praktika.
2. Mësuesit ishin mjaft të motivuar në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në projekt. Një numër në rritje mësuesish jo të Edukimit Global kërkonin trainim.
3. Mësuesit thonë se metoda e Edukimit Global kërkon më shumë kohë dhe angazhim se mënyra e vjetër e mësimdhënies, por ata e pëlqejnë dhe besojnë se ajo ishte një ndryshim cilësor për nxënësit e tyre dhe ata vetë si profesionistë dhe qytetarë.
4. Mësuesit i angazhuan nxënësit dhe prindërit për të bashkëpunuar dhe gjetur mjetet e Edukimit Global.
5. Mësuesve u pëlqen metoda e punës në grup kaq e zakonshme për këtë projekt. Sidoqoftë, nuk dukej qartë nëse ata kishin zotëruar aspekte të caktuara të Projektit të Edukimit Global. Këto përfshijnë:
 - a. Aftësinë për të ditur se kur duhet zgjedhur puna në grup midis metodave të tjera të mësimdhënies dhe të të nxënit që ata mund të përdorin gjithashtu. Ekziston problemi i balancimit të metodave.
 - b. Aftësia për të integruar të nxënit nga puna në grup tek filozofia e Edukimit Global. Vëzhguesit shkruanin se mësuesit e përdornin rrallë “ndal-veprimin” ose kohën e përmbledhjes për të identifikuar lidhjen midis instrumentave të punës dhe praktikës dhe filozofisë demokratike ose bashkëpunuese.

- c. Akoma është në diskutim niveli i lirshmërisë së mësuesve për të integruar aktivitetet me praktikën e tyre personale në atë shkallë që ato do të dëshironin të eksperimentonin dhe modifikonin.
 - d. Mësuesit dukeshin të gatshëm për të bërë ndryshime të vogla në aktivitetet e përgatitura për ta, por shumë pak kishin ndërmarrë detyrën për të hartuar vetë aktivitetet.
6. Marrëdhëniet mësues/drejtor ishin forcuar dhe komunikimi i tyre është më i hapur.

3.1.3. Trainimi i mësuesve

1. Trainimi i siguruar nga INEG konsiderohej i shkëlqyeshëm dhe si shtulla themelore e suksesit praktik të këtij projekti.
2. Mësuesit shprehën dëshirën për trainim më të avancuar dhe më të shpeshtë.
3. Vëzhguesit ishin të mendimit se trainimi duhet të lidhet me çështjet e 3.1.1 më sipër.
4. Interes të veçantë kishte për hartimin e një modeli të Trainimit të Trainuesve për të përhapur më tej modelin e Edukimit Global.
5. Interes të veçantë kishte në të gjitha nivelet për futjen e Edukimit Global në universitetet e mësuesisë.

3.1.4. Burimet

1. Disa mësues (dhe nxënës) shpenzonin fondet e veta për sigurimin e burimeve të aktiviteve të Edukimit Global për shkak të mungesës së pajisjeve të tilla si kompjuter, futje në Internet dhe fotokopje.
2. Burimet e UNICEF-it ishin të paçmueshme për ta sjellë këtë projekt në fazën e fuqishme ekzistuese të zbatimit dhe zgjerimit potencial.
3. Mungonin një sërë tipesh burimesh si komplete bashkëkohore të materialeve për referencë si enciklopeditë dhe biblioteka të kompletuara, kompjuterat dhe futja në Internet, fotokopjet dhe televizorët apo videot.

3.1.5. Ndryshimi i sistemeve

1. Vlerësimi sasior i ndryshimeve në dijet dhe praktikën e nxënësve nuk qe i mundur për shkak të mungesës në praktikë në atë kohë të një vlerësimi uniform me notë.
2. Nxënësit ishin forca shtytëse për zgjerimin e Edukimit Global në shkolla.
3. Drejtorët mbështesnin fuqimisht zbatimin e Edukimit Global në shkollat e tyre duke siguruar mundësitë dhe mjete për mësuesit e Edukimit Global. Ata të gjithë kishin marrë pjesë në trainim. Ata mbështesnin gjithashtu trainimin e mësuesve jo të Edukimit Global dhe përhapjen e praktikës në klasat jo të Edukimit Global.
4. Edukimi Global po jepte kontributin e vet në përpjekjen e tanishme për reformën e kurrikulës në Shqipëri nëpërmjet një kuadri dhe shembulli të praktikave dhe filozofive të reja të Edukimit Global.
5. Përdorimi i një kohe pilotimi për aktivitetet e reja fuqizonte efektivitetin e aktiviteve. Sidoqoftë, ndihet akoma nevoja për më shumë punë për kompletimin e përshkrimeve të aktiviteve në lidhje me pjesët e “objektivave”, “burimeve të nevojshme” dhe “potencialit” të aktiviteve.
6. Ekipi Qëndror dhe disa mësues ishin të gatshëm të shkëmbenin dhe të ndanin përvojën e tyre me vendet e tjera që mund të zbatojnë Edukimin Global.
7. MASH dhe ISP vazhdonin t’i jepnin këtij projekti mbështetje të fuqishme morale. ISP vazhdonte t’i jepte kohë stafit të vet për të punuar për zhvillimin dhe zbatimin e këtij projekti. Të dy palët shprehën angazhimin për të mbështetur planin për pronësinë përfundimtare të këtij projekti nëpërmjet integritit të tij në sistemin arsimor shqiptar.

8. Dëshmitë subjektive tregonin se Edukimi Global ka çuar në përmirësimin e marrëdhënieve shkollë-komunitet ,megjithëse projekti ka ende nevojë të thellohet dhe zgjerohet përtej formës së tanishme.

3.2. PËRSHKRIMI I GJETJEVE KRYESORE TË VLERËSIMIT TË FAZËS SË DYTË

3.2.1. Nxënësit

Ky është një raport mbi gjetjet në lidhje me nxënësit në Projektin e Edukimit Global. Këto gjetje mbështeten mbi një analizë të 219 pyetësorëve të zgjedhur rastësisht nga 2199 pyetësorë të plotësuar nga një grup i rastësishëm nxënësish për të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë Fazës së Dytë dhe nga intervistat e bëra nga vlerësuesja e jashtme në Nëntor 2000.

Fleta feedback e nxënësit i jepte nxënësve 5 pyetje për përgjigje (shih Shtojcën B). Katër nga pyetjet ishin të hapura dhe kërkonin përgjigje cilësore. Pyetja e pestë u kërkonte nxënësve të rendisnin se sa u pëlqeu mësimi në një shkallë nga 1 (nuk më pëlqeu fare) deri në 4 (më pëlqeu shumë). Përgjigja mesatare e nxënësve është 3.74 në shkallëzimin 4 pikësh. Përgjigjet e pyetjeve cilësore përputheshin me përgjigjet e dhëna nga nxënësit, mësuesit dhe drejtorët gjatë intervistave të nëntorit duke dhënë tregues të fuqishëm se projekti i Edukimit Global po arrin rezultatet e synuara. Më poshtë vijon një përmbledhje e përmbajtjes së intervistave me grup nxënësish.

Pikëpamjet e Nxënësve mbi Orët e Mësimin të Edukimit Global: Nxënësit e vlerësonin shumë ndryshimin në stilin e mësimdhënies nga stili akademik i ngurtë që hasnin në të gjitha orët e mësimin para futjes së Edukimit Global. Ata thanë se tani ishin më të lirë për tu shprehur, kishin më pak frikë nga mësuesit, dhe mësonin më shumë nga njëri tjetri në grup se sa veçmas në modelin e mëparshëm. Ata shprehën ngazëllim dhe entuziazëm për procesin e të nxënësve. Ata besonin se ishin organizuar më mirë. Ata thanë se në orët jo të Edukimit Global në pjesën më të madhe ata përsërisnin çka u thonte mësuesi, ndërsa në orët e Edukimit Global nga ata pritej të zhvillonin dhe të jepnin mendimet e tyre mbi një çështje. Ata thanë se e përpunonin dhe e asimilonin më mirë informacionin. Ata e ndanin përvojën me entuziazëm me shokët e tyre dhe familjen jashtë orëve të Edukimit Global. Të gjithë nxënësit thanë se do tu pëlqente ta kishin Edukimin Global në të gjitha orët e mësimin.

Të nxënësve: Nxënësit dhanë shembuj se si kishin mësuar më shumë rreth vendit të tyre nëpërmjet orëve të Edukimit Global. Më e rëndësishmja, ata thanë se kishin mësuar rreth ndryshimeve dhe ngjashmërisë midis tyre dhe të tjerëve dhe si rrjedhojë besonin se ishin bërë më tolerantë dhe dëgjues më të mirë. Ata kishin përdorur përvojën e refugjatëve kosovarë si pjesë të agjendës së tyre të të nxënësve global, duke i ftuar fëmijët refugjatë në shkollë për të mësuar rreth përvojës së refugjatëve dhe duke ndarë të mirat materiale me to. Shumica e nxënësve thanë se nëpërmjet orëve të Edukimit Global ata kishin mësuar mbi të drejtat e njeriut si edhe mbi ligjet që i mbrojnë këto të drejta. Ata kishin zhvilluar disa aktivitete mbi lidhjen e së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes dhe besonin se kjo i kishte ndihmuar për të kuptuar rolin e përgjegjësive individuale në formimin e botës së tyre.

Disa nga punët e bëra nga nxënësit në këto aktivitete u panë nga ekipi i vlerësimit gjatë vizitave nëpër shkolla dhe u gjet se ishin tregues që mbështesnin vlerësimet e nxënësve për procesin e tyre të të nxënësve. Një prej tyre përqendrohej mbi një pus historik në qytetin e Durrësit. Nxënësit

kishin vizatuar se si dukej pusi dhe rrethinat e tij ashtu siç i kujtohej prindërve dhe gjyshërve të tyre para shkatërrimit të 91' dhe 97'. Seria e dytë e vizatimeve ishte për pusin dhe rrethinat e tij sot, siç e shohin vetë nxënësit, mbuluar me plehra, barishte e papastërtira. Seria e tretë e vizatimeve ishte paraqitje individuale se si do të dukej pusi dhe rrethinat e tij në të ardhmen, nëse njerëzit do të kujdeseshin për ta ringjallur atë si një monument arkeologjik të qytetit. Nxënësit pohuan se ky ushtrim vërtetonte se e ardhmja ishte në duart e tyre. Një nxënës tha: “Në qoftë se ne mund të ndryshojmë klasën, atëherë ne mund të ndryshojmë të ardhmen tonë.”

Pikëpamjet e Nxënësve mbi Nxënësit e Dobët në Mësime: Nxënësit pohuan se nxënësit që kishin qenë më të dobët në mësime apo më të ndrojtur tashmë ishin integruar në aktivitetet e klasës. Sipas këndvështrimit të nxënësve, rezultati ishte se nxënësit e dobët po mësonin më shumë dhe ishin shumë më aktivë. Ata kishin fituar vetëvlerësimin dhe flisnin më shumë. Një nga këta nxënës kishte thënë: “*Edhe unë jam diçka. Edhe unë jam dikushi.*” Disa nxënës vunë në dukje se para orëve të Edukimit Global nxënësit e mirë nuk i linin rast nxënësve të dobët për të marrë pjesë. Përvoja e Edukimit Global e ndryshoi këtë si brenda edhe jashtë klasës. Një nxënës shkruante se përvoja e Edukimit Global u tregoi atyre se dobësia tek njëri pasqyrohet tek të tjerë, dhe kjo i inkurajoi ata të punonin më shumë. Një nxënës tjetër tha: “*Kur punojmë në grup ne punojmë për njëri tjetrin ndërsa në mënyrën tradicionale, kjo është më individuale dhe ndoshta më egoiste.*”

Përfitimi i Nxënësve në Këndvështrim: Të gjithë nxënësit e intervistuar besonin se kishin përgjegjësi personale për mjedisin, për paqen, lagjen dhe familjen e tyre. Ata ia atribuonin këtë ndryshim pjesëmarrjes në orët e Edukimit Global. Edukimi Global i ndihmonte ata të kuptonin se çdo individ ka rol dhe përgjegjësi në shoqëri. Një nxënës tha se orët e Edukimit Global i kishin ndihmuar të largonin “*pesimizmin tradicional shqiptar*” për të ardhmen. Ajo tha se kjo pikëpamje është “*pengesa më e madhe në jetën tonë. Ajo nuk do të na ndihmojë të ecim përpara. Në qoftë se ne e humbasim pesimizmin, ne mund ta ndihmojmë Shqipërinë të ecë përpara.*” Të gjithë nxënësit përdornin gjuhën e fuqizimit; p.sh. Unë mund të ndryshoj, Ne mund ta ndryshojmë jetën tonë. Si rezultat i Edukimit Global, ata panë dhe provuan një proces më demokratik dhe ata kërkonin më shumë. Ata besonin se jo vetëm kishin mësuar se cila ishte sjellja e drejtë, por në mënyrë konstruktive ishin në gjendje të kuptonin se çfarë po bënin gabim dhe si mund ta ndreqnin atë. Siç tha një nxënës: “*Nëqoftëse ne jemi nxënës të mirë dhe mësojmë shumë, kjo nuk do të ndikojë vetëm në jetën tonë, por edhe në atë të vendit tonë. Ne do të jemi në gjendje të krijojmë një të ardhme më të mirë për vendin tonë.*”

Nxënësit dhe Familjet: Nxënësit përshkruanin marrëdhënie më bashkëpunuese brenda familjeve të tyre dhe në biseda me prindërit. Ata shkruanin se po përqeshin ta shtrinin ndikimin që kishin në klasë tek familjet dhe fqinjët. Shumica besonte se familjet kishin ndryshuar qëndrim ndaj tyre sepse ata, nxënësit, tregonin një sjellje më shumë përgjegjëse. Shumica e tyre besonte se Edukimi Global ishte bërë pjesë e jetës së tyre të përditshme. Disa nga nxënësit thanë se mësimet mbi pastrimin e mjedisit ishin shndërruar në sjellje të zakonshme në shtëpi.

Nxënësit mbi Bashkëpunimin: Nxënësit besonin se mund të arrijnë në zgjidhje më të mira duke përdorur bashkëpunimin sepse kështu janë në gjendje të shqyrtojnë të gjitha mendimet. Në çdo shkollë pati të paktën një nxënës i cili citoi thënien e vjetër shqiptare “*Bashkimi bën fuqinë*”. Ata besojnë se bashkëpunimi është e ardhmja e tyre. Ai do të influencojë pozitivisht marrëdhëniet e tyre në punë, marrëdhëniet në familje dhe të ardhmen e vendit të tyre. Një nxënës tha: “*Ne kemi dëgjuar se Shqipëria është prapa për shkak të ndarjeve politike të brendshme. Ndoshta, në qoftë se fëmijët mësojnë bashkëpunimin në shkollë, ata do ta praktikojnë atë më vonë.*” Po kështu, një

drejtor dha një shembull të ndikimeve të bashkëpunimit kur një mësues kishte bërë një konkurs duke përdorur një model të Edukimit Global, në të cilin secili fitoi diçka. Ai tha se ndonjëherë në konkurset tradicionale nxënësit largoheshin me lotë në sy sepse kishin punuar shumë dhe kishin humbur, ndërsa tani kjo nuk ndodh më.

Drejtorët dhe Mësuesit mbi Nxënësit: Drejtorët dhe mësuesit kanë parë se nxënësit e tyre kanë përfituar nga pjesëmarrja në Projektin e Edukimit Global si më poshtë:

1. Nxënësit ishin më miqësorë që dukej nga ndërtimi i marrëdhënieve më të mira dhe më të forta me njëri tjetrin,
2. Nxënësit mësonin dhe praktikonin sjellje më bashkëpunuese me njëri tjetrin siç dukej nga praktika e tyre e sukseshme e punës në grupe,
3. Nxënësit mësonin për njerëz dhe vende të ndryshme në atdheun e tyre, gjë që kontribuon në rritjen e njohurive dhe tolerancës ndaj ndryshimit siç tregohet nga rritja e durimit ndaj njëri tjetrit në dialog,
4. Nxënësit tregonin një rritje të vetë-vlerësimit dhe shpalosnin më shumë personalitet (prani personale) brenda dhe jashtë klasës,
5. Nxënësit i shprehnin lirshëm dhe hapur mendimet e tyre dhe,
6. Nxënësit mësonin mendimin logjik dhe kritik dhe tregonin aftësinë për të vlerësuar argumentat dhe mendimet e njëri tjetrit me dhe pa ndihmën e mësuesit.

Në të gjitha rastet, mësuesit dhe drejtorët thanë se nxënësit i kërkonin mësuesve dhe drejtorëve shtrirjen e Projektit të Edukimit Global. Ata besonin se programi ndihmonte veçanërisht nxënësit e dobët gjë që tregohet nga rritja e pjesëmarrjes së tyre në aktivitetet në klasë dhe nga aftësia e tyre e sapoformuar për të kontribuar në të nxënësit në klasë. U vu re se nxënësit i donin mënyrat e larmishme në të cilat ata lejoheshin të shprehnin atë që kishin mësuar p.sh. shkrim, vizatim, raportimi me gojë, poezi etj. Edhe pse mësuesit dhe drejtorët flisnin për kohën që duhet të shpenzonin për të gjetur mjetet për disa aktivitete, ata lëvduan nxënësit dhe prindërit për ndihmën e tyre në gjetjen e mjeteve të nevojshme. Tregues subjektivë bënë të qartë se kërkimi i mjeteve iu duk mësuesve, nxënësve dhe prindërve një përvojë e pasur dhe shpërblyese. Mësuesit vunë re se nxënësve nuk u pëlqeu zurma e punës në grup në fillim, por ata janë mësuar disi me të. Mësuesit dhe drejtorët pohuan se nxënësit në orët e mësimit të Edukimit Global i përmirësuan notat, por ky është vetëm tregues subjektiv, meqenëse sistemi shqiptar i vlerësimit me notë nuk ndjek standarte uniforme të zbatuara në mënyrë të barabartë tek të gjithë nxënësit.

3.2.2. Mësuesit

Plotësimi i formularëve C dhe D para dhe pas pilotimit të aktiviteteve u bë nga një numër i vogël mësuesish. Pas përfundimit të çdo aktiviteti, të gjithë mësuesit plotësuan formularin G, fletën e feedback të mësuesit (shih shtojcën B). Përgjigjet në to përputheshin me ato të dhëna nga mësuesit dhe drejtorët në intervistat e nëntorit. Mësuesit besonin se aktivitetet i shërbenin qëllimeve të kurrikulës. Para zbatimit mësuesit ndanë shqetësimet rreth organizimit të klasës, kohës së pamjaftueshme për të zhvilluar aktivitetin dhe pjesëmarrjes së nxënësve. Shpresat e tyre para zhvillimit të aktivitetit përfshinin përmirësimin e punës, pjesëmarrje më të madhe të klasës dhe efikasitet në mësimdhënie. Pas zbatimit, mësuesit ndjenin përmirësim të organizimit të klasës; ata ishin habitur dhe kënaqur nga niveli i pjesëmarrjes së nxënësve; besimi i tyre tek nxënësit ishte rritur. Mësuesit lavdëruan punën e bërë në seminarët e trainimit dhe thanë se kishin përfituar shprehi të reja nga feedback të mësuesit. Të gjithë mësuesit besonin se koha për të zhvilluar aktivitetin është e mjaftueshme, se ata ishin në gjendje të realizonin objektivat e mësimit dhe të ndiqnin me lehtësi hapat e aktivitetit.

Motivimi i Mësuesve: Proçesi i zgjedhjes së mësuesve ishte një kombinim i mësuesve që dolën vullnetarë dhe atyre që zgjodhën drejtorët duke besuar se ata do të ishin të interesuar. Kjo rezultoi në një kuadër mjaft të motivuar të mësuesve të Edukimit Global. Mësuesit morën pjesë bashkë me anëtarët e Grupit Qendror në hartimin dhe rishikimin e shumë aktiviteteve, megjithëse ata ende përdornin aktivitete të hartuara kryesisht nga Ekipi Qendror. Mësuesit e intervistuar shpesh kishin pasur një lloj trainimi të punës në grupe dhe disa prej tyre e kishin përdorur punën në grupe në klasë para trainimit të Edukimit Global.

Përfitimet e Mësuesve nga Projekti: Një drejtor tha: “Mësuesit nuk janë më skllëvër të teksteve.” Në një shkollë mësuesit kishin binjakëzim me shkolla në Itali, Greqi dhe Suedi gjë që kishte zgjeruar horizontet e tyre të mësimdhënies. Ata që kohët e fundit kishin shkuar bashkë me nxënësit për një vizitë në Suedi, kishin mësuar për projekte të reja që mund t’i zbatonin me nxënësit e tyre. Mësuesve u pëlqente pjesëmarrja më e madhe e nxënësve të tyre, dhe e shihnin veten si bashkë-nxënës dhe bashkëpunëtorë me nxënësit. Mësuesit nuk i kritikonin hapur nxënësit e veçantë; ata preferonin të nxirrnin nga klasa përgjigjet e sakta të pyetjeve apo problemeve ,gjë që i lejonte nxënësit me përgjigje jo të sakta për të mësuar nga të tjerët pa u sikletosur. Kjo përputhet me vëzhgimet në klasë të vlerësueses. Mësuesit vlerësonin shumë pjesëmarrjen në një nivel më të lartë dhe të mësuarit më shumë të nxënësve të dobët. Ata thanë gjithashtu se nxënësit zhvilluan një bazë më të gjerë miqësie duke dalë nga korniza : nxënësit e “mirë” përballë nxënësve të “këqinj”.

Mësuesit besonin se tani, nëpërmjet trainimit të Edukimit Global janë më të përgatitur për të bërë punën e tyre dhe njëri prej tyre tha: *“O Zot, si kemi mundur të jepnim mësim në mënyrën e vjetër akademike?!“* Drejtorët shprehën kënaqësinë dhe vlerësimin e tyre të madh për angazhimin e thellë të mësuesve për një të nxënë më të mirë e më cilësor të nxënësve. Ata theksuan se kjo merrte më kuptim duke ditur shkallën e ulët të pagesës së mësuesve. Kur u pyetën për rezistencë nga mësuesit, të gjithë drejtorët thanë se nuk kishin patur asnjë të tillë nga mësuesit e tyre, përveçse një frikë të vogël në fillim për të praktikuar diçka të re. Në fillim, disa mësues ndiheshin të mbingarkuar nga detyrat e reja, por nga fletët e feedback dhe raportet e mësuesve dhe drejtorëve të intervistuar duket se kjo ndjenjë i ka mbetur së shkuarës. Megjithatë është e rëndësishme të shënohet se shumica bënë komente mbi punën shtesë që i kërkohet mësuesit të Edukimit Global për gjetjen e burimeve për aktivitetin jashtë teksteve. Një drejtoreshë citon një nga mësueset e saj të kishte thënë: *“Përgatitja është e lodhshme. Unë lodhem, por ndjehem e lumtur duke bërë këtë punë.”* Kjo drejtoreshë thotë se: *“Një mësues i Edukimit Global tani punon më shumë në shtëpi dhe më pak në klasë.”*

Mësuesit, përfshirë edhe ata jo të Edukimit Global, e pëlqenin aspektin e punës në grupe që i jepte mundësi më shumë nxënësve për të marrë pjesë dhe folur. Mësuesit pëlqenin balancën e zhvillimit të shprehive praktike dhe rritjes së njohurive që kombinon Edukimi Global. Edukimi Global lejon zgjerimin e lëndës. P.sh. një mësim gjuhe dhe leximi përfshinte gjeografinë, etnografinë, antropologjinë, folklorin etj. Mësuesit panë se po përdornin një tip të ndryshëm, më të hapur të organizimit të klasës si rezultat i Edukimit Global dhe tani ndiheshin mirë me të.

Edukimi Global solli demokratizimin e procesit mësimor. Të gjithë mësuesve të intervistuar u pëlqente iniciativa e integritit që po ndodhte në sistemin arsimor shqiptar dhe ata besonin se projekti i Edukimit Global përputhej shumë me këtë iniciativë dhe me trainime të tjera që kishin pasur, p.sh. Mendimi Kritik i Soros-it, punë të tjera në grup dhe zgjidhja e konflikteve. Një

mësuese tha se ajo besonte se zbatimi i Edukimit Global “është një ndryshim cilësor i mënyrës me të cilën japim mësim”

Mësuesit në fazën e pilotimit dhe mësuesit e intervistuar të Edukimit Global dhe jo të Edukimit Global u pyetën se cilat mendonin se ishin cilësitë e një mësuesi. Ata dhanë të gjithë përgjigje të ngjashme dhe të gjithë e shihnin mësuesin si një lloj moderatori apo lehtësuesi më shumë se sa si modeli i vjetër i mësuesit si lektor dhe përçues i informacionit. Shumica përmendën se mësuesit duhet të mësojnë nga nxënësit e tyre ashtu siç mësojnë nxënësit prej tyre, tregues ky se mësuesit po fillojnë ta shohin veten si nxënës të përjetshëm, një nga objektivat e Edukimit Global. Mësuesit besonin se roli i shkollës ishte krijimi i qytetarëve globalë më të përkushtuar, veçanërisht nëpërmjet kurseve të Edukatës Qytetare. “Nxënësit me një bazë dijesh të shëndoshë dhe edukim të mirë qytetar e lehtësojnë punën e mësuesit, -tha një mësuese.

Treguesit e ndryshimeve në tipin e metodave të përdorura të mësimdhënies ishin të qartë nga llogaritë e bëra nga vëzhguesit mbi sasinë e kohës që shpenzojnë tani mësuesit në procese të ndryshme të mësimin. Tabela 1 më poshtë jep një paraqitje grafike të ndarjes së kohës nxënës-mësues në klasë.





Tabela 2 poshtë, tregon rritjen e kohës që shpenzojnë tani nxënësit në punën në grupe dhe në veprimtari të të gjithë klasës (57%) përkundërt sasisë së kohës së shpenzuar në veprimtari individuale të tilla si dëgjimi dhe puna në bankën e vet (43%). Shifrat në të dyja tabelat bazohen mbi perceptimin subjektiv të vëzhguesve, por duken se vërtetojnë perceptimin e mësuesve dhe nxënësve rreth ndryshimeve që po pësojnë në praktikë.



Kontributi i Projektit në Jetën e Mësuesve: Kontributi personal në jetën e mësuesve përfshinte marrëdhënie më të mira e më të hapura me fëmijët e vet. Një mësuese tha se krahas kontributit që Edukimi Global i kishte dhënë në jetën e saj profesionale në shkollë, ajo po punonte edhe me fëmijët e saj duke përdorur disa strategji të Edukimit Global si edhe po interesohej për të krijuar një shoqatë arsimore për të drejtat e njeriut.

Pikëpamja e Nxënësve për Mësuesit: Nxënësit kishin vënë re ndryshim midis mësuesve të Edukimit Global dhe atyre jo të Edukimit Global. Ndërkohë që të gjithë nxënësit dukeshin se i respektonin të gjithë mësuesit e tyre dhe e ndienin se ata ishin të përgatitur, ata preferonin të ishin në orët e Edukimit Global sepse mësuesit aty nxisnin pjesëmarrje më aktive të klasës, ndërsa të tjerët ishin më shumë si “udhëheqës” dhe përqëndroheshin më shumë tek notat. Nxënësit e Edukimit Global e shihnin se mësuesit i respektonin të drejtat e tyre si nxënës dhe qytetarë. Mësuesit e Edukimit Global e bënë shkollën argëtuese dhe fëmijët dëshironin të vinin në klasë, ndërsa në të njëjtën kohë ata vërenin se këta mësues ishin më të organizuar dhe orët e tyre drejtoheshin më mirë. Mësuesit e Edukimit Global i trajtonin ata si “shokë”. Në shkollat shqiptare kjo marrëdhënie midis mësuesit dhe nxënësit duket se lidhet fort me trajtimin nga mësuesi të nxënësit si koleg në të mësuar dhe hapja dhe inkurajimi i mësuesve ndaj fëmijëve shpreh mendimet e tyre kundër ndarjes së ngurtë midis nxënësit dhe mësuesit që ndodh në modelin tradicional jo shumë elastik. Në klasë u vu re një respekt maksimal i nxënësve për autoritetin e mësuesit. Disa nxënës thanë se disa nga mësuesit jo të Edukimit Global po përpiqeshin të përdornin aktivitetet dhe metodat e Edukimit Global në orët e tyre dhe nxënësit e vlerësonin këtë.

Pikëpamja e Mësuesve jo të Edukimit Global: Mësuesit jo të Edukimit Global janë të informuar për Edukimin Global dhe shpesh shkojnë në drejtori për të kërkuar leje për të zbatuar aktivitetet e

Edukimit Global në klasat e tyre. Shpesh ata që nuk ishin zgjedhur as për fazën e parë dhe as për fazën e dytë pyesnin: ”Pse jo?” dhe donin të dinin se kur do të trainoheshin. Trainimi kërkohej nga shumica e mësuesve. Një drejtor tha: “Mësuesit e mi kanë oreks për këtë.” Të tre mësuesit e intervistuar jo të Edukimit Global e njihnin projektin. Ata kishin dëgjuar për të nga drejtorët, kolegët dhe nxënësit e tyre. Që të tre po përpiqeshin të zbatonin disa komponentë të Edukimit Global ose punës në grup në klasat e tyre edhe pse ende të patrainuar. Të katër shkollat e kishin rritur numrin e mësuesve të Edukimit Global përtej atyre të trainuar zyrtarisht. Mësuesit e Edukimit Global po e shtrinin vullnetarisht përvojën e tyre në lëndë dhe klasa të tjera krahas atyre të shënuara fillimisht në projekt. Ata po trainonin kolegët e tyre vullnetarisht.

Të gjithë mësuesit dhe drejtorët kërkuan me forcë zgjerimin e programit sipas planit në klasat 1-4 dhe lëvizjen drejt shtrirjes së programit në të gjitha shkollat.

3.2.3. Trainimi i Mësuesve, e Shkuara, e Tashmja dhe e Ardhmja

Trainimi Zyrtar i Edukimit Global: Mësuesit ishin shumë të impresionuar nga seminaret trainuese të Edukimit Global. Ata thanë se drejtuesit e seminareve ishin të përgatitur shumë mirë. Ata të gjithë bënë komente mbi balancën midis aplikimit praktik dhe shtyllave teorike të projektit. Vënia e mësuesve në rolin e nxënësve konsiderohej nga shumica si një mjet të nxëni me shumë vlerë. Të gjitha shkollat përdornin mësuesit e trainuar para 3-4 vjetësh për të siguruar trainimin dhe këshillimin e mësuesve më të rinj. Një nga mësuesit veteranë të Edukimit Global tha: “*Trainimi ishte baza e suksesit të mësuesve.*”

Trainimi jo Zyrtar i Edukimit Global: Drejtorët dhe mësuesit organizonin trainime për mësuesit jo të Edukimit Global në shkollat e Edukimit Global dhe inspektorët punonin po me këta drejtorë dhe mësues për të bërë trainime dhe këshillime të mësuesve në shkollat e tjera. Këto ndodhi “trainimi” ishin përdorimi i videos, modelimi, loja në role dhe vëzhgimi. Kjo ngre çështjen e besnikërisë ndaj qëllimit origjinal të trainimit në seminar, d.m.th. a e riprodhon ky trainim në mënyrë besnike trainimin fillestar? Një drejtoreshë i ka kaluar të gjitha trainimet dhe është anëtare e Ekipit Qëndror, kështu që ndihet e kualifikuar për të trainuar në Edukimin Global.

Trainime të Tjera: Pothuajse të gjithë të intervistuarit kishin marrë trainim mbi Mendimin Kritik nga SOROS-i dhe trainime të tjera për punë në grupe. Të gjitha këto trainime ishin sipas tyre të pajtueshme me Edukimin Global. Një mësuese ishte angazhuar në programin e të mësuarit në distancë, i cili përfshinte punën në grupe me kolegët vendas. Një tjetër ishte trainuar në Shoqatën Shqiptare të të Drejtave të Njeriut.

Nevojat e Trainimit të Mësuesve in-service: Mësuesit kërkonin më shumë aktivitete dhe trainim për zbatimin e tyre. Ata besonin se trainimet duheshin bërë më shpesh për të vazhduar përforsimin e shprehive dhe për të prezantuar shprehi të reja. Rekomandimi i përgjithshëm ishte një ose dy herë në muaj. Mësuesit, drejtorët dhe anëtarët e Ekipit Qendror rekomanduan komponentin e certifikatës. Mësuesit do të donin të merrnin me vete në shtëpi një manual trainimi që do të përfshinte aktivitetet dhe një përshkrim të proceseve që mësuan. Për shkak të rritjes së trainimit shoqërisht që i bëhet mësuesve të rinj nga mësuesit e Edukimit Global, mendohet se është koha për të hartuar një Trainim të Trainuesve për të siguruar besnikërinë ndaj synimit fillestar të trainimit dhe për të krijuar kapacitetin vendas për shtrirjen dhe futjen e Edukimit Global. Disa sugjeruan një sistem rishikimi dhe feedback nga ana e kolegëve ofruar në frymën e përmirësimit të punës së njëri-tjetrit.

Nevojat e Trainimit të Mësuesve të Ardhshëm (pre-service): Gjatë intervistave doli qartë se një hap shumë i nevojshëm për shtrirjen dhe mbështetjen e Projektit të Edukimit Global në sistemin arsimor shqiptar do të jetë trainimi i studentëve të mësuesisë në universitete. Ekipi i vlerësimit bëri një vizitë në Universitetin Aleksandër Xhuvani në Elbasan dhe takoi një grup prej 6 dekanësh e drejtuesish. Në Elbasan ka një shkollë të Edukimit Global, dhe stafi i universitetit e njihte projektin. Grupi vuri në dukje se ky universitet po punonte për rishikimin e kurrikulave dhe metodave të trainimit të mësuesve për t'iu përshtatur inisiativës së integritimit në sistemin shqiptar. Ata e mbështetën fuqimisht këtë lëvizje dhe shprehën interesin e tyre për tu bërë partnerë me UNICEF-in dhe ISP-në në zgjerimin e fushës së Projektit të Edukimit Global. Grupi vendosi të planifikonte mbledhje mbi hapat e tjera të mundshme në fillim të vitit 2001.

3.2.4. Drejtorët Sigurojnë Mbështetje

Mësuesit e intervistuar, si të Edukimit Global edhe jo të Edukimit Global, besonin se drejtorët e tyre ishin shumë mbështetës të zbatimit të projektit. Mësuesit besonin se kyçi i lirshmërisë dhe zbatimit siç duhet të Edukimit Global është praktika konstante dhe drejtorët po u jepnin mundësi të bollshme për këtë. Një drejtor kishte ngritur një mini-këshill pedagogjik me mësues të Edukimit Global edhe jo të Edukimit Global për të parë zhvillimin e kurrikulës.

Një drejtor theksoi se përfitimet e mësuesve dhe nxënësve të tij e ndihmonin edhe atë për të punuar më mirë si drejtor dhe qytetar. Ai ishte një projekt pozitiv për të gjithë drejtorët dhe kishte ndryshuar rrjedhën e komunikimit dhe marrëdhënieve midis drejtorëve dhe mësuesve. Në çdo shkollë ekzistonte një politikë e “dyerve të hapura” (për në zyrën e drejtorit). Sipas një drejtori, ai rriti tolerancën në marrëdhëniet me mësuesit. Disa nga drejtorët jepnin orë të Edukimit Global dhe të gjithë kishin marrë pjesë në seminarët e trainimit. Pjesëmarrja çoi në një hapje të marrëdhënieve të tyre me fëmijët e vet. Drejtorët po inkurajonin dhe mbështesnin përdorimin e Edukimit Global në orët jo të Edukimit Global nga mësues jo të Edukimit Global madje pa një shtrirje zyrtare, si edhe në klasat 1-4 megjithëse këto klasa nuk do të përfshihen në program para Fazës së Tretë. Një drejtor tha se projekti i kishte zgjeruar horizontin dhe se atij i duhej të lexonte më shumë për tu përgatitur për orët e Edukimit Global.

Siç u përmend më parë, një shkollë kishte bërë binjakëzim me shkolla në Greqi, Itali dhe Suedi. Kohët e fundit një grup nxënësish, mësuesish dhe drejtori kishin bërë një udhëtim në një shkollë të Suedisë. Në disa raste drejtorët thanë se kishin ofruar klasa të tjera ose mundësinë për të kombinuar dy orë mësimi për të zgjeruar orët e Edukimit Global. Një drejtor kishte siguruar një dhomë “sekrete” ku nxënësit të mund të shkonin të votonin për një projekt të Edukimit Global mbi votimet. Të gjitha shkollat i ruanin punët e nxënësve. Në një rast, drejtori i kishte ruajtur të gjitha punët e nxënësve dhe përshkrimet e aktiviteteve të nxënësve me rregull në dosje që mbahen në zyrën e tij. Inspektori i Drejtorisë Arsimore të Rrethit i merr ato herë pas here për t'ia paraqitur mësuesve të tjerë të Edukimit Global të rrethit, dhe drejtori është shumë i merakosur që t'ia kthejnë në gjendje të mirë! Një drejtor kishte planifikuar një trainim të Edukimit Global për mësuesit e matematikës në të gjithë rrethin për në fund të Nëntorit 2000 dhe një aktivitet tjetër për mësuesit e një lënde tjetër në Mars 2001.

3.2.5. Edukimi Global dhe Nisma e Reformës së Kurrikulës

Disa nga të intervistuarit komentuan se kurrikula ekzistuese nuk lë vend për shumë fleksibilitet. Disa prej të intervistuarve thanë se kishte një kontradiktë ose mospërputhje midis kurrikulës

ekzistuese të kërkuar siç ishte hartuar dhe zbatuar dhe zbatimit të Edukimit Global dhe projekteve të tjera të ngjashme. U pranua se Ministria duhet ta ndryshojë këtë nga sipër dhe shumë ishin të ndërgjegjshëm se kjo reformë kishte nisur, por do të duheshin edhe disa vite. Mungesa e fleksibilitetit në tekstet shkollore dhe mungesa e teksteve alternative e bënte më të vështirë se sa duhet futjen e aktiviteteve të Edukimit Global në klasë. Pavarësisht nga këto vëzhgime, të gjithë thanë se mësuesit ishin në gjendje të punonin rreth kurrikulës në mënyra krijuese që i lejonin atyre të zhvillonin aktivitete të Edukimit Global dhe në të njëjtën kohë, të plotësonin objektivat e kurrikulës ekzistuese zyrtare.

3.2.6. Përmirësohen marrëdhëniet Shkollë-Komunitet

Në një shkollë nxënësit kishin pikturuar nëpër mure për të zëvendësuar shgarravinat. Kjo shkollë kishte organizuar pastrimin e oborrit të shkollës gjë që vazhdojnë ta bëjnë rregullisht. Prindërit i kishin dhuruar shkollës një shatërvan në hyrje të saj dhe kujdeseshin për muret rrotull shkollës. Drejtori tha se vandalizmi ishte ndalur. Prindërit kishin mbështetur ndërtimin e një sere dhe e kishin furnizuar me bimë. Nxënësit kishin botuar një gazetë të vetën dhe pastaj ndihmuan prindërit për të botuar një të tyren. Me paratë nga shitja e gazetave, ata blenë tuba uji dhe instaluan ujin për serën. Aktivitete të ngjashme ishin zhvilluar edhe në shkolla të tjera. Një drejtoreshë tha se asaj do t'i pëlqente të bënte përpjekje më të bashkërenduara për tu shtrirë në komunitet dhe për t'i folur atyre rreth projektit. Megjithatë, në këtë shkollë prindërit vinin për pastrimin e shkollës në verë. Ajo kishte marrë disa nxënës të Edukimit Global dhe prindër në një ekskursion në malin e Dajtit për një mësim mbi mjedisin në gjeografi dhe për argëtim. Mësuesit raportuan se nxënësit e tyre ishin përfshirë aktivisht në projekte të komunitetit si dita e pastrimit, ndërgjegjësimi ndaj plehrave, pastrimi i oborreve të shkollave. Dy nga shkollat kishin klube “Ekologjie” që kishin rezultuar nga përvoja e tyre e Edukimit Global. Këto klube punonin për pastrimin e oborreve të shkollave, mbjelljen e pemëve dhe sigurimin e luleve për të gjitha klasat dhe korridoret që ndërtesa e shkollës të lulëzonte. Një mësuese tregoi një ndodhi rreth një nxënëseje të Edukimit Global e cila, pas një shiu të rrëmbyer, kishte dalë dhe kishte filluar të hiqte baltën nga trotuari para shtëpisë së saj. Nëna e saj donte që të hynte brenda se mos merrte ndonjë të ftohtë, por nxënësja tha: *“Në qoftë se nuk e bëj unë, as të tjerët nuk do ta bëjnë”*. Ajo vazhdoi punën, dhe më vonë dolën edhe të tjerë dhe e hoqën baltën me lopatë.

Përpjekje të tilla ishin tregues se nxënësit e kanë kapur qëllimin e Edukimit Global sipas të cilit pjesëmarrësit do të fillojnë ta kuptojnë lidhjen e tyre me cilësinë e jetës së tyre dhe do të fillojnë të veprojnë mbi këtë lidhje në mënyra konstruktive. Sipas një nxënësi të intervistuar mbi këtë temë, *“Kushtet e mjedisit janë pasqyrimi i kulturës së një populli.”* Sidoqoftë, në thellimin e filozofisë së Edukimit Global në sistemin arsimor shqiptar, testi i vërtetë do të jetë përfshirja e nxënësve në veprimtari shërbimi në shkollë e komunitet. Veprimtari të tilla mund të përfshijnë qeverinë reformuese të nxënësve, punën me projekte komuniteti për të zhvilluar burimet dhe politikën nga drejtuesit e komunitetit për të mbështetur pastrimin e vazhdueshëm të lagjeve, ose punën me projekte që bashkojnë qytetarët më të moshuar me të rinjtë për interesa të përbashkëta.

3.2.7. Rritet Përfshirja e Prindërve

Prindërit tani shiheshin si më të interesuar në mënyrë aktive në të nxënësit e fëmijëve të tyre. Ata po e mbështesnin programin sepse në të vërtetë donin të ndihmonin fëmijët të mësonin. Ata bënë shumë pyetje për fëmijët e tyre dhe shkollat. Prindërit ndihmonin për mbledhje dhe dhurimin e mjeteve për orët e mësimi, përfshirë dhënien hua të televizorëve ose videove, pagesën e posterave etj. Drejtorët thanë se më shumë prindër, fëmijët e të cilëve nuk ishin në klasat e

Edukimit Global, tani po e kërkonin atë. Mësuesit thanë se prindërit arrinin t'i shihnin ndryshimet tek fëmijët e tyre dhe vinin të shihnin se ç'po ndodhte. Një prind, i cili nuk besonte se fëmija e tij kishte shprehur shumë të mira sociale ose të nxëni tha: *“Kur fëmija im erdhi dhe më kërkoi kokrra arrash e fasuleje, nuk mendova se do t'i përdorte për ndonjë gjë.”* Por pastaj drejtori e ftoi të merrte pjesë në orën e mësimit dhe prindi tha: *“Fëmija im është diçka!”* Një prind tjetër tha: *“Çfarë i keni bërë kësaj fëmije? Ajo tani vjen në shtëpi dhe në vend që të ulet direkt që të hajë, fillon të sillet nëpër shtëpi duke kërkuar mjete për mësime!”* Komente të tjera nga prindërit përputheshin me raportet nxënësve se marrëdhëniet e tyre me prindërit po bëheshin më të respektueshme dhe më të barabarta si rezultat i përvijës së Edukimit Global.

Një dobësi në hartimin e vlerësimit të Fazës së Dytë është mosintervistimi i prindërve, me përjashtim të pak mësuesve dhe drejtorëve që i kishin fëmijët e tyre në shkollat e Edukimit Global. Kjo duhet korrigjuar për vlerësimin tjetër. Kjo duket se ishte një burim i pasur për të përcaktuar ndryshimin që mund të jetë duke u krijuar nga Edukimi Global jashtë klasës.

3.2.8 Mjetet e Nevojshme

E rëndësishme është të thuhet se nxënësit, mësuesit dhe drejtorët në shkollat pilot po e zbatonin me entuziazëm projektin e Edukimit Global. Mësuesit punonin më shumë për të gjetur burimet e nevojshme për zhvillimin e aktiviteteve dhe ata angazhonin edhe nxënësit e prindërit në këtë punë, si pjesë e të nxënit të nxënësve dhe mbështetjes së komunitetit. Sidoqoftë, shkollat e Edukimit Global duhet të kenë patjetër në duart e tyre disa mjete themelore si : kompjutera të lidhura me internet, projektorë, televizorë, video, një fond të veçantë për mjete të tilla si postera dhe punë artistike që nuk gjenden në klasë. Për momentin, fëmijët dhe mësuesit shpenzojnë paratë e tyre për të pasur korrespondencë me e-mail me shokë të tyre dhe për gjetjen e mjeteve për punimet e tyre. Përmasat e klasave dhe mobilimi në të gjitha rastet e vëzhguara ishin të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për punën në grupe. Në klasa kishte shumë fëmijë. Krahas mundësive të gjetjes së mjeteve nga interneti, mësuesit dhe drejtorët donin më shumë burime të shkruara për mësuesit, p.sh. enciklopedi etj. Siç tha një drejtor: *“Një projekt i ri nuk mund të zbatohet mbi një bazë të vjetër.”*

Do të ishte e dobishme për mësuesit dhe Ekipin Qendror që të kishin mundësinë të vizitonin vende të tjera që përdorin modele të njëjta dhe përfaqësues të modeleve të tilla të vinin në Shqipëri për shkëmbim përvoja që do të përmirësonte përbajtjen dhe praktikën e këtij projekti. Mësuesit merrnin një shpërblim shumë të vogël për pjesëmarrjen në këtë projekt, por pjesëmarrja e tyre kërkon kohë shtesë, veçanërisht për ata që trainojnë mësues të tjerë. Në fund të fundit, trainimi në Edukimin Global dhe të bërit trainues i mësuesve të Edukimit Global duhet bërë pjesë e “paketës” së shprehive të mësimdhënies që përfshihen në vendimet mbi shkallën e pagesës së mësuesve.

3.2.9. Shënime të Vlerësueses mbi Vëzhgimet në Klasa


Vëzhgimi i klasave i bërë nga vlerësuesja e jashtme konfirmoi perceptimet e mësuesve, nxënësve, drejtorëve dhe Ekipit Qendror. Edhe pse në klasat e Edukimit Global kishte një shkallë disi të lartë zhurme, disiplina në klasë dukej se ishte e shkëlqyeshme. Mësuesit ishin në dijeni të asaj që po bënin grupet e nxënësve dhe aty ku ishte e mundur angazhonin më shumë se një person nga secili grup. Nxënësit nuk dukeshin se shqetësoheshin nga zhurma dhe bënin përpjekje të ndërjegjshme për të mos shqetësuar grupet e tjera.


Klasat jo të Edukimit Global ishin shumë të heshtura. Nxënësit në orët e mësimit të Edukimit Global ishin shumë aktivë në grupet e tyre. Ata gjithashtu ishin shumë entuziastë për t'iu përgjigjur pyetjeve, por edhe ata në orët jo të Edukimit Global dukeshin se ishin po aq energjikë për t'iu përgjigjur pyetjeve. Mësuesit jo të Edukimit Global përpiqeshin të përfshinin sa më shumë nxënës që mundeshin, por ishin individët përballë modelit të grupit të përdorur në klasat e Edukimit Global. Nuk kishte dallim të dukshëm në lidhje me respektin dhe inkurajimin e ofruar nga mësuesit jo të Edukimit Global dhe mësuesit e Edukimit Global.

Kushtet fizike të të nxënësve në klasa ishin të vështira, klasat ishin të vogla dhe kjo vihej re më shumë në klasat e Edukimit Global meqenëse ishte e vështirë për nxënësit që të punonin fizikisht në grup. Bankat dhe tavolinat nuk e ndihmonin këtë lloj pune, kështu që qëndronin mbi njëri-tjetrin dhe në disa raste jo të gjithë anëtarët e grupit kishin mundësi të përfshiheshin në rreth. Dhomat në shumicën e rasteve ishin kaq të vogla saqë ishte e vështirë për nxënësit që të ekspozonin rezultatet e punës së tyre për tu parë nga grupet e tjera dhe mësuesi. Vihej re dukshëm mungesa e kompjuterave në klasa. Në fund të çdo ore, vlerësuesja i dha mundësi nxënësve që t'i bënin pyetje të çdo natyre. Një dallim i madh që u vu re nga ekipi i vlerësimit ishte se në klasat e Edukimit Global pati më shumë nxënës me pyetje se koha për t'iu përgjigjur dhe pyetjet ishin të menduara mirë, shpesh në lidhje me aktivitetin që sapo kishte zhvilluar klasa. Në klasat jo të Edukimit Global, nxënësit ishin të ndrojtur, shumë pak e ngrinin dorën dhe u dukën se e patën të vështirë të mendonin se çfarë pyetje të bënin.

3.2.10. Ekipi Qendror

Ekipi Qendror zhvilloi vëzhgime të shumë mësuesve të Edukimit Global gjatë periudhës së zbatimit të Fazës së Dytë. Tabelat 3 dhe 4 më poshtë japin një prezantim të gjetjeve të tyre siç raportohet në formularin E: Lista e Vëshgimit të Mësimit (Shih shtojcën B)





Ekipi Qendror Identifikon Pengesat dhe Mundësitë: Edhe anëtarët e Ekipit Qendror u intervistuan veçmas. Pyetja e parë kishte 4 elementë rreth të cilëve ekipi u pyet për të identifikuar pengesat dhe barrierat ose lehtësuesit për të katë elementët. Pjesa e mëposhtme është një përmbledhje e përgjigjeve të tyre.

Zhvillimi i Kurrikulës: Ekipi Qendror besonte se të qënit autorë tekstesh e lehtësonte mundësinë e tyre për të shkruajtur aktivitetet e nevojshme për projektin e Edukimit Global. Ata e shihnin këtë projekt si një ndryshim cilësor në zhvillimin e kurrikulës në sistemin arsimor shqiptar dhe si kontribut në iniciativën e reformës së kurrikulës. Një anëtar theksoi: “Ky projekt i jep mësuesit një profil tjetër për përdorim. Tani ai është organizues i klasës dhe jo lojtar ping-pongu, i cili jep probleme dhe bën pyetje. Ai ka çuar në një rritje të pjesëmarrjes së nxënësve dhe ka çuar në një përfshirje më të madhe të nxënësve në të mësuarit e vetvetes.” Pengesat për zhvillimin e aktiviteteve përfshinin mungesën e materialeve të referencës për tu përdorur si modele për zhvillimin e aktiviteteve (i vetmi libër në dispozicion ishte Global Teacher, Global Learner - Mësuesi Global, Nxënësi Global), mungesën e futjes në internet dhe mungesën e të dhënave statistikore mbi Shqipërinë. Ekipi Qendror besonte se aktivitetet ekzistuese ishin të mira, por ende kanë nevojë për përmirësim cilësor. Ata do të vazhdojnë të punojnë nga afër me INEG për zhvillimin e aktiviteteve.

Anëtarët e Ekipit Qendror përdornin periudha të ndryshme pilotimi për të mbledhur informacion nga mësuesit dhe nxënësit mbi mbarëvajtjen e aktiviteteve. Ata e përdornin këtë feedback për t'i rishikuar aty ku dilte e domosdoshme. Anëtarët e Ekipit Qendror të ISP angazhuan mësues nga çdo lëndë për hartimin e aktiviteteve. Ndërsa e pranonin se struktura ekzistuese e kurrikulës ishte shumë e ngurtë dhe e vështirësonte disi zbatimin e aktiviteteve të Edukimit Global nga mësuesit, të gjithë anëtarët e Ekipit Qendror besonin se ishte e mundur të punohej rrotull kurrikulës ekzistuese. Edhe mësuesit e intervistuar, si të Edukimit Global, edhe ata jo të Edukimit Global

komentuan mbi këtë vështirësi, por të gjithë kishin gjetur mënyra krijuese për të punuar rreth saj për momentin. Një problem i hershëm ishte një hartim më tepër ambicioz se sa duhet i aktiviteteve, gjë që vështirësonte plotësimin e tyre në kohën e caktuar dhe gjetjen e mjeteve të nevojshme. Pas pilotimit, aktivitetet u rishikuan për tu bërë më të arësyeshme. Anëtarët e Ekipit Qendror e ndienin të gjithë se trainimi që kishin marrë nga kontakti i tyre me INEG i kishte ndihmuar mjaft në qartësimin e keqkuptimeve dhe veçanërisht në të kuptuarit e çështjes së Edukimi Global nuk është vetëm metodologji, por edhe një pikëpamje apo filozofi botërore. Disa anëtarë të Ekipit Qendror besonin se mësuesit e kanë akoma të vështirë ta kapin këtë në fazat e para të trainimit dhe zbatimit.

Trainimi i mësuesve: Trainimi i mësuesve konsiderohej shumë i efektiv për Fazën e Parë dhe të Dytë. Anëtarët e Ekipit Qendror besonin ashtu si edhe mësuesit se trainimi siguronte një ekuilibër të shkëlqyer midis teorisë dhe praktikës. Mësuesit ishin trainuar mbi mënyrat e punës në grupe dhe atyre u ishin dhënë aktivitete të hartuara që thjesht t'i zbatonin në klasat e tyre. Anëtarët e Ekipit Qendror besonin se në kuadrin e nivelit të trainimit të ofruar, shumica e mësuesve kishin punuar mirë me zbatimin dhe disa kishin punuar jashtëzakonisht mirë dhe kishin qenë shumë krijues. Sidoqoftë, anëtarët e Ekipit Qendror besonin se kishte ardhur koha për të rivlerësuar se për realizimin e cilave detyra ishte hartuar trainimi.

Së pari, ata besonin se shumica e mësuesve, ndërkohë që ishin në gjendje të zbatonin punën në grup, nuk kishin po kaq shprehje ta ndalonin veprimin dhe t'i pyesnin nxënësit për të identifikuar se cilat ishin strategjitë e punës në grup që po lehtësonin të mësuarit e tyre. Ekipi Qendror ishte i mendimit se disa mësues besonin se nëse ata bënin punë në grupe në klasë, ata po bënin Edukim Global.

Së dyti, ata do të dëshironin që mësuesit të integronin filozofinë dhe praktikën e Edukimit Global në një shkallë të tillë që të mund të krijonin aktivitetet e veta për lëndët e tyre, duke zvogëluar varësinë nga Ekipi Qendror për pajisjen me aktivitete. Kjo aftësi lidhet me një dobësi tjetër potenciale që vunë re anëtarët e Ekipit Qendror, se mësuesit po i bëjnë aktivitetet, por ata jo gjithmonë bëjnë lidhjet e hapura me dimensionet e Edukimit Global për tu reflektuar nga nxënësit. Një anëtar i Ekipit Qendror theksoi se mësuesit e kuptonin filozofinë, po jo gjithmonë e lidhnin atë hapur me realitetin në klasë. Ky anëtar besonte se sa më shumë e më thellë të futen mësuesit në integrimin e metodave të Edukimit Global dhe ta kishin për zemër Edukimin Global në praktikën e tyre, aq më shumë ata do të ishin në gjendje të punonin brenda kurrikulës së vjetër dhe më shumë do të kontribuonin për ndryshimet e kurrikulës.

Së treti, ashtu si edhe mësuesit e intervistuar, Ekipi Qendror beson fuqimisht se trainimet për mësuesit in-service është e nevojshme të bëhen të paktën një herë në muaj, në mos dy herë. Kjo do të përfshinte seminare rajonale ose kombëtare, konferenca dhe veprimtari më të vogla brenda shkollave të Edukimit Global dhe drejtorive arsimore të organizuara për lëndë të veçanta ose për zhvillimin e shprehive. Ekipit Qendror do t'i pëlqente të shihte mësuesit e avancuar që të mësoheshin të trainonin të tjerët, por kjo ngre çështjen e besnikërisë ndaj synimit origjinal të trainimit. Për momentin nuk ka një model të Trainimit të Trainuesit për këtë projekt.

Së katërti, mësuesit duhet të jenë në gjendje të dallojnë se kur metoda e duhur e mësimdhënies është puna në grup dhe kur është ajo individuale.

Së pesti, të trainuarit për filozofinë dhe zbatimin e Edukimit Global duhet të marrin një certifikatë për punën e tyre, veçanërisht meqënëse ata janë vullnetarë dhe nuk marrin ndonjë

shpërblim të rëndësishëm për punë shtesë. Kjo do të jetë veçanërisht e rëndësishme për trainuesit e mësuesve në qoftë se do të kryhet një model i trainimit të trainuesve.

Zbatimi me Nxënësit: Të gjithë anëtarët e Ekipit Qendror besonin se burimi i kryesor i këtij projekti janë nxënësit. Ata vunë në dukje entuziazmin e nxënësve për këtë lloj “të ri” të mësuarit dhe përfitimet në vetëvlerësimin, mendimin kritik dhe shprehjen e lirë të mendimeve, veçanërisht për nxënësit e dobët në mësim. Një anëtar tha: *“Unë kam vënë re ndryshime të mëdha midis nxënësve të dobët, të cilët në këtë sistem mësimdhënieje, nuk janë më të dobët dhe ju mund ta shihni ndryshimin në qëndrimin dhe përgatitjen e duhur. Sytë e tyre ndrisin!”* Ekipi Qendror tha se nxënësit po nxisin shtrirjen e Edukimit Global në klasat jo të Edukimit Global duke kërkuar që tu jepet më shumë nga ky model dhe kjo filozofi. Nxënësit ishin lodhur me metodat e vjetra të mësimdhënies dhe e pritën mirë këtë projekt. Siç tha një nxënës i intervistuar: *“Adaptimi në këtë projekt të ri është i vështirë në fillim, por tani ne jemi mësuar me të. Projekti ka bërë atë ç’ka kishte nisur të bënte.”*

Anëtarët e Ekipit Qendror i kushtonin vëmendje të madhe feedback të nxënësve nga lëndë të ndryshme. Ata thanë se ankesa me e zakonshme ishte zhurma që krijohet në klasë gjatë Edukimit Global kur zhvillohet puna në grup. Përveç kësaj, Ekipi Qendror nuk dëgjoi ndonjë ankesë tjetër serioze nga nxënësit. Kjo përputhet me rishikimin e fletëve feedback të nxënësve nga vlerësuesja. Një anëtar komentoi se në fillim disa mësues shkruanin në ditarët e tyre se kishin shpresa shumë të pakta për mënyrën e sjelljes së nxënësve në këtë model të ri, por nxënësit i tejkaluan këto shpresa dhe më vonë mësuesit të habitur e pranuan këtë.

Anëtarët e Ekipit Qendror shprehën të njëjtin shqetësim për nxënësit siç e kishin edhe për mësuesit. Ata nuk ishin të sigurtë se çfarë lidhjeje bënin nxënësit midis ngazëllimit të tyre dhe vlerësimit të punës me grupe, dhe të kuptuarit filozofik të aktiviteteve të Edukimit Global. Anëtarët e Ekipit Qendror besonin se kjo lidhje mund të përmirësohet duke e lidhur me nevojat e trainimit të theksuara në komentet e tyre mbi trainimin e mësuesve. Ata duan të shohin tregues se nxënësit në fakt e kuptojnë lidhjen e punës në grup me praktikën demokratike. P.sh. u sugjerua hartimi nga nxënësit i rregullave bazë mbi bazën e të cilave do të punonin në grupe. Hartimi i rregullave të tilla se si do ta marrin rradhën për të raportuar, se si do të veprojnë me mosmarrëveshjet etj. do të ishin për nxënësit një mundësi me vlerë për të zbatuar në jetën e tyre të përditshme ato çfarë po mësojnë. Një tregues tjetër i të kuptuarit nga nxënësit të filozofisë si edhe të praktikës do të ishte një aplikim më i gjerë i mësimave të Edukimit Global në veprimtaritë e komunitetit, ose zhvendosja e proceseve dhe vlerave të mësuara në punën e tyre në qeveritë e nxënësve.

Burimet Egzistuese dhe Ato të Nevojshme: Anëtarët e Ekipit Qendror pajtohen me mendimin se burimi më i madh i këtij projekti janë nxënësit dhe mësuesit. Shumë mësues kanë patur trainime të tjera të ofruara në Shqipëri, p.sh. modeli i Mendimit Kritik i Soros-it, i cili ka kontribuar në aftësitë e tyre për të zbatuar Edukimin Global. Drejtues të disa drejtorive arsimore dhe të gjithë drejtorët e shkollave kanë marrë pjesë në trainimin që çoi në mbështetjen e zbatimit nga ana e tyre. Trainimi i financuar nga UNICEF dhe i siguruar nga INEG, konsiderohet si një nga burimet më të mira.

Anëtarët e Ekipit Qendror lavdëruan përkushtimin e mësuesve dhe gatishmërinë për të bërë punë shtesë, megjithëse ajo ka shumë pak efekt mbi të ardhurat e tyre. Entuziazmi i nxënësve për projektin ishte parë si forcë lëvizëse për ta bërë të suksesshëm. UNICEF-i siguroi burimet në formën e furnizimeve “laps e letër” për nxënësit. Përveç kësaj, mësuesit dhe nxënësit kanë qenë

përgjegjës për gjetjen e burimeve të nevojshme për aktivitetet. Anëtarët e Ekipit Qendror shprehën dy pamje të kësaj nevoje. Të gjithë e pranuan se kjo i ngarkon mësuesit me një barrë shtesë, duke përfshirë, me raste, koston e materialeve që del nga të ardhurat e tyre personale. Ndonjëherë kjo ishte e vërtetë edhe për nxënësit. Sidoqoftë, Ekipi Qendror dhe mësuesit komentuan se nxënësit lidhen me këtë detyrë dhe shihej si një veprimtari që kontribuonte në të nxënit e tyre dhe zhvillimin e marrëdhënieve familjare. Pasi nxënësit e saj kishin sjellë gjëra artistike nga historia e familjes së tyre për një aktivitet, një mësuese nga Shkodra citohej se tha: *“Ky është një muze arkeologjik!”*. Një anëtar i Ekipit Qendror besonte se burimet specifike për aktivitetet individuale nuk duhet të sigurohen nga jashtë pikërisht për këtë arësyje.

Të gjithë anëtarët e Ekipit Qendror pajtohen me mësuesit dhe nxënësit se duhen siguruar burime të tjera për mbështetjen e punës kërkimore nga mësuesit dhe nxënësit. Këto burime përfshijnë ngritjen e një biblioteke me materiale reference për Ekipin Qendror në ISP dhe për mësuesit e Edukimit Global në shkollat e tyre, kompjutera që sigurojnë futjen në Internet për anëtarët e Ekipit Qendror dhe shkollat; televizorë, video dhe fotokopje. Për momentin, pa këto lloj burimesh, burimet e referencës dhe burime të tjera të shkruara, ose paguhen nga vetë mësuesit, ose ata duhet të shkruajnë me dorë kopje për çdo nxënës siç ishte rasti i një ore matematike vëzhguar nga vlerësuesja, ose ata përfundojnë duke përdorur copa gazetash apo revistash për të krijuar dokumentet. Ndihma për rehabilitimin dhe pajisjen e klasës për të mundësuar modelin e mësimdhënies të punës me grupe konsiderohet gjithashtu si shumë e rëndësishme për vazhdimin e sukseshëm.

Kontributi Potencial që Mund të Japë Ekipi Qendror për Shtrirjen e Edukimit Global: Ekipi Qendror u pyet se çfarë mund tu ofronte vendeve të tjera në qoftë se i kërkohej ndihmë për të filluar një projekt të Edukimit Global. Ata besonin se mund të ndanin mësimet që kishin marrë për të ndihmuar një sistem tjetër në shmangjen e gabimeve të para. Në vendet që po ndeshin të njëjtin tip të transformimit të kurrikulës, ata besonin se do të mund të ndihmonin veçanërisht në ndarjen e eksperiencës së tyre për shkrirjen e Edukimit Global me periudhën e rishikimit. Ata ndjenin se mund të ndihmonin pjesëmarrësit e rinj të këtij modeli të forconin të kuptuarit e marrëdhënieve midis metodave dhe filozofisë së Edukimit Global dhe të kuptuarit e marrëdhënies së metodave dhe filozofisë me krijimin e qytetarit global.

Ekipit Qendror do t'i pëlqente që të ishte në gjendje të siguronte trainim të Edukimit Global në nivele pre-service dhe in-service. Disa anëtarë të Ekipit Qendror i konsideronin përvojat e tyre vetjake në shkolla të vendeve të tjera, madje edhe në shkolla jo të Edukimit Global si një kontribut të madh në aftësinë e tyre për të formuluar aktivitetet e nevojshme dhe për t'i dhënë mësuesve shqiptarë asistencë teknike mbi strategjitë e organizimit të klasës. Rekomandohet fuqimisht që Ekipi Qendror dhe disa mësues shqiptarë të Edukimit Global të vizitojnë INEG në Toronto në 2001 për të parë nga afër zhvillimin dhe praktikën e këtij projekti dhe për tu angazhuar në dialog me inisiatorët e projektit se si të përmirësojnë përhapjen e tij këtu në Shqipëri.

Të dhënat e mbledhura për vlerësimin e Fazës së Dytë vërtetojnë pikëpamjen se përkushtimi dhe aftësitë ekzistuese të Ekipit Qendror kanë qënë faktor qendror për suksesin e Projektit të Edukimit Global. Anëtarët e ekipit studioan me kujdes për të mësuar se si t'i zhvillonin me efektivitet aktivitetet për çdo lëndë. Ata mësuan shprehitë trainuese të domosdoshme për të mbështetur mësuesit dhe drejtorët që po zbatojnë projektin në klasë, dhe u angazhuan me dëshirë në një proces të hapur të feedback dhe vlerësimi me qëllim që jo vetëm të përmirësonin cilësinë në terren, por edhe cilësinë e tyre të zbatimit. Ekipi Qendror duhet inkurajuar dhe mbështetur nga

UNICEF-i, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe ISP në përpjekjet e tyre për të ndihmuar kapacitetet e tyre për hartimin dhe zbatimin e këtij projekti.

3.2.11. Roli i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencave dhe Institutit të Studimeve Pedagogjike

Anëtarët e Ekipit Qendror besonin se Ministria e Arsimit dhe Shkencave dhe Instituti i Studimeve Pedagogjike kishin dhënë mbështetje të shkëlqyer. Kjo përputhej me atë që thanë shumica e mësuesve në intervista. Ata theksuan se Ministria është angazhuar në zgjedhjen e disa shkollave, disa nëpunës kishin ndjekur trainimin e Edukimit Global, dhe Ministria kishte folur hapur për mbështetjen e saj ndaj projektit. E vetmja fushë shqetësimi dhe nevoje e shprehur nga të gjithë ishte nevoja për të vazhduar punën për rishikimin e kurrikulës me synim përfundimtar arritjen e një ekuilibri në kërkesat e kurrikulës midis njohurive akademike dhe shprehive praktike për aplikimin e tyre. Ky shqetësim përqendrohej kryesisht në lejimin e mësuesit për të marrë në konsideratë metoda alternative për ngulitjen e njohurive dhe në sigurimin e teksteve alternative dhe materialeve të referencës nga të cilat mësuesit të mund të zgjedhin. Një tjetër sugjerim i bërë nga mësuesit dhe Ekipi Qendror është se mësuesit e Edukimit Global duhet të marrin një çertifikatë nga Ministria që të njohë shprehitë e tyre në këtë fushë. Së fundi, u rekomandua edhe që shkollat ku po përdoret Edukimi Global të caktohen si shkolla “model” ku të praktikohen këto alternativa si pjesë e transformimit të kurrikulës dhe metodave të mësimdhënies.

Në një intervistë, Drejtori i Arsimit 8-vjeçar në MASH tha se projekti i Edukimit Global përputhet tërësisht me objektivat afat-mesme të vitit 2000 për përmirësimin e sistemit arsimor shqiptar. Këto objektiva ishin;

1. Normalizimi i sistemit arsimor i cili përfshin përmirësimin e infrastrukturës dhe burimeve të nevojshme për një arsim cilësor.
2. Rritja e efikasitetit të arsimit duke bërë lidhjen midis investimit dhe rezultateve.
3. Përmirësimi i vazhdueshëm cilësor i burimeve njerëzore në sistemin arsimor.
4. Integrimi i sistemit shqiptar në sistemin Europian, Atlantik e më tej.

Drejtori beson se Edukimi Global përputhet me këto objektiva sepse ai:

1. Kontribuon në zhvillimin e inisiativës për të zgjeruar kurrikulën.
2. Përputhet me inisiativën e integritit duke mbështetur një largim nga mekanikja tek sistemikja.
3. Mbështet filozofinë e njohjes së të drejtave njerëzore të fëmijëve.
4. Përmirëson shprehitë e mësimdhënies.
5. Nxirr rritjen akademike, personale dhe shpirtërore të fëmijëve.

Trainimi është shumë i nevojshëm në të gjitha aspektet e arsimit në Shqipëri, dhe trainimi i Edukimit Global shihet si një mjet për mbushjen e kësaj nevoje duke siguruar një model me bazë të gjerë filozofike dhe të zhvillimit të shprehive. Ky është një ekuilibër që po kërkohet nga sistemi arsimor shqiptar me largimin e tij nga një kurrikul që bazohet shumë në teori dhe pak në shprehitë praktike për zbatim. Drejtori mbështeti kalimin e modelit të Edukimit Global në Universitete për trainimin e studentëve të mësuesisë. Ai besonte se Edukimi Global mbështet zhvillimin më të mirë të qytetarëve shqiptarë nëpërmjet zbatimit në sjelljen dhe etikën qytetare etj.

Ai vuri në dukje se sfida për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës ishte mungesa e fondeve, por ata do të donin të zhvillonin sa më shumë partneritete që të mund t'i ndihmonin ata në lidhje me këtë çështje. Drejtori i ISP, i cili gjithashtu theksoi nevojën për partneritet për të mbështetur përpjekjen për ndryshimin e arsimit në Shqipëri, ndante të njëjtin shqetësim. Drejtori i ISP besonte se situata e financimit për arsimin në Shqipëri po fillonte të ndryshonte, dhe ISP do të merrte më shumë fonde. Ata shpresojnë të krijojnë një qendër kombëtare për reformën arsimore dhe Edukimi Global përfshihet nën këtë ombrellë. Synohet në shtrirjen e Edukimit Global në të gjitha shkollat me aktorë kryesorë mësuesit. Për momentin, Institutit i nevojiten akoma partnerë për të siguruar disa burime, p.sh. kompjutera dhe ekspertizë trainimi. Ai porositi se është e rëndësishme që aktivitetet ekzistuese të Edukimit Global të mbahen larg shkollave rurale që nuk kanë akoma akses në mundësitë elektronike. ISP do të mbështesë futjen e Edukimit Global në trainimin e mësuesve të ardhshëm në nivel universitar.

Drejtori i ISP i ka kërkuar Ekipit Qendror dhe mësuesve të bëhen pjesë e një ekipi bashkëpunues për të dhënë këshilla mbi mënyrën e shtrirjes së pronësisë së Edukimit Global dhe përpjekjeve të tjera të integritit në sistemin arsimor. Vlerësuesja sugjeroi edhe përfshirjen e prindërve dhe nxënësve. Drejtori i ISP shprehu një dëshirë të madhe për t'i parë mësuesit shqiptarë të trainuar për të qënë trainues të mësuesve të Edukimit Global këtu dhe gjetkë në botë. U diskutua çertifikata për mësuesit e Edukimit Global dhe drejtori i ISP ofroi një model që mund të njihete nivelet e ndryshme të shprehive nga një që thjesht ka marrë pjesë në trainim nga ai që është një trainues i kualifikuar për projektin.

Ndërkohë që mundësia e mbështetjes nga MASH për futjen e Edukimit Global në mbarë sistemin arsimor në të ardhmen e afërt (një ose dy vjet) shihet si e vogël në kohën e këtij raporti, Ministria dhe ISP me partnerët e tjerë duhet të lëvizin në drejtim të mbështetjes së plotë të këtij projekti brenda 4-5 viteve të ardhshme. Ata do të kërkojnë angazhimin e më shumë partnerëve, dhe çfarë është më e rëndësishme, të përgatisin ligjvënësit për nevojën e projekteve të tilla dhe të tregojnë efektivitetin e tyre me qëllim që të zhvillojnë vullnetin politik dhe kapacitetin institucional të domosdoshëm për të kryer reformën arsimore aq të nevojshme e aq të kërkuar, që për momentin është në ecje e sipër.

3.2.12. Roli i UNICEF-it

UNICEF-i siguroi burimet e domosdoshme materiale për këtë projekt. Veçanërisht gjatë Fazës së Dytë, u siguroa udhëheqja mjaft e nevojshme. Së pari, mbështetja financiare për trainim dhe për hartimin e aktiviteteve dhe shërbimet e anëtarëve të Ekipit Qendror siguroi një bazë të shëndoshë për rritjen e projektit. Ekspertiza e planifikimit dhe koordinimit, e siguruar veçanërisht në Fazën e Dytë, çoi në zhvillimin e partneritetit midis UNICEF-it dhe mbështetësve të tjerë. Gjatë vitit 2000 menaxherja e UNICEF-it për projektin e Edukimit Global punoi për të organizuar dhe konsoliduar më mirë raportet dhe shënimet mbi projektin. Veçanërisht e rëndësishme ishte përpjekja për të hartuar një pamje të qartë të buxhetit dhe fillimi i një plani për një vëzhgim financiar me partnerët, që do të lehtësonte mundësinë që të gjithë partnerët të kenë akses në analizën e kostos dhe përfitimit të projektit mbi bazën e një kohe të caktuar.

Menaxherja e projektit, në bashkëpunim me ISP dhe shkollat e Edukimit Global po harton planet për rrjedhjen e proceseve të menaxhimit, shpërndarjen e materialeve dhe zbatimin për Fazën e Tretë. Këto përfshijnë:

1. Zhvillimi i një procesi të përdorimit buxhetor më të hapur;

2. Arritjen e një marrëveshjeje me partnerët për llogaritjen e shpenzimeve në kohën e duhur si dhe kërkesave për fonde;
3. Shpërndarjen e furnizimeve nëpër shkolla;
4. Shpërndarjen e një projekti të parë të manualit të mësuesit;
5. Blerjen dhe shpërndarjen e një kompjuteri dhe një fotokopjuesi për të 14 shkollat ekzistuese të Edukimit Global dhe për zyrat e Ekipit Qendror në ISP;
6. Monitorizimin e vazhdueshëm të cilësisë së zbatimit të projektit; dhe
7. Hartimin me mbështetësit e një strategjie vlerësimi më efikase.

Në mbështetje të menaxhimit dhe zgjerimit të projektit, menaxherja e projektit propozon si më poshtë:

1. Hartimin e materialeve për nxitjen e Edukimit Global, p.sh. broshura, video, etj.
2. Zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me partnerë të tillë si Universiteti i Elbasanit.
3. Përfshirjen e vazhdueshme të zyrtarëve të Ministrisë dhe ISP në takimet e vazhdueshme të koordinimit dhe vendim-marrjes.
4. Në fillim të 2001, hartimin e një plani pesë ose dhjetë vjeçar nga të gjithë partnerët për transferimin përfundimtar dhe mbështetjen e Edukimit Global tek MASH.
5. Mbështetjen e vazhdueshme të trainimit të mësuesve, duke përfshirë mbështetësit për të zgjeruar bazën e mbështetjes së projektit.
6. Mbështetjen për një konferencë kombëtare mbi këtë projekt pas daljes së raportit të vlerësimit të Fazës së Tretë; dhe
7. Zbatimin e seminarit të trainimit për trainuesit.

UNICEF-i duhet të njohë dy faktorë të rëndësishëm në lidhje me natyrën vazhduese të këtij projekti. Ai është një lloj projekti që do të kërkojë disa forma të mbështetjes së jashtme financiare për një periudhë të caktuar kohe për shkak të brishtësisë së tanishme të sistemit arsimor shqiptar. Ky projekt nuk mund të shihet si një “rregullim i shpejtë”. Një nga kushtet kryesore të kurrikulës së Edukimit Global kërkon një depërtim të thellë e të gjerë në sistemin arsimor. Siç tregon ky raport, tashmë ka një shpërblim për UNICEF-in dhe të gjithë partnerët e tij për investimin e bërë deri tani. Si përfituesi (përfundimtar) kryesor i kësaj përpjekjeje për ndryshim, nxënësit e përfshirë po shfaqin tashmë tregues të fuqishëm të kapjes së ndryshimeve dhe plotësimit të objektivave të kërkuara nga ky projekt. Tani në sistemin arsimor shqiptar ka një momentum që ka nevojë për “mbajtjen për dore” për një kohë disi më të gjatë. Ka një momentum që po ndërtohet nga mësuesit, nxënësit dhe prindërit që shtojnë për këtë ndryshim nga sistemi, që do të kërkonte futjen e plotë të projektit të Edukimit Global në mbarë sistemin. Së fundi, do të ishte me një kosto mjaft efektive për UNICEF-in që të vazhdonte si partner dhe lehtësues i këtij projekti derisa shqiptarët të mund të arrijnë një pikë kritike në sistemin arsimor shqiptar që të mbështesë pronësinë e plotë të projektit. Kjo mbështetje përfshin sigurimin e asistencës në materiale trainimi të përkthyer në shqip, mbështetjen e trainimit të mëtejshëm të mësuesve përfshirë mundësinë e zbatimit të një modeli të Trainimit të Trainuesve këtu, sigurimin e një furnizimi fillestar në kompjutera dhe fotokopjues në shkollat e tanishme gjatë Fazës së Tretë, vlerësim dhe monitorim të vazhdueshëm dhe ndihmën ndaj partnerëve shqiptarë për të gjetur OJQ të tjera, organizata të tjera fitim dhe jo fitim prurëse për të mbështetur ndihmën e vazhdueshme dhe shpërndarjen përfundimtare të këtij projekti novator.

3.2.13. Analiza e Buxhetit

Buxheti për këtë projekt filloi në 1997 dhe është bashkangjitur si shtojca A. Për këtë analizë u përdorën dy grupe shifrash. Shifrat e mëposhtme të kostos për nxënës u llogaritën nga fillimi i projektit deri në fund të Fazës së Dytë dhe nuk përfshijnë shifrat me të kuqe të buxhetit në kolonën e vitit 2000. Shifrat e kuqe paraqesin shpenzimet e propozuara për Fazën e Tretë. Llogaritjet e kostos për nxënës gjatë Fazës së Tretë përfshijnë shifrat me të kuqe. Që nga faza përgatitore në 1997 e deri në fund të Fazës së Dytë në Qershor 2000, kostot e projektit janë përdorur kryesisht në ndërtimin e kapacitetit të personelit për të krijuar një kuadër fillestar mësuesish për të implementuar kurrikulën. Në koston e trainimit të Fazës së Dytë (99-00) pati një rritje të rëndësishme mbasi pjesëmarrësve iu shtuan drejtorët e shkollave dhe të interesuar të tjerë me qëllim mbështetjen e projektit në të gjithë sistemin arsimor shqiptar. Kostoja për nxënës nga Faza përgatitore deri në fund të Fazës së Dytë ishte afërsisht 16\$. Në Fazën e Tretë, kostoja për nxënës do të rritet në afërsisht 33\$ për arsye të kostos së pajisjes me kompjutera dhe fotokopje për 14 shkollat pjesëmarrëse, projektit të “manualit të mësuesit” dhe shtimin e materialeve të tilla si lapsa, letër dhe furnizime të tjera për çdo shkollë.

Kur i krahasojmë këto kosto për nxënës me ato të kurrikulave të ngjashme, p.sh. ato për parandalimin e abuzimeve, zgjidhjen e konflikteve dhe/ose parandalimin e dhunës¹, kostoja për nxënës për projektin e Edukimit Global duket qartë se është në fundin minimal të spektrit të kostos, e cila varion nga 10\$ deri në 1600\$ për nxënës në varësi të kurrikulës së zgjedhur dhe mesatarja është 235\$ për nxënës. Rritja e kostos jo vetëm për trainimin e mësuesve do të kontribuonte në zgjerimin e mëtejshëm të kontributit që ky projekt ka dhënë në sistemin arsimor shqiptar siç u përshkrua mësipër.

3.2.14. KONKLUZION

Rekomandimet që vijojnë janë bërë mbi bazën e gjetjeve të raportuara mësipër dhe përfshijnë një pohim që tregon realizimin e suksesshëm të rekomandimeve nëse ata do të zbatohen. Këto rekomandime duhet të merren në konsideratë nga mbështetësit dhe të veprohet me to siç e shohin ata të përshtatshme dhe siç e lejojnë burimet. Projekti i Edukimit Global po shfaq tregues të arritjeve të synimeve të parashtruara në kurrikul dhe nga MASH në përpjekjet e saj për të transformuar sistemin arsimor shqiptar. Fëmijët e Shqipërisë tashmë janë ndikuar thellë nga ky projekt dhe ky ndikim do të vazhdojë të zgjerohet. Ky projekt ia vlen të vazhdojë për sa kohë që ai përmbush të njëjtin nivel arritjesh dhe në këtë shkrim nuk ka arsye të besohet se këto objektiva nuk do të vazhdojnë të përmbushen. Mbështetja për këtë projekt është e fuqishme dhe motivimi i të gjithë mbështetësve për të vazhduar zgjerimin dhe thellimin e përpjekjeve në mënyrë cilësore është i lartë.

¹ *Making the Grade: A Guide to School Drug Prevention Programs dhe Safe Schools, Safe Students: A Guide to Violence Prevention Strategies*, Strategjitë e drogës, një institut kërkimor jofitimprurës, Washington DC, 1999

3.3. REKOMANDIME

3.3.1. Zhvillimi i Kurrikulës

1. Ekipi Qendror duhet të vazhdojë të përdorë hartimin e kurrikulës së Edukimit Global si një model për të kontribuar në kurrikulën ekzistuese. Tregues i progresit do të jetë një kalim nga rishikimi i kurrikulës në reformën tërësore.
2. Ekipi Qendror duhet të vazhdojë t'i mbështesë mësuesit në:
 - a. Së pari, zbatimin e aktiviteteve të parapërgatitura.
 - b. Së dyti, arritjen e një niveli të tillë praktike me këto aktivitete ku mësuesit të mund të bëjnë ndryshime dhe të kuptojnë bazat e këtyre ndryshimeve.
 - c. Së treti, trainimin e mësuesve për të shkruajtur vetë aktivitetet e tyre.
 - d. Së katërti, shndërrimin në mësues të Edukimit Global jo thjesht mësues të aktiviteteve në disa orë të caktuara mësimi, por praktikues, të cilët integrojnë filozofinë dhe metodologjinë në të gjithë praktikën e tyre mësimdhënëse.
3. Në fund të Fazës së Tretë, instrumentat e vlerësimit dhe aktivitetet e reja do të tregojnë se mësuesit kanë mësuar t'i rishikojnë aktivitetet në mënyrë të përshtatshme dhe se disa po hartojnë me sukses të tyre dhe po i integrojnë ato në klasat e tyre.
4. Ekipi Qendror duhet të vazhdojë të përmirësojë kapacitetin e vet për të hartuar aktivitete të reja dhe për të ndihmuar mësuesit në këtë punë. Ky hartim do të përfshinte jo vetëm aktivitete më të plota profesionalisht siç rekomandohet në memon e David Selbit në Shtator 2000, por edhe lëvizjen drejt një integrimi të natyrshëm të filozofisë dhe metodologjisë së Edukimit Global në të gjitha klasat dhe lëndët. Në fund të Fazës së Tretë, vlerësimi do të tregojë një futje të mëtejshme të praktikave të Edukimit Global në një numër gjithnjë e në rritje klasash dhe shtimin e Dimensionit të Brendshëm si p.sh. diversiteti dhe drejtësia sociale.

3.3.2. Trainimi

1. UNICEF-i dhe partnerët shqiptarë që punojnë me INEG, duhet të sponsorizojnë një seminar të Trainimit të Trainuesve për mësuesit që janë të interesuar të trainojnë mësues të tjerë dhe zyrtarë shkollash në modelin e Edukimit Global. INEG duhet të sigurojë një manual trainuesish që të përkthehet në shqip. Duhet të ketë një çertifikatë për mësuesin që t'i njohë këtë shprehje. Në fund të Fazës së Tretë duhet të jetë një kuadër prej dy ose tre mësuesish të Edukimit Global nga çdo rreth, të cilët të jenë trainuar si trainues dhe të zbatojnë trainimin.
2. Mësuesve që kanë praktikuar Edukimin Global për një farë periudhe duhet tu sigurohet një trainim i avancuar. Ky trainim duhet të përfshijë:
 - a. Zhvillimin e një kuptimi më të thellë të të gjithë komponentëve të Edukimit Global.
 - b. Sesione mbi diversitetin e stilit të mësimdhënies dhe të nxënies; dhe
 - c. Zhvillimin e mëtejshëm të kapacitetit të mësuesve për identifikimin e mjeteve të përdorura të punës dhe qëllimin e tyre dhe krijimi i këtyre shprehive tek nxënësit; p.sh. brainstorming, krijimi i konsensusit etj. dhe zbatimin e tyre në jetën e përditshme.
3. Nga fundi i Fazës së Tretë, partnerët duhet të mbajnë të paktën një seminar trainimi të avancuar për disa mësues nga rrethet e shkollave të tanishme që praktikojnë Edukimin Global.

4. Të xhirohen dhe fotografohen orë të Edukimit Global. Të mblidhen kasetat e videove ekzistuese që janë bërë nga mësues të veçantë dhe të redaktohen për tu përdorur në training. Kjo mund gjithashtu të përdoret si pjesë e përpjekjeve për marrëdhënie publike. Xhirimi do të vihet në përdorim gjatë fazës së Tretë.

3.3.3. Zhvillimi i Burimeve

1. Partnerët shqiptarë duhet të punojnë ngushtë me INEG për mundësinë e ardhjes në Shqipëri për praktika të të diplomuarve të Edukimit Global nga INEG për të punuar për shtrirjen e Edukimit Global dhe për të siguruar asistencë teknike. Partnerët mund edhe të duan të shohin mundësinë e një modeli të mësuarit në distancë. Dialogu për këtë duhet të nisë në fillim të vitit 2001. Këto janë mënyra potenciale me kosto efikase për të zgjeruar trainingun në Shqipëri.
2. Çështja e identifikimit, zhvillimit dhe shpërndarjes së burimeve duhet parë mirë. Me qëllim që të lehtësohet zgjerimi i mëtejshëm i këtij projekti, të 14 shkollat pjesëmarrëse në këtë projekt dhe Ekipi Qendror duhet të marrin nga një kompjuter të lidhur me internetin, një fotokopje të një madhësie të përshtatshme dhe televizorë e video. Rekomandohet që për këtë raund fillestar, UNICEF-i të sigurojë kompjuterat dhe fotokopjet dhe nëpërmjet zhvillimit të partneritetit të gjendet një burim tjetër për pajisje të tilla si TV e video. UNICEF-i duhet të vazhdojë të sigurojë furnizimin me letër të paktën edhe për një vit, duke punuar me partnerë për të identifikuar burime të tjera për këto materiale në të ardhmen. Me fillimin e zbatimit të orëve të Edukimit Global të Fazës së Tretë në fund të Shkurtit 2001, të paktën kompjuterat dhe fotokopjet duhet të jenë në vend dhe gati për përdorim për projektin e Edukimit Global. UNICEF-i duhet të bëjë sqarimet e duhura për ndonjë kufizim në përdorimin e këtyre pajisjeve dhe të punojë me partnerët për të gjetur kontribute të ngjashme nga burime të tjera me zgjerimin e projektit.
3. UNICEF-i duhet të marrë rolin udhëheqës në punën me partnerët e tanishëm për të identifikuar partnerë të tjerë që do ta fuqizojnë këtë projekt. Partnerët e rinj duhet të përfshijnë organizata të tjera jo-qeveritare, fondacione dhe organizata të tjera jo fitimprurëse që kanë interes për nxitjen e reformës arsimore dhe grupe të tjera që kanë interesa të përbashkëta për mirëqënien e fëmijëve shqiptarë dhe reformës arsimore. Në fillim të zbatimit të Fazës së Katërt (pranverë 2002), këtij projekti duhet t'i shtohen të paktën dy partnerë të rinj.

3.3.4. Edukimi Publik

1. INEG, Ekipi Qendror dhe mësuesit e Edukimit Global duhet të botojnë artikuj për eksperiencën e deritanishme shqiptare. Në fund të Fazës së Tretë, do të jenë botuar një ose dy dokumenta mbi përvojën e Edukimit Global në Shqipëri.
2. Pas përfundimit të raportit të vlerësimit të Fazës së Tretë, mbështetësit duhet të sponsorizojnë një konferencë kombëtare për Edukimin Global. Kjo konferencë duhet të përfshijë "pista" për të gjithë të interesuarit, përfshirë ligjvënësit, nxënësit dhe prindërit.
3. Të hartohen materiale të marrëdhënieve publike për të njohur ligjvënësit, organizatat e komunitetit, partnerë të tjerë të reformës arsimore, prindër etj. me Edukimin Global dhe

rezultatet e tij tek ata që kanë qenë të përfshirë në të. Në fund të Fazës së Tretë do të ketë një raport tërheqës të thjeshtë që do të informojë partnerët potencialë, shkollat, vendimmarrësit etj. rreth projektit të Edukimit Global.

3.3.5. Vlerësimi

1. Të rishikohen të gjitha instrumentat e vlerësimit për këtë projekt me qëllim mbledhjen e të dhënave më të matshme për ndryshimet që po ndodhin. Këto instrumenta duhet të përmbajnë një balancë të dhënash sasiore dhe cilësore dhe të përdorin metoda që identifikojnë ndryshimin e sjelljes në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, por veçanërisht midis mësuesve dhe nxënësve. Të dhënat nga prindërit duhet t'i shtohen të paktën çdo raporti të fundvitit. Për zbatimin e Fazës së Tretë, do të jenë gati instrumentat e rinj të vlerësimit. (Në fund të shkurtit)
2. Të shtrihet përdorimi i instrumentave të vlerësimit tek nxënësit dhe mësuesit jo të Edukimit Global për qëllime krahasimi.
3. Të punohet me palët përkatëse për vendosjen e kriterëve të vlerësimit të njohurive të fituara nëpërmjet punës në grup përballë asaj që matet më lehtë në përfitim individual. Të përfshihet INEG në këtë rekomandim. Në shkurt 2001, kjo do të jetë bërë pjesë e instrumentave të rinj të vlerësimit.
4. Të vendoset një proces për mbledhjen dhe menaxhimin sistematik të të dhënave. Kjo do të thotë që, pas hartimit dhe përdorimit të formularëve të rinj siç u rekomandua më sipër, të dhënat duhet të shqyrtohen rregullisht ose me dorë, ose më mirë do të ishte në një program kompjuterik për të lehtësuar analizat gjatë vitit dhe në fund të vitit. Partnerët duhet të përfshijnë në mbledhjen e tyre të planifikuar në fillim të vitit 2001 diskutimin se si ta zbatojnë këtë rekomandim. Në fillim të zbatimit në klasë të Fazës së Tretë, puna duhet të jetë vënë në vijë.

3.3.6. Ndërtimi i Kapaciteteve

1. Të hartohen më shumë programe në nivel shkolle dhe drejtorie arsimore për përfshirjen e nxënësve në komunitetin e tyre përtej mureve të shkollës. Të lëvizet përtej "ditëve të pastrimit" në projekte në vazhdim për të mësuarit e shërbimeve. Në fund të Fazës së Tretë, vlerësimi dhe vëzhgimi do të tregojnë se nxënësit janë angazhuar në shërbimet ekzistuese të komunitetit në nivel lokal.
2. Sa më shpejt që të jetë e mundur në 2001, Ekipi Qendror, menaxherja e projektit të Edukimit Global dhe ndoshta edhe disa mësues dhe një drejtor shkolle duhet të shkojnë në Toronto për tu njohur me burimet dhe praktikën e Edukimit Global në pikën e nisjes së tij. Një vizitë e tillë do të zgjerojë të kuptuarit e projektit nga shqiptarët dhe do të rifreskojë partnerët për një vështrim të ri të projektit në fillimin e shtrirjes së tij.
3. Në fillim të vitit 2001, duhet të mbahet një takim midis UNICEF-it, ISP, Ekipit Qendror dhe Universitetit të Elbasanit për të filluar dialogun mbi partneritetin me universitetin për futjen e metodave dhe filozofisë së Edukimit Global në trainimin e mësuesve të ardhshëm të Shqipërisë. Në fillim të zbatimit të Fazës së Katërt (pranverë 2002) treguesit do të thonë se

universiteti në fakt është duke futur disa elementë të Edukimit Global në punën e tij me mësuesit e rinj.

3.3.7. Ndryshimi Sistemik (Tërësor)

1. Një synim afatgjatë duhet të jetë evoluimi i “Shkollës së Edukimit Global”. Kjo do të thotë që të gjitha shkollat shqiptare të jenë integruar tërësisht në praktikën e Edukimit Global përtej klasës, për të përfshirë planifikimin dhe administrimin shkollor. Veprimtaritë që po bëhen nga nxënësit jashtë klasës si rezultat i projektit të Edukimit Global deri tani janë embrioni i një ndryshimi të tillë dhe duhet të thellohen e zgjerohen për të ndryshuar normat e shkollës dhe të sistemit. Në fund të Fazës së Tretë, në planin 5-10 vjeçar do të përfshihet një strategji për arritjen e këtij synimi.
2. Të hartohet një përfshirje e mbështetësve në vendim-marrje në lidhje me përhapjen e Edukimit Global në të gjitha nivelet. – të përfshihen prindërit, nxënësit, mësuesit, drejtoritë arsimore, Ekipi Qendror, UNICEF-i, MASH dhe ligjvënësit. Kjo duhet të marrë formën e grupeve mbështetëse në komunitetin lokal të shkollës, grupe në nivel drejtorie arsimore, ISP, zyrtarësh ministrie dhe ligjvënës dhe kombinime të tjera. Këto grupe duhet të përqëndohen në shtrirjen dhe mbështetjen lokale të Edukimit Global në të gjithë sistemin arsimor shqiptar dhe krijimin e mundësive për nxënësit për të praktikuar mësimet e Edukimit Global në nivel komuniteti dhe shteti. Shtrirja duhet të përqëndrohet si në zbatimin më të gjerë të kurrikulës së Edukimit Global, edhe në thellimin e praktikës së Edukimit Global me nxënësit. Në fund të Fazës së Tretë do të ketë një lloj komiteti bashkëpunues këshillues lokal që do të punojë për aktivitetet e Edukimit Global në çdo shkollë. Ky komitet do të ketë si anëtarë prindër e nxënës.
3. Të angazhohen organizata të tjera që nxisin ndryshimin arsimor në Shqipëri për të hartuar një metodologji sistemike për reformën arsimore.
4. Pas fillimit të vitit 2001 duhet të mbahet një mbledhje me të gjithë partnerët për të përpiluar një plan 5-10 vjeçar për pronësinë përfundimtare të projektit të Edukimit Global nga sistemi arsimor shqiptar. Një plan i tillë duhet të përfshijë synimet prioritare afatgjata me objektivat afatmesme dhe afatshkurtra, hapat e veprimit dhe një buxhet. Buxheti duhet të reflektojë një spektër të gjerë mbështetjeje dhe një kalim gradual drejt financimit që vjen kryesisht nga investimi shqiptar në arsim. Një plan i tillë duhet të jetë gati nga fundi i majit 2001.

SHTOJCA A
TË DHËNA TË BUXHETIT

Buxheti i Edukimit Global (1997-2000)

Nr.	PËRSHKRIMI	1997	1998	1999	2000
1	SEMINARE				
	Shpenzime ditore	1356 ⁽¹⁾	3 583	3 634	15 380
	Specialistët shqiptarë	--	--	164	579
	Shërbime ⁽²⁾	366	1 217	809	762
	Kartoleri	64	351	410	678
	Qira lokalesh / pushime për kafe	3 008	2 666	2 603	2 615
	Ekspertët e huaj	4 272	8 187	8 709	6 472
	Gjithsej (1)	9 066	16 004	16 329	26 486
2	PILOTIMET				
	Specialistët	-	1 268	2 245	2 730 +10 333
	Mësuesit	-	1 540	1 968	5 317
	Përkthimi i aktiviteteve	1 000	165	1400	1 395
	Kartoleri	--	1 522	--	9 877
	Gjithsej (2)	1 000	4 495	5 613	29 652
3	FURNIZIMI				
	Materiale didaktike (14 shkolla)				12,567
	Materiale didaktike dhe argëtuese				119 140
	Kompjutera, fotokopje (14 shkolla + ISP)				58 352
	Rafte				5 410
	Gjithsej (3)				195 469
4	BOTIME				
	Postera dhe fletëpalosje				9 349
	Manuali i mësuesit				4 721
	Raporti i Vlerësimit të Fazës së Parë				1 592
	Gjithsej (4)				15 662
5	VLERËSIMI I JASHTËM				14 615
6	20 LIBRA TË EG				626
	Totali i përgjithshëm (1)+(2)+(3)+(4)+(5)+(6)	10 066	30 565	21 942	282,510

⁽¹⁾ Të dhënat jepen në US \$.

⁽²⁾ Tek "shërbimet" përfshihen përkthimet gojore në seminare, përkthimet e materialeve për seminare, sekretaria dhe fotokopjet.

TË DHËNA DHE SHPENZIME PËR SEMINARET

Përshkrimi	1997	1998	1999	2000
Numri gjithsej i ditëve	3	7	4	6
Numri i pjesëmarrësve	22	120	107	198
Shpenzime gjithsej (1)	9 066	16 004	16 329	26 238

SHPENZIMET PËR PERIUdhËN E PILOTIMIT

Përshkrimi	1997	1998	1999	2000
Numri i shkollave	4	4	10	14
Numri i nxënësve	630	1 250	5 100	8 090
Numri i aktiviteteve	23	23	73	123
Shpenzime gjithsej(2)	1 000	4 495	5 613	29 652

SHPENZIME TË DETAJUARA PËR SEMINARET (pa specialistin e jashtëm)

1997

Përshkrimi	Tetor
Numri i ditëve	3
Numri i pjesëmarrësve	22
Shpenzime ditore	1356
Specialistët shqiptarë	--
Shërbime	366
Kartoleri	64
Qira lokalesh / pushime për kafe	3 008
Gjithsej	4 794

1998

Përshkrimi	Shkurt	Prill	Shtator	Tetor	Gjithsej
Numri i ditëve	2	2	1	2	7
Numri i pjesëmarrësve	37	29	24	30	119
Shpenzime ditore	973	658	669	1 283	3 583
Specialistët shqiptarë	--	--	--	--	--
Shërbime	255	363	73	526	1 217
Kartoleri	40	32	139	140	351
Qira lokalesh / pushime për kafe	704	762	70	1130	2 666
Gjithsej	1972	1 815	951	3 079	7 817

1999

Përshkrimi	Shkurt	Shtator	Tetor	Gjithsej
Numri i ditëve	1	1	2	4
Numri i pjesëmarrësve	28	30	49	107
Shpenzime ditore	524	504	2606	3 634
Specialistët shqiptarë	73	30	61	164
Shërbime	--	431	378	809
Kartoleri	109	149	152	410
Qira lokalesh / pushime për kafe	129	500	1974	2 603
Shpenzime gjithsej	835	1614	5 171	7 620

2000

Përshkrimi	Shkurt	Shtator	Gjithsej
Numri i ditëve	3	3	6
Numri i pjesëmarrësve	70	131	201
Shpenzime ditore	5 230	10 150	15 380
Specialistët shqiptarë	309	270	579
Shërbime	207	555	762
Kartoleri	184	494	678
Qira lokalesh / pushime për kafe	1 500	1 115	2 615
Gjithsej	7 430	12 584	20 014

SHTOJCA B

**PROCEDURAT E VLERËSIMIT GJATË FAZËS SË DYTË
PLOTËSUAR NGA PJESËMARRËSIT GJATË ZBATIMIT
SHKURT-MAJ 2000**

**PROCEDURAT E VLERËSIMIT GJATË FAZËS SË DYTË
PLOTËSUAR NGA PJESËMARRËSIT GJATË ZBATIMIT
SHKURT-MAJ 2000**

FORMULARI TITULLI

- (A) & (B) Intervistat e mësuesve (me gojë) para dhe pas pilotimit të aktiviteteve të reja të shtuara në Fazën e Dytë.
- (C) & (D) Pyetësorët e mësuesve (me shkrim) para dhe pas periudhës së pilotimit të aktiviteteve.
- (E) Lista e vëzhgimit të mësimin plotësuar nga anëtarët e Ekipit Qendror dhe mësuesit kolegë gjatë një aktiviteti të Edukimit Global.
- (F) Fleta feedback e nxënësve plotësuar nga afro 5 prej nxënësve që morën pjesë në aktivitet.
- (G) Fleta feedback e mësuesit plotësuar pas zbatimit të çdo aktiviteti të Edukimit Global.
- (H) Ditarët e mësuesve që përfshinin refleksionet e tyre mbi praktikën e Edukimit Global në klasat e tyre.

FORMULARI→ LËNDA↓	# i (A)	# i (B)	# i (C)	# i (D)	# i (E)	# i (F)	# i (G)	# i (H)
Edukatë Qytetare	1/1*		9/1	9/1	70/7	537/53	79/7	10
Matematikë	1/1	2/2	21/2	23/2	140/14	675/67	141/14	15
Gjuhë Shqipe	2/2	1/1	19/2	19/2	255/25	465/46	228/22	9
Histori/ Gjeografi	3/3	1/1	7/1	11/1	50/5	283/28	54/5	13
Dituri Natyre			8/1	8/1	40/4	239/23	42/4	
Mbledhur gjithsej/ Analizuar	7/ 7	4/ 4	64/ 7	70/ 7	555/ 55	2199/ 219	544/ 42	47/ ??

- Numri i mbledhur/ numri i analizuar

A. INTERVISTA PARA TESTIMIT

Dhjetë pyetjet e mëposhtme janë shkruar si pyetje udhëzuese për të nxitur përgjigjen e mësuesit për çështjet kritike të vlerësimit. Secila prej tyre duhet të ndiqet me pyetje shtesë të hapura ose me ndërhyrje të përcaktuara për të qartësuar më shumë përgjigjet e tyre (për shembull: “Çfarë kuptoni kur thoni se ...?”, “Më jepni një ose dy shembuj për të argumentuar atë që po thoni”; “A mund ta shtjelloni më mirë këtë çështje?”

1. Cilat mendoni se janë cilësitë më të rëndësishme të një mësuesi?
2. Cilat janë mendimet tuaja për seminarët në të cilat keni marrë pjesë?
3. A e gjykoni të vlefshme përgatitjen tuaj paraprake për testimin e aktiviteteve?
4. Sipas mendimit tuaj, sa i shërbejnë aktivitetet arritjes së synimeve të kurrikulës?
5. Cilat janë shpresat dhe shqetësimet tuaja fillestare për zhvillimin e aktiviteteve në klasë?
6. A mund të veçoni ndonjë aktivitet që ju shqetëson dhe të shpjegoni arsyet e shqetësimit tuaj?
7. A mund të veçoni një aktivitet për të cilin mendoni që në fillim se do të jetë i suksesshëm? A mund të shpjegoni pse mendoni se ky aktivitet do të jetë i suksesshëm?
8. Në cilat drejtime i parashikoni ndryshimet e klasës gjatë periudhës së pilotimit?
9. Si i parashikoni përgjigjet e nxënësve gjatë aktiviteteve?
10. Përshkruani si e kuptoni ju edukimin global.

B. INTERVISTA PAS TESTIMIT

Këtë herë 12 pyetjet udhëzuese të parashtruara më poshtë duhet të shoqërohen me pyetje shtesë të hapura dhe nxitëse.

1. Cili është vlerësimi juaj i përgjithshëm i testeve?
2. A keni pasur pengesa ose vështirësi gjatë zhvillimit të testimit? Cilat kanë qenë ato?
3. Në cilat drejtime mendoni se testet kanë qenë më të suksesshme?
4. Në cilat drejtime mendoni se testet kanë qenë më pak të suksesshme?
5. A kanë ndryshuar qëndrimet tuaja ndaj aktiviteteve gjatë periudhës së pilotimit? Shpjegoni.
6. A kanë ndryshuar qëndrimet e nxënësve ndaj aktiviteteve gjatë periudhës së pilotimit? Si?
7. A ka ndikuar pilotimi në rishikimin e mënyrës së drejtimit të klasës dhe të mësimdhënies? Shpjegoni.
8. A ua keni bërë të njohura kolegëve tuaj aktivitetet (mësimet) e pilotuara? Si e keni realizuar këtë? Cili ka qenë rezultati?
9. Në qoftë se do të përshkruanit, në mënyrë të përmblodhur, vetëm me katër fjalë, përvojën e pilotimit, cilat do të ishin ato?
10. Nëse do t'i përsërisnit mësimet e pilotuara çfarë ndryshimesh do të dëshironit të bënit në to?
11. Gjatë intervistës para testimit ju keni identifikuar disa nga shpresat dhe shqetësimet tuaja. Në çfarë shkalle mendoni se ju janë realizuar shpresat dhe janë justifikuar shqetësimet?
12. Cilat mendoni se janë cilësitë më të rëndësishme të një mësuesi?

C. PYETËSORI PARA TESTIMIT

1	EMRI, MBIEMRI	
---	---------------	--

2	SHKOLLË URBANE	
	SHKOLLË RURALE	

3	SHKOLLË SHTETËRORE	
	SHKOLLË PRIVATE	

4	KLASË E PËRZIER	
	KLASË ME MESHKUJ	
	KLASË ME FEMRA	

- Rendisni 5 cilësitë më të rëndësishme që duhet të ketë një mësues.
- Shkruani tri komente të cilat përmbledhin pështypjet tuaja për seminarët në të cilat këni marrë pjesë.
- Cila është, sipas mendimit tuaj, cilësia e aktiviteteve të hartuara për pilotim? Rrethoni numrin që shpreh mendimin tuaj.

I përgatitur shumë mirë	I përgatitur mirë	I përgatitur mjaftueshëm	I përgatitur jo mirë	I përgatitur keq
5	4	3	2	1

- Cilat janë shpresat dhe shqetësimet tuaja për pilotimin? Shprehni deri në tri prej tyre.

Shpresat	Shqetësimet

9. Cili do të jetë, sipas mendimit tuaj, qëndrimi i nxënësve ndaj aktiviteteve? Rrethoni numrin që shpreh mendimin tuaj.

Shumë pozitiv	Pozitiv	I papërcaktuar	Negativ	Shumë negativ
5	4	3	2	1

10. Cilat janë, sipas mendimit tuaj, qëllimet e edukimit global?

D. PYETËSORI PAS TESTIMIT

1	EMRI, MBIEMRI	
---	---------------	--

2	SHKOLLË URBANE	
	SHKOLLË RURALE	

3	SHKOLLË SHTETËRORE	
	SHKOLLË PRIVATE	

4	KLASË E PËRZIER	
	KLASË ME MESHKUJ	
	KLASË ME FEMRA	

5. Sa të suksesshme mendoni se kanë qenë, në përgjithësi, aktivitetet e hartuara për pilotim? Rrethoni numrin që shpreh mendimin tuaj dhe shpjegoni përgjigjen.

I përgatitur shumë mirë	I përgatitur mirë	I përgatitur mjaftueshëm	I përgatitur jo mirë	I përgatitur keq
5	4	3	2	1

Shpjegimi:

6. Shkruani katër fjalë që përmbledhin vlerën e aktiviteteve.
7. Cilat aktivitete kanë qenë më të suksesshme dhe cilat më pak të suksesshme? Tregoni 2 aktivitete për secilin rast.

Më të suksesshëm	1. 2.
------------------	----------

Më pak të suksesshëm	1. 2.
----------------------	----------

8. A ka pasur pengesa në klasë ose në shkollë të cilat e kanë bërë të vështirë kryerjen e pilotimit? Në qoftë se po, ju lutemi i përshkruani ato.

9. Cili ka qenë qëndrimi i nxënësve ndaj aktiviteteve? Rrethoni numrin që shpreh mendimin tuaj.

Shumë pozitiv	Pozitiv	I papërcaktuar	Negativ	Shumë negativ
5	4	3	2	1

10. Në çfarë shkalle mendoni se aktivitetet i kanë realizuar synimet e kurrikulës? Rrethoni numrin që shpreh mendimin tuaj dhe shpjegoni zgjedhjen tuaj.

Shumë i suksesshëm	I suksesshëm	I mjaftueshëm	Jo i suksesshëm	Fare pa sukses
5	4	3	2	1

Shpjegimi:

11. Nëse do të përsërisnit aktivitetet e pilotimit a do të bënit ndryshime në to? Nëse po, i përshkruani ato.
12. Rendisni 5 cilësitë më të rëndësishme që duhet të ketë një mësues.
13. Cilat janë, sipas mendimit tuaj, qëllimet e edukimit global ?

E. LISTA E VËZHGIMIT TË MËSIMIT

EMRI I MËSUESIT	
TITULLI I AKTIVITETIT	

SHKOLLË URBANE	
SHKOLLË RURALE	

SHKOLLË SHTETËRORE	
SHKOLLË PRIVATE	

KLASË E PËRZIER	
KLASË ME MESHKUJ	
KLASË ME FEMRA	

ÇËSHTJET E VËZHGIMIT	SHËNIME
SHPJEGIMI I AKTIVITETIT <ul style="list-style-type: none"> • A ËSHTË KUPTUAR QARTË PROCEDURA NGA TË GJITHË NXËNËSIT APO NGA SHUMICA E TYRE? • A JANË DHËNË TË GJITHA SQARIMET E NEVOJSHME? 	
BURIMET <ul style="list-style-type: none"> • A EKZISTOJNË BURIMET E NEVOJSHME (DUKE PËRFSHIRË HAPËSIRËN E KLASËS)? • A JANË ATO TË PËRSHTATSHME? 	
AFTËSITË E NXËNËSVE <ul style="list-style-type: none"> • A KANË NXËNËSIT NJOHURI DHE AFTËSI TË MJAFTUESHME PËR TË PËRMBUSHUR ME SUKSES AKTIVITETIN? 	

<p>PËRFSHIRJA E NXËNËSVE</p> <ul style="list-style-type: none"> • A JANË TË GJITHË NXËNËSIT APO PJESA MË E MADHE E TYRE E PËRFSHIRË NË MËNYRË AKTIVE NË SECILËN PJESË TË AKTIVITETIT? 	
<p>INTERESIMI OSE MOTIVIMI I NXËNËSVE</p> <ul style="list-style-type: none"> • A JANË TË GJITHË , PJESA MË E MADHE, PAK NXËNËS TË INTERESUAR APO TË MOTIVUAR PËR TË ZHVILLUAR AKTIVITETIN? 	
<p>NDRYSHIMET NË AKTIVITET</p> <ul style="list-style-type: none"> • A JANË BËRË NDRYSHIME APO PËRSHTATJE NË AKTIVITET? • A JANË HEQUR APO SHTUAR FAZA TË TJERA NË AKTIVITET? 	
<p>PËRSHKRIMI PËRMBLEDHËS I AKTIVITETIT</p> <ul style="list-style-type: none"> • SA PËRFITON MËSUESI NGA PËRVOJA E NXËNËSVE NË AKTIVITET DHE SA E ZGJERON AI ATË? • A JANË TË GJITHË, PJESA MË E MADHE APO PAK NXËNËS TË PËRFSHIRË NË PËRSHKRIMIN PËRMBLEDHËS TË AKTIVITETIT? 	
<p>OBJEKTIVAT E KURRIKULULËS</p> <ul style="list-style-type: none"> • NË ÇFARË SHKALLE CILËSIE I PLOTËSON AKTIVITETI OBJEKTIVAT E KURRIKULËS PËR KËTË MËSIM? 	
<p>KOHA</p> <ul style="list-style-type: none"> • KOHA ËSHTË E MJAFTUESHME, E PAMJAFTUESHME APO E TEPËRT PËR TË PËRMBUSHUR TË GJITHA FAZAT E AKTIVITETIT (DUKE PËRFSHIRË EDHE PËRSHKRIMIN PËRMBLEDHËS)? 	
<p>DREJTIMI MËSUES- NXËNËS (PËRMBLEDHJE)</p> <ul style="list-style-type: none"> • SA PËRQIND E MËSIMIT ËSHTË DREJTUAR NGA MËSUESI? • SA PËRQIND E MËSIMIT ËSHTË DREJTUAR NGA NXËNËSI? • SA PËRQIND E KOHËS SË MËSIMIT ËSHTË SHPENZUAR NGA NXËNËSIT: 	

<ul style="list-style-type: none">- PËR TË DËGJUAR MËSUESIN,- PËR TË PUNUAR ME DETYRA INDIVIDUALE,- PËR TË PUNUAR ME GRUPE TË VOGLA,- PËR DISKUTIME ME TË GJITHË KLASËN?- TË TJERA (JEPNI HOLLËSIRA)	
VËZHGIME TË TJERA	

F. FLETA E FEEDBACK-ut TË NXËNËSIT

1. Çfarë ju pëlqeu nga mësimi (në qoftë se ju pëlqeu ndonjë gjë)?
2. Çfarë nuk ju pëlqeu nga mësimi (në qoftë se nuk ju pëlqeu ndonjë gjë)?
3. Çfarë ju habiti nga mësimi (në qoftë se ju habiti ndonjë gjë)?
4. Çfarë mësuat nga mësimi (në qoftë se mësuat ndonjë gjë)?
5. Në qoftë se do të zhvillohej i njëjti mësim a do të dëshironit të ishte i ndryshëm?
Nëse po në çfarë drejtimesh?
6. Vlerësoni mësimin duke përdorur numrat nga 1 deri në 4.

Mësimi më pëlqeu shumë	Mësimi më pëlqeu	Mësimi nuk më pëlqeu	Mësimi nuk më pëlqeu fare
4	3	2	1

G. FLETA E FEEDBACK-ut TË MËSUESIT

1	AKTIVITETI Nr.	
2	SHKOLLË URBANE	
	SHKOLLË RURALE	
3	SHKOLLË SHTETËRORE	
	SHKOLLË PRIVATE	
4	KLASË E PËRZIER	
	KLASË ME MESHKUJ	
	KLASË ME FEMRA	

1. Kohëzgjatja e aktiviteteve (përfshirë edhe diskutimet)

_____minuta

2. A ishte aktiviteti, sipas mendimit tuaj, i përshtatshëm për të realizuar qëllimet e temës së veçantë të kurrikulës? Shpjegoni përgjigjet tuaja.
3. Si u prit aktiviteti nga nxënësit? Nëse e shihni të nevojshme, përshkruani përgjigje të veçanta të nxënësve.
4. A u arritën, sipas mendimit tuaj, objektivat e përshkruara në potencial? Nëse po, jepni detaje.
5. A kishte arritje të tjera përveç atyre të parashikuar në potencial? Nëse po jepni detaje.
6. A ishte përshkrimi i aktivitetit sipas ecuresë krejtësisht i qartë? Në qoftë se jo, si do ta ndryshonit atë?

PO	
JO	

11. A ndoqët hapat e përshkruar sipas ecuresë dhe sipas radhës që sugjerohet? Në qoftë se jo, çfarë nuk ndoqët, nuk përmirësuar apo nuk shtuat? Jepni detaje.

PO	
JO	

12. Në qoftë se do ta ribënit aktivitetin, a do ta ndryshonit atë? Jepni detaje.

SHTOJCA C

**PROCEDURAT PËR INTERVISTAT GJYSËM TË STRUKTURUARA
TË BËRA GJATË HARTIMIT TË RAPORIT TË VLERËSIMIT
NËNTOR, 2000**

DREJTORËT DHE INSPEKTORËT
U intervistuan katër drejtorë dhe një inspektor

1. Pse zgjodhët që shkolla/rrethi juaj të merrte pjesë në Projektin e Edukimit Global?
2. A besoni se ky projekt ka kontribuar në jetën e nxënësve tuaj? Në qoftë se Po, si? Në qoftë se Jo, pse jo?
3. A besoni se ky projekt ka kontribuar në jetën e mësuesve tuaj? Në qoftë se Po, si? Në qoftë se Jo, pse jo?
4. A keni pasur ndonjë përfitim nga ky projekt?
5. Ç' mbështetje i keni dhënë këtij projekti?
6. Çfarë do të rekomandonit për shtrirjen e këtij projekti?
7. Çfarë arsyesh të tjera mund të ketë për ndryshimet për të cilat kemi folur? Trainime të tjera, etj?
8. A besoni se kjo pjesëmarrje e shkollës në këtë projekt ka dhënë apo do të japë kontribut në marrëdhëniet shkollë-komunitet?

MËSUESIT E EDUKIMIT GLOBAL
U intervistuan tre mësues të EDUKIMIT GLOBAL

1. Sa kohë keni që jepni mësim?
2. Pse zgjodhët që të përfshiheshit në këtë projekt?
3. Kur jeni trainuar në Edukimin Global? Sa kohë pas kësaj filluat ta praktikoni?
4. Keni pasur ndonjë trainim tjetër të ngjashëm me këtë? Në qoftë se po, a mendoni se ai e mbështet trainimin e Edukimit Global apo s'ka të bëjë fare me të?
5. Sa të lirshëm dhe të sigurtë ndiheni kur praktikoni Edukimin Global në klasë? Nëse nuk jeni të lirshëm/sigurtë, pse jo?
6. Si ka ndikuar futja e Edukimit Global në organimin e klasës suaj? Jepni shembuj. Si ndiheni në lidhje me këtë lëvizje drejt integritit?
7. A jeni në gjendje të integroni metodat e Edukimit Global në aktivitetet e klasës? Nëse po, jepni shembuj. Nëse jo, pse jo?
8. Si po i aplikoni temat në klasën tuaj? A ju duket se aktivitetet dhe temat përputhen me lëndën e kërkuar? Nëse po, jepni shpjegime. Nëse jo, pse jo?
9. A keni pasur mbështetje nga Ekipi Qendror për të përforcuar përdorimin nga ana juaj të metodave të Edukimit Global? Po nga drejtori?
10. Çfarë lloj mbështetje do të donit të kishit për t'iu lehtësuar zbatimin e Edukimit Global?
11. Në qoftë se do të prezantonit mësues të rinj me këto parime e praktika, çfarë do të donit që ata të dinin?
12. A keni pasur ndonjë mbështetje nga prindërit në fillimin e këtij projekti?
13. A besoni se ky projekt do të japë kontribut në jetën e nxënësve tuaj? Në qoftë se po, si? Në qoftë se jo, pse jo?
14. A besoni se ky projekt do të japë kontribut në jetën tuaj si mësues dhe si qytetar? Në qoftë se po, si? Në qoftë se jo, pse jo?

MËSUESIT JO TË EDUKIMIT GLOBAL
U intervistuan tre mësues jo të EDUKIMIT GLOBAL

1. Sa kohë keni që jepni mësim?
2. Çfarë dini për Projektin e Edukimit Global? Si dëgjuat për të?
3. Bazuar mbi çfarë dini, a dëshironi t'i sillni aktivitetet dhe metodat e Edukimit Global në klasën tuaj?
4. Si ndiheni në lidhje me lëvizjen drejt më shumë integrimi ndërlëndor në klasë?
5. Cila është përvoja juaj në aplikimin e integritit ndërlëndor?
6. Keni pasur ndonjë trainim për metodat interaktive si ato që përdoren në Projektin e Edukimit Global?
7. A po e praktikoni atë në klasë?
8. Çfarë merak apo shqetësimesh keni për përdorimin e këtyre metodave në klasën tuaj?
9. Çfarë lloj mbështetjeje do të jua lehtësonte praktikimin e këtyre metodave?
10. Cilat besoni ju se janë cilësitë më të rëndësishme të një mësuesi?
11. Çfarë besoni se u nevojitet fëmijëve nga shkollat dhe mësuesit për tu bërë qytetarë shqiptarë më të mirë?

NXËNËSIT**Zhvilluar në grupe në katër shkolla me 30 nxënës gjithsej**

1. Më thoni një gjë që ju pëlqen tek mësuesit tuaj?
2. A vini re ndonjë ndryshim midis mësuesve tuaj të Edukimit Global dhe mësuesve jo të Edukimit Global?
3. A keni vënë re ndonjë ndryshim në orët tuaja të mësimit qëkurse mësuesit tuaj filluan të përdornin projektin e Edukimit Global? Nëse po, cili është ndryshimi?
4. A mund të më jepni një shembull të diçkaje që keni mësuar për njerëz apo vende diku tjetër në Shqipëri ose në botë si rezultat i aktiviteteve të Edukimit Global?
5. A keni mësuar ndonjë gjë rreth së shkuarës, së tashmes dhe së ardhmes që ju mendoni se është e rëndësishme për jetën tuaj sot?
6. Tani që keni marrë pjesë në aktivitetet e Edukimit Global, a bëni ndonjë gjë ndryshe në klasë ose me prindërit e miqtë tuaj?
7. A besoni se ju keni një rol në ruajtjen e mjedisit dhe sjelljen e paqes në komunitetin/lagjen tuaj apo në botë? Në qoftë se po, në ç' mënyrë?

ANËTARËT E EKIPIT QENDROR
U intervistuan pesë anëtarë

1. Cilat kanë qenë pengesat/barrierrat dhe lehtësuesit për:
 - a. Zhvillimin e kurrikulës
 - b. Trainimin e mësuesve
 - c. Zbatimin me nxënësit
 - d. Burimet ekzistuese dhe burimet e nevojshme
2. A keni pasur mundësi të shihni në vende të tjera projektin e Edukimit Global ose programe të ngjashme?
3. Në qoftë se Shqipërisë do t'i kërkohet të ndihmonte një vend tjetër në zbatimin e programit të Edukimit Global, çfarë lloj asistence mund të ofrojë Shqipëria?
4. Çfarë mund të bëjë Ministria e Arsimit dhe Shkencave për të mbështetur zbatimin dhe shtrirjen e Edukimit Global?

SHTOJCA D

**ANËTARËT E EKIPIT QENDROR
DHE SHKOLLAT PJESËMARRËSE**

ANËTARËT E EKIPIT QENDROR

- | | |
|---------------------|--|
| 1. Astrit Dautaj | Instituti i Studimeve Pedagogjike |
| 2. Fatmira Myteberi | Instituti i Studimeve Pedagogjike |
| 3. Mimoza Gjokutaj | Instituti i Studimeve Pedagogjike |
| 4. Stavri Llambiri | Instituti i Studimeve Pedagogjike |
| 5. Bukurie Rexha | Shkolla “Dora D’Istria” – Drejtoreshë |
| 6. Iris Kodra | Shkolla “Dora D’Istria”,
Edukatë Qytetare |
| 7. Lidra Remaçka | Shkolla “Sabaudin Gabrani”,
Gjuhë Shqipe |
| 8. Violeta Xhanari | Shkolla “Sabaudin Gabrani”, Biologji |
| 9. Fatos Bajraktari | Shkolla “Xhaferr Kongoli”, Matematikë |

SHKOLLAT PJESËMARRËSE NË PROJEKT

Faza e Parë: 1997-1999

<u>EMRI I SHKOLLËS</u>	<u>QYTETI</u>
Dora D'Istria	Tiranë
Ramazan Jarani	Tiranë
Sabaudin Gabrani	Tiranë
Kushtrim i Lirisë	Durrës
Xhaferr Kongoli	Elbasan
Branko Kadia	Shkodër

Faza e Dytë: 1999-2000

<u>EMRI I SHKOLLËS</u>	<u>QYTETI</u>
Rilindja	Kavajë
Lissus	Lezhë
Naum Veqilharxhi	Korçë
28 Nëntori	Vlorë

Faza e Tretë: 2000 – 2001

<u>EMRI I SHKOLLËS</u>	<u>QYTETI</u>
Shkolla Nr. 3, Laç	Kurbin
Shkolla Nr.1, Fushë Krujë	Krujë
Shkolla Skënder Libohova	Lushnjë
Shkolla e Konispolit	Sarandë

SHTOJCA E
LISTA E AKTIVITETEVE

LISTA E AKTIVITETEVE

MATEMATIKË

Klasa e pestë

1. Kush është më i vogël se unë?
2. Në treg (Një koktejl)
3. Ne jemi të një sipërfaqshëm
4. Rrumbullakimi i numrave
5. Cila është figura më e bukur?
6. Mbledhja dhe zbritja e gjatësive
7. Bum!
8. Një tabelë e çuditshme
9. Numri dhjetor
10. Cili është më i zoti të çmojë me sy gjatësitë?
11. Cilët janë më shtatlartët?
12. Më e bukura!
13. Kutia pa kapak
14. Dy e nga dy me shumë të njëjtë

Klasa e gjashtë

1. Me sa më shumë mënyra, aq më mirë
2. Çfarë mësova të re në këtë kapitull?

Klasa e shtatë

1. *Lojë thyesash me letra*
2. *Kujdes! Kur skadon?*
3. *Gjej në qoftë se mundesh figurën që kam vizatuar*
4. *Cilin numër kam në mendje?*
5. *Ne do të vazhdojmë shkollën*
6. *Lojë me letra me numrat dhjetorë*
7. *Njeri pas tjetrit*
8. *Dy e nga dy me prodhim të njëjtë*
9. *Cilin do të blija unë?*
10. *Le të formojmë së bashku katër katrorë!*
11. *Energjia elektrike...Sa shumë probleme!*
12. *Matematika rreth nesh*
13. *Kjo është një marrëveshje e mirë!*
14. *Gjeni në qoftë se mundeni figurën për të cilën po mendoj*
15. *Popullsia e botës*
16. *E drejta për të jetuar*
17. *Të drejtat e fëmijëve*
18. *Shumëzimi i numrave negativë*
19. *Le të zmadhojmë shpejt figura të bukura*

GJUHË SHQIPE**Klasa e pestë**

1. Sinonimet dhe antonimet
2. Shprehjet frazeologjike
3. Ftojmë, urojmë, falenderojmë
4. Fjalia nxitëse
5. Fjalia e përbërë
6. Dje, sot, nesër
7. Përdorimi i fjalorëve
8. Katër stinët
9. Ushqimi
10. Dita e piknikut
11. Pyesim dhe përgjigjemi
12. Dobia e pyjeve për planetin
13. Tregojmë ngjarje që na kanë ndodhur
14. Ushqimi i kafshëve
15. Fjalia me pjesë të nënrenditura përcaktuese
16. Fjalia pyetëse
17. Rendi i fjalëve në fjali
18. Kuptimi i parë dhe i figurshëm i fjalëve
19. Mënyrat e tjera të foljes
20. Ndërtojmë tregime të thjeshta
21. Vjeshta
22. Tri anekdota
23. Lypsi i vogël

Klasa e gjashtë

1. Tregojmë, njoftojmë, përshkruajmë
2. Fjalia vendore dhe kohore
3. Të mënjanojmë konfliktet
4. Njoftimi, reportazhi, intervista
5. Përemrat pyetës
6. Fjalia shkakore
7. Flasim për modën
8. Tregojmë dhe shkruajmë ngjarje komike
9. Shpjegojmë shkaqet e keqkuptimeve
10. Një çikë mjaltë
11. Një mbrëmje në Lurë
12. Nëpër rrugët e Azisë
13. Kitaristi
14. Bilbili
15. Hej moj zanë
16. Burri i vogël që...
17. Korbi dhe dhelpira
18. Qortimet e vjeshtës
19. Ka mënyra të ndryshme për tu shprehur
20. Lypsi i vogël

Klasa e shtatë

1. *Fjalorët*
2. *Anekdotat dhe skeçe*
3. *Lidhëzat*
4. *Parafjalët*
5. *Le të shkruajmë poezi*
6. *Metaforat*
7. *Ushtrime mbi tiparet e emrave*
8. *Gjeniu i vogël*
9. *Qyteti i lashtë*
10. *Kopraci*
11. *Erë bjeshke, erë malesh*
12. *Gurra dhe oqeani*
13. *Dhe pranvera erdhi...*

EDUKATË QYTETARE**Klasa e pestë**

1. Sistemi arsimor shqiptar
2. Cili është mësimi më i mirë për ty
3. Përdorimi i tekstit shkollor
4. Si të lexojmë një pikturë
5. Krijimtaria
6. Respekti
7. Qytetaria në shkollë
8. Komuniteti
9. Llojet e komunitetit
10. Qytetarët i shërbejnë komunitetit
11. Klubet vullnetare

Klasa e gjashtë

12. Të drejtat dhe liritë e njeriut në dokumenta
13. Të drejtat dhe përgjegjësitë
14. Të drejtat e fëmijëve
15. Grupet e pakicës
16. *SIDA*
17. *Si mund të na ndihmojnë ligjet*
18. *Edhe unë*

Klasa e shtatë

19. *Opinionet publik dhe propaganda*
20. *Dallimi i faktit nga opinionet*
21. *Si të lexojmë një artikull.*

.

HISTORI DHE GJEOGRAFI

Gjeografi

1. *Formimi i kontinenteve*
2. *Porti detar*
3. *Relievi i kontinenteve*

Histori

4. *Feudalët dhe bujkrobërit*
5. *Qytetet*
6. *Zhvillimi i kulturës*
7. *Kryeqytetet*

DITURI NATYRE

1. *Gjallesat hanë dhe hahen nga të tjerat*
2. *Bimët e zgjedhin vetë vendin e rritjes*
3. *Kafshët zgjedhin se ku të jetojnë*
4. *Gjej gjallesën dhe ku jeton ajo*
5. *Riprodhimi i gjallesave*
6. *Mbirja e farës*
7. *Si mund ta rrisim energjinë elektrike*
8. *Pjalmimi i bimëve me lule*
9. *Udhëtimi i farës*

SHTOJCA F
MATRICAT E AKTIVITETEVE
DHE DIMENSIONEVE TË EDUKIMIT GLOBAL

MATEMATIKË – KLASA E PESTË

<i>Dimensioni/Aktivitetet</i>	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	
Dimensioni hapsinor	✓	✓																		
Dimensioni kohor	✓								✓											
Dimensioni i çështjeve																				
-Edukatë shëndetsore		✓					✓											✓		
-Mjedisi																				
-Paqja dhe konfliktet																				
-Të drejtat dhe përgjegjësitë																				
Dimensioni i brendshëm	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Metoda																				
-Punë çift	✓		✓					✓									✓			
-Punë me grupe të vogla		✓	✓	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
-Lojë me role		✓				✓														
-Simulim		✓																		
-Punë individuale	✓	✓	✓	✓		✓	✓		✓	✓		✓	✓		✓	✓	✓	✓	✓	✓

MATEMATIKË – KLASA E GJASHTË DHE E SHTATË

<i>Dimensioni/Aktivitetet</i>	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
Dimensioni hapsinor		✓		✓	✓			✓	✓			
Dimensioni kohor				✓	✓			✓	✓			
Dimensioni i çështjeve												
-Edukatë shëndetsore										✓		
-Mjedisi					✓				✓			
-Paqja dhe konfliktet					✓			✓				
-Të drejtat dhe përgjegjësitë					✓				✓	✓		
Dimensioni i brendshëm	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Metoda												
-Punë çift												
-Punë me grupe të vogla		✓	✓	✓	✓		✓	✓		✓	✓	✓
-Lojë me role			✓		✓							
-Simulimi												
-Punë individuale		✓	✓	✓	✓		✓	✓		✓	✓	✓

EDUKATË QYTETARE

<i>Dimensioni/Aktivitetet</i>	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
Dimensioni hapsinor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓			✓	✓	✓	
Dimensioni kohor	✓	✓		✓	✓	✓	✓	✓			✓	✓		✓
Dimensioni i çështjeve				✓						✓				
-Edukatë shëndetsore														
-Mjedisi					✓			✓	✓	✓		✓		✓
-Paqja dhe konfliktet					✓	✓			✓			✓		
-Të drejtat dhe përgjegjësitë		✓	✓		✓	✓				✓		✓		
Dimensioni i brendshëm	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Metoda														
-Punë çift														
-Punë me grupe të vogla	✓	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓	✓		✓		✓
-Lojë me role														
-Simulimi														
-Punë individuale	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓	✓			✓		✓

DITURI NATYRE

<i>Dimensioni/Aktivitetet</i>	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Dimensioni hapsinor	✓	✓	✓	✓	✓		✓	✓	✓
Dimensioni kohor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Dimensioni i çështjeve									
-Edukatë shëndetsore				✓	✓	✓		✓	
-Mjedisi	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
-Paqja dhe konfliktet				✓					
-Të drejtat dhe përgjegjësitë		✓	✓						
Dimensioni i brendshëm	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Metoda									
-Punë çift				✓				✓	
-Punë me grupe të vogla		✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
-Lojë me role	✓								✓
-Simulimi		✓	✓		✓	✓	✓		✓
-Punë individuale		✓	✓		✓	✓	✓		✓

HISTORI / GJEOGRAFI

<i>Dimensioni/Aktivitetet</i>	1	2	3	4	5	6	7
Dimensioni hapsinor	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Dimensioni kohor	✓			✓	✓	✓	✓
Dimensioni i çështjeve							
-Edukatë shëndetsore							
-Mjedisi		✓					
-Paqja dhe konfliktet							
-Të drejtat dhe përgjegjësitë	✓			✓			
Dimensioni i brendshëm	✓	✓	✓		✓	✓	✓
Metoda							
-Punë çift							
-Punë me grupe të vogla	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
-Lojë me role					✓		
-Simulimi						✓	
-Punë individuale	✓	✓		✓	✓	✓	✓

SHTOJCA G
SHEMBUJ AKTIVITETESH

Aktiviteti	1
Lënda	Matematikë
Klasa	8
Tema	Pema ime gjenealogjike
Kohëzgjatja	100'

Objektivat

Nxënësve t'u jepet mundësia:

- Të përforcojnë kuptimin e fuqisë dhe ta zbatojnë atë në situata realiste, jo rutinë.
- Të kuptojnë lidhjen ndërmjet të kaluarës së familjes së tyre dhe të tashmes së tyre, si një aspekt i ndikimit të së kaluarës tek e tashmja dhe tek e ardhmja.
- Të forcojnë lidhjet afektive në familje përmes njohjes më të mirë të historisë së saj.

Mjetet

- Nga një fletë A4 për secilin nxënës.
- Nga një Fletë 3 për çdo grup me 4-5 nxënës. (Kjo fletë i është bashkëngjitur aktivitetit.)

Ecuria

Hapi i parë (15 minuta)

Një nxënës i shpërndan nga një fletë A4 secilit bashkënxënës.

Mësuesi vizaton një kutizë nga fundi i tabelës së zezë dhe thotë “Këtu po shkruaj emrin tim”. Nxënësit vizatojnë kutizën nga fundi i fletës së tyre dhe secili shkruan aty emrin e vet. (Në fletën A4 do të punohet për së gjeri.)

Pastaj mësuesi vendos mbi kutizën e vet një bigëzim si në Fletën 3, vizaton dy kutiza të tjera dhe thotë: “Këtu janë emrat e prindërve të mij”. Ai shkruan emrin e nënës në njërin kutizë dhe të babait në kutizën tjetër. Nxënësit e imitojnë.

Mësuesi shton një bigëzim te kutiza e babait duke thënë “Edhe babai im ka prindët e tij” dhe vizaton dy kutizat përkatëse. “Kështu mund të vazhdojmë gjatë. Kjo quhet “pema gjenealogjike”, përfundon ai.

Mësuesi i porositi që secili nxënës “ta rrisë pemën edhe ca” dhe të shënojë emrat e familjes së vet deri sa mundet. Ai u jep për model nga një Fletë 3 për grup.

Hapi i dytë (10 minuta)

Klasa ndahet në grupe me nga 4-5 nxënës.

Nxënësit e secilit grup u tregojnë njeri-tjetrit punë e vet dhe bëjnë korrigjimet e mundshme.

Mësuesi vizaton në tabelën e zezë boshtin numerik si në Fletën 3. Nxënësit e imitojnë në fletën e tyre.

Mësuesi shkruan në tabelë fjalët “unë” dhe “prindët” ashtu siç është treguar në Fletën 3 dhe nxënësit shkruajnë këto fjalë në fletët e tyre.

Pastaj mësuesi i pyet nxënësit se cilat fjalë duhen shkruar më sipër në bosht. (“Stërgjysh” dhe “katragjysh” është përgjigja) Nxënësit i shkruajnë këto dy fjalë krahas boshtit numerik.

Mësuesi i nxiti nxënësit të shpikin fjalën që duhet të vijë pas fjalës “katragjysh”.

(Fjala “katragjysh” duhet të tregojë se bëhet fjalë për brezin e katërt, nëse marrim si brez të parë “unë”. Po qe se është kështu, fjala pasonjëse duhet të jetë “pesëgjysh” e pastaj “gjashtëgjysh”, etj.)

Hapi i tretë (15 minuta)

Mësuesi pyet klasën “Sa gjyshër ka secili prej nesh? Sa stërgjyshër? Po katragjyshër?

Ai vizaton në tabelën e zezë tabelën e mëposhtme dhe u kërkon grupeve të vazhdojnë plotësimin e saj deri te brezi i gjashtë.

Numri i brezave	1	2	3	4	5	6	...	n
Numri i vetëve të një brezi	1	2	4				...	y =


Pasi verifikohet puna e grupeve, kalohet në gjetjen e formulës. ($y = 2^{n-1}$)

Hapi i katërt (10 minuta)

“Tani – vazhdon mësuesi – do të gjejmë me afërsi kur kanë jetuar brezat paraardhës”.

Ai hap një diskutim në klasë se sa duhet marrë afërsisht dhe mesatarisht intervali nga lindja e prindërve në lindjen e fëmijës. (Ky interval mund të merret 25 vjet)

Pas kësaj nxënësit duhet të plotësojnë boshtin numerik në fletët e tyre në këtë mënyrë:



Hapi i pestë (10 minuta)

Mësuesi u kërkon grupeve të përshkruajnë dy veçori të periudhës kur janë lindur përkatësisht gjyshërit, stërgjyshërit dhe katragjyshërit e tyre. (Mund të përmendin veçori historike si “Katragjyshi është lindur kur Shqipëria ishte nën sundimin turk”, por edhe të tjera psh “Ato kohëra udhëtohej me kuaj, nuk kishte trena apo vetura”)

Hapi i gjashtë

Mësuesi i fton nxënësit që të “mbushin” pemën e tyre gjenealogjike sëbashku me prindët dhe gjyshërit e tyre. Ai i fton, gjithashtu, që të shkruajnë diçka shkurt për historinë e tyre familjare, psh për një stërgjysh (kur është lindur, kur, me se merrej, ndonjë ngjarje të tij dhe ca veçori të asaj epoke)

Hapi i shtatë (20 minuta)

Pasi mbaron afati disa nxënës lexojnë para klasës shkrimet e tyre.

Potenciali (20 minuta)

Ky aktivitet kombinon njohuri nga matematika, historia dhe gjeografia. Të nxënët konjitiv ndërthuret më të nxënët afektiv.

Ai inkurajon marrëdhënje pozitive ndërpersonale ndërmjet nxënësve, gjithashtu ndërmjet brezave brenda në familje.

Diskutimi mund të gjallërohet me pyetje të tilla: Çfarë ndjetë kur mësuat ngjarje të familjes që ishin të panjohura për ju? Çfarë ju ka lënë më shumë mbresë ndërsa përpiqeshit ta plotësonit sa më shumë pemën tuaj gjenealogjike? Po te pema gjenealogjike e shokut tënd

çfarë të ka bërë më shumë përshtypje? Çfarë do të doje të mësoje edhe më rreth historisë së familje tënde?

Një pyetje tjetër: A ka ndonjë ngjarje që u ka ndodhur paraardhësve tuaj që ka ndikuar në jetën tënde?

Ky diskutim mund të bëhet brenda grupit.

Stavri Llambiri, ISP.

Aktiviteti	2
Lënda	Gjuha shqipe
Tema	Gjuha shqipe dhe dialektet
Klasa	8
Koha	45'

Objektivat

- të njohin shtrirjen e gjuhës shqipe në hapësirë në dialektet e saj dhe në variante të dialekteve
- të rritet ndërgjegja kombëtare e nxënësve për pasurine dhe larminë leksikore të gjuhës shqipe
- të bejnë krahasime dhe vlerësime për përdorimin e gjuhës shqipe në fusha të ndryshme të jetës
- të kontribuojnë për pasurimin e gjuhës shqipe me lëndë të marrë nga perlat e dialekteve.

Mjetet e nevojshme

- Fjalori i gjuhës shqipe
- lista me fjalë të mbledhura nga vetë nxënësit më parë nga krahinat e tyre gege apo toske , nga krahina e Kosoves , nga Arbëreshet ,Çamëria etj
- fije peri me ngjyra të ndryshme 5 ngjyra
- fletë pune dhe etiketa kartoni për të shkruar fjalë dhe shprehje të ndryshme në dialektet e shqipes.

Potenciali

Duke pasur parasysh se shpërndarja demografike e popullsisë së Shqipërisë vitet e fundit ka ndryshur dhe ka një integrim më të madh midis krahinave të ndryshme të vendit, nxënësit në shkollat përcjellin forma të ndryshme të folmes së dialekteve të shqipes dhe nuancat e tyre .Duke shfrytëzuar këtë dukuri natyrore për efekte mësimore, mund të ndërmerret edhe njëherë problemi i dialekteve të shqipes për të dalluar afritë midis tyre si dhe nuancat e pasura të njerit dialekt nga tjetri, të cilat përcjellin sa pasuri gjuhësore aq edhe inteligjencë kombëtare.

Procedura

Hapi i parë

Mësuesi kërkon nga nxënësit që ata të interpretojnë të folurën e zonës (qytetit apo fshatit të tyre) Përmes interpretimit apo lojës në role dhe përmes skeçeve mësuesi synon që nxënësit të riprodhojnë të folurën e shqipes në variante të ndryshme ligjërimore dialektore .Bën kujdes që të përfshihen pjesa më e madhe e varianteve të folura të shqipes (e malësisë ,e Kosovës , Çamërisë arbëreshëve , Jugut të Shqipërisë , Shkodrës , Tiranës etj).Një nxënës në dërrasë shkruan termat përfaqësuese të të folurave të ndara në kolona

Veri	Jug	Kosovë	Tiranë	Çamëri
------	-----	--------	--------	--------

Hapi i dytë

Ndahen nxënësit në grupe me nga 5-6veta një grup. Mësuesi kërkon që ata të krijojnë një fjalor me jo më shumë se 10 fjalë përfaqësuese të një varianti të folur dialektor .Cdo grup krijon fjalorin dhe e fut në zarf. Zarfat cdo grup ja dërgon njeri - tjetrin. Nxënësit në grupe i hapin zarfat, diskutojnë për kuptimin e fjalëve të fjalorit të ofruar, i shpjegojnë ato për të tjerët. Më pas mund të pyesin grupin nga i cili ka ardhur zarfi për kuptimin e fjalëve që ata nuk i njohin. Shpjegohen nga grupet përkatës e kuptimet e fjalëve

Hapi i tretë

Nxënësit të organizuar në rrathe të vegjel të cilët së bashku krijojnë një rreth të madh organizojnë lojën e fjalëve të njejta (Cdo grup ka një fije peri me ngjyrë të vecantë) Mësuesi ngre etiketën e një fjalë dhe grupet bëjnë lidhjet me pe midis tyre në rast se në të folmet e tyre përdoret ajo fjalë (kjo lojë synon të tregojë trungun e përbashkët midis fjalëve të varianteve të ndryshme dialektore si dhe lidhjen e tyre në një të tërë Me këtë lojë fëmijët mund të krijojnë edhe fjali

Hapi i katërt

Me fjalët përfaqësuese të një të folmeje (me fjalorët e përgatitur) mësuesi orienton nxënësit të përgatisin një ese, titujt t'i vendosin vetë por shkrimi t'i përgjigjet atij dialekti. Porosia është që fjalët që përdoren të kenë vlera të figurshme të kuptimeve figurative po të mundën.

Hapi i pestë

Nxënësit lexojnë esetë para klasës në dy variantet në atë dialektor dhe në atë letrar dhe njëkohësisht japin vlerësime për të dy llojet e varianteve

Variacion

- Nxënësit i ekspozojnë punimet e tyre në miniekspozita në muret e klasës.
- Nxënësit prorositen të krijojnë një fjalor me fjalë të figurshme përfaqësuese të varianteve të ndryshme dialektore të shqipes. Krahas fjalëve duhet të vihen edhe shpjegimet e kuptimeve të tyre.
- Nxënësit porositen të gjejnë në pjesët letrare që lexojnë fjalë që i takojnë dialekteve të ndryshme dhe të shpjegojnë kuptimet e tyre të figurshme

Mimoza Gjokutaj, ISP.

Aktiviteti 3
Lënda: Edukata qytetare (Ekonomia dhe drejtimi)
Klasa: 8
Tema: Porosia
Kohëzgjatja: 45'

Objektivat

Në fund të këtij aktiviteti nxënësi duhet të jetë i aftë:

- Të përkufizojë konceptin: klient, furnitor, porosi;
- Të përshkruajë elementët e një porosie;
- Të shpjegojë rëndësinë e secilit element të porosisë;
- Të përshkruajë lidhjen klientë-porositës si një lidhje komplekse
- Të plotësojë një fletë-porosi
- Të marrë vendime si klient dhe furnitor në situata konkrete të marrëdhënieve ndërmjet tyre.

Mjetet

Mësuesi mund të sjellë në klasë produktin që mendon të përdorë për konkretizim, por ai fare mire mund të shfrytëzojë idenë e pantallonave ose këpucëve që janë prezente në klasë

Ecuria

Hapi i parë (10 minuta)

Mësuesi u kërkon nxënësve të identifikojnë lëndët e para ose gjysmë të përgatitura që nevojiten për prodhimin e një produkti, për shembull të pantallonave, këpucëve ose një produkti tjetër që ai e gjykon më të përshtatshëm për bashkësinë ku ndodhet shkolla. Mësuesi mund të zgjedhë edhe një produkt të trajtuar më parë gjatë zhvillimit të lëndës.

Ai shkruan në tabelën e zezë emrin e produktit dhe liston lëndët e para ose të gatshme që nevojiten për prodhimin e produktit të zgjedhur, të identifikuar nga nxënësit.

Më pas ai kërkon nga nxënësit t'i grupojnë lëndët e para sipas mënyrës së sigurimit të tyre. Nxënësit mund të veçojnë për shembull

në rastin e pantallonave,

- pambukun
- copa
- penjtë
- komçat
- bojën për ngjyrosje

në rastin e këpucëve:

- lëkurën e papërpunuar
- lëkurën e përpunuar
- shollin
- pjesën e brendshme të këpucës

- penjtë
- lënda për ngjitje.

Po kështu, mësuesi kërkon nga nxënësit të vendosin përbri lëndëve të para ndërmarrjen që i siguron ato, për shembull:

- pambuku sigurohet nga ndërmarrja bujqësore,
- copa sigurohet nga kombinati tekstil etj.

Hapi i dytë (10minuta)

Mësuesi i shpjegon nxënësve se ndërmarrja që të realizojë produktin (pantallonat, këpucët) duhet të sigurojë lëndët e para nga ndërmarrje të tjera. Për këtë arsye ndërmarrja duhet të porosisë ndërmarrjet e tjera për ta furnizuar atë më këto lëndë. Ai sqaron nxënësit se ndërmarrja që porosit lëndën e parë ose produktet e gatshme që duhen për prodhim quhet **klienti** ndërsa ndërmarrja që siguron ato quhet **furnitor**. Po kështu mësuesi u shpjegon nxënësve mënyrën se si plotësohet një porosi si dhe kushtet e domosdoshme të pranimit të saj. Përveç kësaj mësuesi u shpjegon nxënësve disa nga rastet kur ndërmarrje të ndryshme nuk i pranojnë porositë e disa klientëve.

Hapi i tretë (15-20 minuta) lojë me role

Më pas mësuesi e ndan klasën e 5 grupe si më poshtë;

- **Grupi 1** është ndërmarrja që shet produktin (pantallonat ose këpucët ose diçka tjetër)
- **Grupi 2** është ndërmarrja që i prodhon ato.
- **Grupi 3** dhe **Grupi 4** janë ndërmarrje furnitore ndërmarrjen prodhuese –Grupi 2 (klient)
- **Grupi 5** është ndërmarrje që furnizon ndërmarrjen **3** dhe **4** (klientë)

Pas kësaj ai kërkon nga grupet (dhe i ndihmon ato) që pasi të vendosin lidhjet me grupet e tjera në të cilat ata shfaqen një herë si klientë dhe një herë si furnitorë, **të plotësojnë fletë porositë për produktet e kërkuara ose të furnizuara** sipas lidhjeve të mëposhtme:

1. Grupi 1 (**klient**) – Grupi 2 (**furnitor**)
2. Grupi 2 (**klient**) – Grupi 3 dhe Grupi 4 (**furnitorë**)
3. Grupi 3 & 4 (**klientë**) – Grupi 5 (**furnitor**)

- Mësuesi sugjeron grupin 2, në rolin e nje klienti që të mos bëjë porosi për grupin 3.
- Grupi 2 të zgjedhë vet arsyen pse nuk kërkon bashkëpunim të mëtejshëm me grupin 3.
- Po kështu **grupi 1**, të paraqesë vërejtjet e tij për grupin 2 për parregullsi në furnizim etj. Pasi të kenë përgatitur punën mësuesi i fton grupet (5 minuta) të luajnë me anë të përfaqësuesve të tyre para klasës një lojë me role mbi bazën e skenarit të sugjeruar më sipër.

Hapi i katërt (5 minuta)

Mësuesi në këtë fazë kërkon nga nxënësit të reflektojnë për rëndësinë që ka fakti që ai që e quan veten klient duhet të mendojë në të njëjtën kohë edhe si furnitor. Kjo do të thotë që ai duhet të mendojë jo vetëm për të drejtën që ka ndaj furnitorit por edhe për detyrimin që ka ndaj një klienti tjetër. Kjo do e ndihmojë atë të jetë më korrekt në procesin e prodhimit dhe në marrëdhëniet me të tjerët, pasi realizimi i interesave individuale varet (ndonëse kjo gjë nuk është e dukshme për disa), nga realizimi i detyrimeve të të gjithëve.

Potenciali

Ky aktivitet mund të përdoret për të sqaruar nxënësit si më poshtë:

- lidhja klient – furnitor nuk është një lidhje e njëanshme por e dyanshme e reciproke
- lidhja konkrete klient - furnitor nuk është dhe nuk mund të kuptohet vetëm brenda marrëdhënieve që vendosen ndërmjet dy anëve të lidhjes por vetëm si një hallkë e një zinxhiri të gjatë **lidhjesh shkak pasojë** në të cilën ato ndërrojnë vend, ose si pjesëz e një lidhje komplekse e globale në të cilën veprojnë si të kushtëzuar dhe kushtëzues shumë faktorë që ndryshojnë në kohë e hapësirë.
- Mësuesi të shfrytëzojë raportet që krijohen në lojnë me role dhe të theksojë idenë e mësipërme për të zgjeruar këndëvshtrimin e nxënësve jo vetëm në rastin e marrëdhënieve konkrete klient furnitorë por edhe më gjerë.
- Ai mund t'i kërkojë nxënësve shembuj kur ata mendojnë se kanë arritur në përfundime të gabuara pasi kanë menduar ngushtë dhe kanë injoruar faktorët e shumtë që ndikojnë në një dukuri.
- Po kështu mësuesi mund ta shfrytëzojë këtë rast edhe në një drejtim tjetër: në atë të ndërgjegjësimit se jo vetëm prodhimi por edhe jeta e përditshme ngrihet mbi bazën e respektimit jo vetëm të të drejtave por edhe të përgjegjësive dhe detyrimeve ndaj të tjerëve.

Astrit Dautaj, ISP.

Aktiviteti	4
Lënda	Dituri Natyre
Klasa	5
Tema	Dhjetë gjëra që i bëj me qejf në vend që të pi duhan
Koha	10'

Objektivat

- Të kuptojnë rëndësinë e marrjes me aktivitete për të shmangur fitimin e veseve.

Forma pune Veprimtari, diskutim.

Mjetet e nevojshme Letër dhe lapsa

Procedura

Vendi Klasa

Hapi i parë (5 minuta)

Udhëzoi nxënësit që në letrën format të heqin një vizë nga lart poshtë në mes të letrës, duke e ndarë në dy gjysma. Kërkoju nxënësve që në anën e majtë të letrës të shkruajnë dhjetë gjëra që do të kishin dëshirë t'i bënin në vend që të pinin duhan. Duhet nxitur që ata të mendojnë në mënyrë sa më krijuese që të munden. Disa mund ta kenë të vështirë të mendojnë dhjetë gjëra. Sugjero disa prej tyre që mendon se njerëzit kanë dëshirë t'i bëjnë, si për shembull: të luajnë me top, të dëgjojnë muzikë, të vizatojnë, të shohin një film, të bisedojnë me një shok apo shoqe, të lexojnë një libër, të shetisin etj.

Hapi i dytë (5 minuta)

Pas plotësimit të listës kërkoji nxënësve të ndajnë pjesën e djathtë të letrës në pesë kolona. Në krye të secilës kolonë, të shënohet me simbolet e mëposhtëme:

Në kolonën e parë **(P)**

Në kolonën e dytë **(RR)**

Në kolonën e tretë **(I)**

Në kolonën e katërt **(5)**

Në kolonën e pestë **(pikëçuditëse)**

Në kolonën e parë (P) secili të shënojë me një V zërin ose zërat që duan para (lekë) për t'i bërë.

Në kolonën e dytë (RR) të shënojë zërin ose zërat që mund të implikojnë rrezik të mundshëm. Ky rrezik mund të jetë personal, shoqëror ose mendor.

Në kolonën e tretë (I) të shënojë ndonjë zë që i përcaktojnë ata si individë, domethënë si njerëz origjinalë.

Në kolonën katërt (5) zërin ose zërat që mendojnë se gjatë pesë vjetëve nuk do t'i ketë më në listë.

Në kolonën e pestë të shënojë veprimtaritë e preferuara që kanë aktualisht në listë.

Hapi i tretë (5 minuta)

Ndaji pjesëmarrësit në grupe prej katër vetësh dhe caktoji çdo personi 2-3 minuta kohë që të flasë për listën e vet. Kërkoju t'i krahasojnë me shoku – shokun gjërat që pëlqejnë si dhe simbolet e ndryshme që kanë shënuar për to.

Potenciali

Ky aktivitet kërkon si fillim, që secili nxënës të punojë në mënyrë individuale, por më parë mësuesi duhet të qartësojë mirë qëllimin e aktivitetit për preferencat që mund të shprehë secili nxënës.

Dikutimi më pas mund të përqëndrohet ndërmjet çifteve të nxënësve për secilën kollonë që ata kanë dëshirë.

Variacioni

Në qoftë se ju mendoni se hapi i dytë paraqet vështirësi për tu realizuar nga nxënësit tuaj, ju mund të realizoni në kohën 10 minuta hapin e parë dhe të tretë duke ju kërkuar nxënësve që të diskutojnë vetëm listën e gjërave që ata kanë dëshirë të bëjnë, pa e klasifikuar atë në pesë kollona.

Fatmira Zenelaj, ISP.

Aktiviteti 5
Lënda Lexim Letrar
Klasa 8
Tema Blimi mama plumbat
Kohëzgjatja 45 minuta

Objektivat

1. Të lexohet me teknikat e leximit shprehës.
2. Të komentohet dhe të zbulohet mesazhi.
3. Të shprehin qëndrime ndaj çështjes së armëve si një problem shoqëror e në vecanti për femijet si dhe ndaj çështjes së paqes.
4. Të bëjnë postera sensibilizues për rrezikun dhe pasojat e armëve.

Mjetet

Tabakë të bardhë (5 copë), fletë pune të parapërgatitura nga mësuesja për dy aktivitete, ngjitëse (60 cop[).

Potenciali

Kjo orë mundëson komentim të lirë të vargjeve duke i zbërthyer ato dhe edukon nxënësit me qëndrime të drejta ndaj luftrave shkatërruese dhe me kujdesin që duhet të kenë për të mos luajtur me armë.

Procedura

Hapi i parë (Koha 5 minuta).

Mësuesja u flet nxënësve për autorin e poezisë dhe e lexon atë. Kërkohet nga nxënësit të thonë çfarë fjale nuk kuptojnë dhe spjegohet kuptimi i saj.

Hapi i dytë (Koha 10 minuta).

Pasi ta kenë lexuar në heshtje poezinë nxënësit do të nxjerrin fjalën kyçe të çdo vargu duke plotësuar këtë fletë pune. Do t'u kërkohet nxënësve që fjala kyçe të jetë nga vargjet e pjesës.

FLETE PUNE NR. 1

VARGJET SIPAS PJESËVE	FJALA KYÇE E PJESËS

Hapi i tretë (Koha 15 minuta).

Ndahet klasa në 5 grupe. Mësuesja i jep cdo grupi nga një fletë pune në format të madh ku duke bashkëpunuar me njeri – tjetrin do të shkruajnë me 5 fjali mendime se çfarë do të ndodhte sikur fëmijet të kishin armë nëpër duar për të lozur. Një i zgjedhur nga grupi pasi e mbarojnë e ekspozon në mur para klasës.

FLETE PUNE NR 2**C'DO TË NDODHTE SIKUR...**

1
2
3
4
5

Hapi i katërt (Koha 25 minuta).

Krijohen 5 grupe të rinj me nga 6 nxënës. Cdo grup do të bëjë nga një poster me vizatime dhe me diçiturën përkatëse lidhur me pasojat shkatërruese të armëve për një popull dhe për një vend. Ekspozohen posterat në klasë dhe shikohen nga nxënësit.

Variacion

Posterat mund të ekspozohen në mjediset e shkollës dhe mund të lihen aty për disa kohë për të bërë efektin ndikues tek fëmijët. Mund të organizohet edhe ndonjë ditë e vecantë ku të ftohen prindër dhe komuniteti për ta vizituar ekspozitën me punimet e fëmijëve të tyre.

Bukurie Rexha (Anëtare e grupit të punës për Edukimin Global).

Aktiviteti	6
Lënda	Gjeografi
Klasa	8
Titulli	Alpet shqiptare
Koha	45'

Mjete të nevojshme

Hartë e Shqipërisë për gjithë klasën, hartë e Shqipërisë për çdo nxënës, tabakë letre për çdo grup, lapostil për çdo grup, ngjitës, gërshërë.

Objektivat

Në fund të këtij aktiviteti nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë pozitën gjeografike dhe disa nga format kryesore të
- relievit të alpeve në artën fizike të Shqipërisë;
- të evidentojnë vlerat turistike të ëtij rajoni;
- të thonë veçoritë e popullsisë dhe të shpërndarjes së saj në këtë zonë

Proçedura

Hapi parë (35 minuta).

Pasi është ndarë klasa në grupe (mirë është 5 grupe), mësuesi fillon prezantimin e detyrës që ka secili grup. (Për tërë ealizuar ndarjen në grupe përdorni forma të ndryshme në mënyrë që përbërja e tyre të mos jetë e njëjtë në çdo aktivitet). Detyra e çdo grupi është kjo:

Supozoni se punoni në një agjensi turistike dhe iu duhet të bëni një fletë palosje (reklamë) për Alpet e Shqipërisë. Në hartimin e tekstit duhet të keni parasysh që me anën e tij të tërhiqni sa më shumë turistë për ta vizituar këtë zonë. Jeni të lirë në strukturimin e tekstit, por do të mbani parasysh që në të të flitet për:

- ku shtrihen Alpet shqipëtare;
- si është relievi (format që mbizotërojnë) duke përmendur disa male apo lugina;
- ç' klimë ka;
- disa lumenj kryesor;
- bota shtazore e bimore;
- bukuritë që ofron relievi;
- popullsia që jeton në këtë zonë;
- disa qendra kryesore;
- si paraqitet gjendja e ndotjes së mjedisit;
- e ardhmja e këtij rajoni.

Detyra do të realizohet duke u konsultuar me hartat fizike dhe administrative të Shqipërisë që keni para.

Mësuesi për ta lehtësuar të kuptuarin e detyrës mund t'i shkruajë në dërrasën e zezë çështjet të cilat duhet të pasqyrohen në tekstin që do të shkruhet.

Pasi i lihet koha e mjaftueshme për ta realizuar detyrën, secili grup prezanton me një përfaqësues punën e tij e cila është e paraqitur në tabakët e letrës që afishohen në muret e klasës. Në fund të prezantimit mësuesi bën përmbledhjen duke shtuar informacionin e pa nxjerrë nga nxënësit.

Hapi dytë (10 minuta).

Më pas kalohet në një diskutim të përbashkët për çështjet si:

- A ka resurse të mjaftueshme ky rajon për zhvillimin turizmit?
- Po në të ardhmen ç'ofron ky rajon?
- A njihni rajone turistike në botë të ngjashme për nga kushtet fiziko-gjeografike me alpet tona?
- Nëse ndonjëri e ka vizituar këtë rajon ç'përshtypje sjell ai?

Potenciali

Ky aktivitet duke qenë i përqëndruar në punën në grup, inkurajon punën e nxënësve së bashku dhe e bën secilin që të respektojë e vlerësojë mendimin e shokut. Vënia në pozicionin e reklamuesit bën ata që ta vlerësojnë pozitivisht vendin e tyre duke nxjerrë në pah veçoritë më të mira të tij. Po kështu tek ata rritet vlerësimi në vetvete pasi iu duhet të gjejnë vetë shumë të dhëna fiziko-gjeografike.

Varacion

Detyra për secilin grup mund të përgatitet edhe në fishe letre për secilin grup e t'i jepet në dorë në mënyrë që të jenë sa më të qarta.

Shënim: Aktiviteti mund të zhvillohet dhe në orë të tjera duke përdorur analogjinë për rajonet e tjera fiziko-gjeografike të Shqipërisë.

Albana Markja, ISP.